



KONTROLI I LARTË I SHTETIT
RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI PËR AUDITIMIN E USHTRUAR NË
AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TIRANË

RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI I PËRPUTHSHMËRISË
NË
NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TIRANË

Tiranë, 2021

Përmbajtja

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE.....	2
1.Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit.....	2
2.Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	3
3.Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinion i auditimit.....	9
II.HYRJA.....	11
1. Objekti i auditimit.....	11
2. Qëllimi i auditimit.....	11
3. Identifikimi i çështjes.....	11
4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.....	11
5. Përgjegjësit e audituesve.....	12
6. Kriteret e vlerësimit.....	12
7. Standartet e auditimit.....	12
8. Metodatat e auditimit.....	12
9. Dokumentimi i auditimit.....	13
III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.....	13
1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin.....	13
2. Përshkrimi i rezultateve sipas drejtimeve të auditimit.....	13
2.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.....	13
2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.....	45
2.3. Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i programit ekonomik.....	54
2.4. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.....	63
2.5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).....	72
2.6. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.....	86
2.7. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.....	98
2.8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit.....	112
2.9. Auditimi i Brendshëm.....	120
IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET.....	120

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

I.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit

Auditimi i Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë me synimin dhënien e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuar si: rregullat, ligjet, politikat, kodet e vendosura apo termat dhe kushtet, mbi të cilat është rënë dakord, ku mund të përmendim si burim të këtyre kriterëve: standarde, ligje, vendime të Këshillit të Ministrave, rregullore, buxhete, kontrata, marrëveshje, instrumente të tjerë që përmbajnë rregulla se si duhet të menaxhohen transaksionet dhe zbatohen buxhetet, etj, si dhe aspektet e rregullshmërisë (respektimi i kriterëve formale siç janë ligjet përkatëse, rregulloret dhe marrëveshjet) dhe ligjshmërisë (respektimi i parimeve të përgjithshme që rregullojnë menaxhimin e shëndoshë financiar dhe sjelljen e zyrtarëve publik), promovimin e një qeverisje të mirë, duke identifikuar dhe raportuar devijimet nga kriteret, në mënyrë që të merren veprime korrigjuese si dhe të identifikojë personat përgjegjës për veprimet e tyre.

I.2 Gjetjet kryesore të konstatuara.

Gjetja	Përmbledhje e gjetjes	Referenca në raport	Rëndësia	Rekomandimi
1	<p>Këshillit Drejtues për programin ekonomik të vitit 2021 ka zhvilluar mbledhjen e datës 18.12.2020 dhe të datës 24.12.2020. Në këto dy mbledhje dhe në veçanti në mbledhjen e datës 29.01.2021 është diskutuar “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO” dhe nuk është marr vendimmarrje, pavarësisht se zgjidhja e kësaj çështje rezulton me pasoja financiare, duke konsideruar se tarifa en-route e mbledhur nga Euro. për llogari të RSH-së për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për Autoritetin e Aviacionit Civil, e cila përbën rreth 30% të të ardhurave totale.</p> <p>Vendimmarrja e Këshillit Drejtues nuk ka marr në konsideratë për sa më poshtë vijon:</p> <p>-a. Njoftimi i Eurocontrol për AAC nëpërmjet komunikimit elektronik bën me dije se shuma e mbajtur nga llogaria</p>	Pika 2.2, fq 45-54	E lartë	Nga Organet Drejtuese të AAC ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pozita financiare e AAC e krijuar, si rrjedhojë e urdhrin të ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO.” dhe pamundësia e deritanishme e zgjidhjes së kësaj shtate nga institucionet e përfshira në këtë çështje si Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, jo vetëm për sa i përket mos përfitimit të tarifës en-route, por

	<p>e Shqipërisë për llogari të Bechetti, deri në datën 15 dhjetor 2020 është në vlerën 171,653 Euro, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1879/1, datë 23.03.2021, njofton AAC se kjo shumë në datën 28 Janar 2021 është në vlerën 1,687,755 Euro.</p> <p>Theksojm se referuar procesverbalit të mledhjes së Këshillit Drejtues të datës 28.12.2020 ,detyrimi total është mbi në vlerën140 milion euro.</p> <p>- b. Urdhri i ekzekutimit dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Belge për të cilën është lëshuar, nuk është realizuar në mënyrë zyrtare për Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” të vitit 1965. Ky njoftim është bërë nëpërmjet Euro, e cila ka njoftuar AAC mbi objektin e urdhrit të ekzekutimit, me anë të shkresës Ref. DCF 126_20 të datës 7 dhjetor 2020.</p> <p>-c. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përballojë shpenzimet ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për çështjen e ngrirjes së llogarive të Republikës së Shqipërisë në EURO, sipas Urdhër Ekzekutimit të Autoriteteve Belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit përkatës te Gjykatës së Shkallës së Parë Belge të datës 1 Dhjetor 2020, pra do t’i duhet të përshijë në programin ekonomik të viti 2021 shpenzimet të asistencës juridike, që nga auditimi rezultuan se nuk ka asnjë korrespondencë me Avokaturën e Shtetit n.q.s ka/ose jo të kontraktuar zyrë avokatie dhe sa shkojnë kostot e gjykimit.</p> <p>-c. Edhe pse çështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e Shtetit dhe AAC, ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacionit Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe urgjencën e kohës, Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar në përputhje me nenin</p>			<p>edhe për shpenzimet e pritshme të asistencës juridike (shpenzime avokatie).</p>
--	---	--	--	--

	<p>15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008, si dhe të Kapitulli 4 pika D të VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, pasi ka deleguar një të drejtë AAC që është tagër ekskluziv i saj.</p> <p>-d. Mbledhja e Këshillit Drejtues e datës 29.01.2021 me pikë të parë të rendit të ditës mbi mbarëvajtjen e procesit të kundërshtimit të veprimeve përmbarimore lidhur me llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO, është zhvilluar në fillim të viti buxhetor, ku AAC gjendet në pozitë financiare të vështirë që pasqyron qartazi vetëm një krizë të mprehtë likuiditeti, si rrjedhojë e mungesës së tarifës en-route dhe uljen rreth 50% të tarifës së sigurisë për shkak të numrit të ulët të fluturimeve nga kufizimet e COVID-19.</p> <p>Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij neni 5 “Këshilli drejtues”, pika 1.</p>			
2	<p>Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, merret nëpërmjet Aeroporti Nënë Tereza. Për të garantuar sigurinë, TIA ka të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarife sigurie (“Pagesa e Sigurisë”) deri në 4 EUR për pasagjer (2 EUR për pasagjeret që mbërrijnë dhe 2 EUR për pasagjeret që largohen) me qellim që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënien e shërbimit të sigurisë. TIA do të paguaj 25% (ose 1 euro), të tarifës së sigurisë të mbledhur AAC në baza mujore me vonesë, dhe do të këtë të drejtën të mbajë diferencën. TIA, bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44” do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, këto regjistrime do t’i paraqiten AAC-së për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme. Nga AAC nuk është kryer asnjë inspektim në Aeroporti Nënë</p>	Pika 2.3, fq 54-63	E lartë	<p>-Nga Drejtori Ekzekutiv të merren masa për kryer për inspektime të herë pas hershme në regjistrat e mbajtura nga TIA për numrin e pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur.</p> <p>-Nga Drejtori Ekzekutiv t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale bashkëpunimit me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 “Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”, edhe për AAC.</p>

	<p>Tereza referuar SHTOJCËS 44. Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart, pasi të dhënat mbi pasagjer në dalje duke llogaritur 1 euro për pasagjer për llogari të AAC dhe tarifa e komunikimi duke llogaritur 25 euro për fluturim, bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza. Pra nuk ka as verifikim nga ndonjë burim tjetër p.sh. operatorët e fluturimit, për saktësinë e pasagjerëve që raporton TIA. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtron aktivitetin AAC, nuk i mundësohet të kërkoj të dhëna të tjera nga burime alternative për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga TIA. Për sa më sipër grupi i auditimit mori në përzgjedhje dy operatorë shqiptar të cilët kryejnë fluturime të rregullta (skedulë) në TIA. Konkretisht u morën në auditim operatori A. dhe A. A.. Duke marrë për bazë aplikimet për leje fluturimi dërguar nga dy kompanitë e mësipërme për sezonin veror IATA 2020, u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Gjithashtu, këto të dhëna i referohen vetëm numrit të fluturimeve sipas frekuencës së kërkuar nga secili operator. Bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare”, AAC nuk ka tagër ligjor për ti kërkuar operatorëve të dhënat statistikore për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Nga informacioni verbal i dhënë nga Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, jemi bërë me dije se AAC po bashkëpunon me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 (e cila ka pësuar 5 ndryshime), “Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”. Aktualisht Bashkimi Evropian ka në fuqi Rregulloren me nr. 437/2003 “Mbi statistikën në lidhje me transportin e udhëtarëve, transportin e mallrave dhe postës” (Regulation (EC) No 437/2003 of the European Parliament and of the Council of 27 February 2003 on statistical returns in respect of the</p>			
--	---	--	--	--

	<p>carriage of passengers, freight and mail by air). Pra Bashkimi Evropian e ka, Republika e Shqipërisë nuk ka një rregullore për këtë qëllim.</p> <p>Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44.</p>			
3	<p>Nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për “Sigurimin e jetës & shëndetit të punonjësve” në kompanitë e sigurimeve “S.” dhe “I.”. Për 3 vjet prej fillimit të kryerjes së këtij shërbimi vlera prej 8,970,950 lekë, është shpenzuar për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, vlerë e cila konsiderohet efekt ekonomik negativ pasi nuk ka asnjë argumentim ligjor për arsyet e kryerjes së këtij shërbimi. Mungon analiza dhe hartimi i një programi mbi argumentimin e kryerjes së këtij shërbimi, nuk ka asnjë dokumentacion ku të arsyetohen kategoritë dhe vendet e punës që kanë më shumë risk, si është vlerësuar nga institucioni risku i punonjësve të administratës krahasuar me personelin teknik, etj, bazuar në detyrimet e punëmarrësit sipas Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.</p>	<p>Pika 2.5, fq 72-86</p>	<p>E mesme</p>	<p>Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të analizojnë dhe përcaktojnë kategoritë përfituese të punonjësve për sigurim jete dhe shëndeti, referuar vështirësisë së vendit të punës dhe nivelit të riskut për çdo pozicion pune, referuar legjislacionit në fuqi dhe me miratim nga Ministria e linjës, me qëllim përfitimin e shërbimit nga punonjësit dhe minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare.</p>
4	<p>AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i detyruar i titujve ekzekutivë (punonjës të larguar nga puna) për periudhën 2019-2020, shumën 13,933,903 lekë. Kjo vlerë përfaqëson dëmshpërblimin e punonjësve në shumën 13,294,846 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 114,400 lekë dhe shpenzime përmbarimi në shumën 524,657 lekë. Vlera prej 13,933,903 lekë, përbën efekt negativ financiar për institucionin.</p>	<p>Pika 2.5, fq 72-86</p>	<p>E mesme</p>	<p>Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, në të ardhmen të marrin masa për eliminimin e procedurave të largimeve nga puna të punonjësve të paargumentuara ligjërisht, me qëllim minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare dhe venë në vështirësi institucionin.</p>
5	<p>Në procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2020, Komisioni për llogaritjen e fondit limit ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC” prej 2,198,500 lekë. Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D., S.K. dhe</p>	<p>Pika 2.7, fq 98-112</p>	<p>E lartë</p>	<p>AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përlllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike. AAC të ndjek</p>

	<p>E.K. është 232,534 lek më i lartë se kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi:</p> <p>-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2019 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e fondit limit e llogaritur nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.</p> <p>-Së dyti AAC ka një kontratë të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë;</p> <p>-Veprimet e mësipërme kanë sjellë një fryrje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiar për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = 233,350 lekë , vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet dëshmohet. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 pika b) VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 59 Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës 1.</p>			të gjitha rrugët administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e shumës prej 233,350 lek nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit.
6	<p>AAC nuk ka arritur të arkëtojë vlerën 1,935,032 lekë nga ish-drejtuësit që janë larguar nga institucioni. Kjo vlerë ka të bëjë pajisjet informatike që kanë pasur në ngarkim për shkak të detyrës që ato kanë ushtruar, të cilët nuk i kanë dorëzuar. AAC nuk duhet të kishte dhënë librezat e punës pa dorëzuar inventarin në ngarkim dhe detyrimet e tjera financiare. Por është mjaftuar vetëm me njoftimet që u ka bërë personave me përgjegjësi materiale dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor. Konkretisht referuar urdhrin të brendshëm nr. 285, datë 06.06.2019 të ish-Drejtorit Ekzekutiv të AAC Krislen Keri janë njoftuar me shkresën nr. 1119/1 A.L. me detyrë ish-Drejtor Ekzekutiv, me shkresën nr.1119/2 A. C. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues,</p>	Pika 2.6, fq 86-98	E lartë	Drejtori Ekzekutiv i AAC, të marrë masa të menjëhershme për ndërmarrjen e të gjithë hapave ligjor për arkëtimin e detyrimeve që kanë ndaj Institutit.

	me shkresën nr. 1119/3 A. A. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues, me shkresën nr. 1119/4 F. G. me detyrë ish-drejtor i departamenti ekonomik dhe me shkresën nr. 1119/4 I. H. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues.			
--	--	--	--	--

1.3. Konkluzioni dhe Opinioni i Auditimit

Ne kemi përfunduar auditimin e përputhshmërisë të Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë për periudhën 01.01.2018 deri më datë 30.07.2021.

Nga auditimi i ushtruar u konstatua se aktiviteti i Institucionit në përgjithësi përputhet me kërkesat dhe kriteret e kuadrit ligjor në fuqi. Pavarësisht sa u citua si më sipër, për periudhën objekt auditimi u konstatuan edhe shkelje të kuadrit nënligjor dhe rregullator dhe në veçanti të organeve drejtuese, realizimit të programit ekonomik, zbatimin procedurave të prokurimit dhe kontratave për punë publike, shërbime dhe pajisje (mallra), kryerjen e transaksioneve financiare për shpenzimet, zbatimin e rekomandimeve të KLSH etj.

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinioni i auditimit i modifikuar/kualifikuar:

Ne kemi audituar përputhshmërinë e aktivitetit të Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë. Auditimi është bazuar në ligjin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, Rregulloren e Procedurave të Auditimit, Manualin e Përputhshmërisë, Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, si dhe Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të Sektorit Publik ISSAI 4000¹.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion kemi konstatuar se në veprimtarinë e Autoritetit të Aviacionit Civil, Tiranë janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin”, që nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinioni të kualifikuar.

Baza për Opinionin

Për gjetjet nga auditimi dhe rekomandimet, jemi dakortësuar me menaxhmentin e Institucionit, si dhe jemi siguruar prej Tij, që vendimmarrjet në ardhmen të jenë më të spikatura, që të japin shërbime më të mira dhe vlerë më të mirë për parane. Për të arritur këtë, menaxhmenti i këtij Institucioni të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare, por edhe për të siguruar që këto vendime janë dobiprurëse dhe në interesin më të mirë të publikut. Kjo do të thotë, të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur, nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, si personeli, pasuritë dhe buxheti sipas programit ekonomik.

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit të institucioneve supreme të auditimit (ISSAI). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në

¹ ISSAI 4000 (Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë) që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë.

mënyrë më të detajuar në paragrafin “Përgjegjësitë e audituesit për Auditimin e Përputhshmërisë” të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë , theksuar kjo në ISSAI-n 10-Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t, si dhe ISSAI 30-Kodi Etik, në përputhje me kërkesat etike që janë të rëndësishme në auditimin e përputhshmërisë në Republikën e Shqipërisë, duke përfshirë Kodin e Etikës të KLSH dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të siguruar bazën për opinionin tonë. Menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës për marrjen e masave të nevojshme në drejtim të garantimit të përputhshmërisë së aktivitetit me kushtet e dispozitave ligjor në fuqi. Gjithashtu menaxhmenti i Institucionit është përgjegjës kryesor për ngritjen e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime korruptive në realizimin e të ardhurave dhe kryerjen e shpenzimeve, duke nisur nga hartimi i rregullave të brendshme, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi të këtij Institucioni, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit.

Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të AAC

Strukturat drejtuese të AAC, janë përgjegjëse për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara (kriteret e vlerësimit), përfshirë ato për zbatimin e gjithë kuadrit rregullator në prokurimin e fondeve publike.

Strukturat drejtuese të AAC janë përgjegjëse funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, hartimin e procedurave, aktiviteteve të kontrollit, gjurmës së auditimit dhe hartës së proceseve.

Gjithashtu, është përgjegjësi e drejtuesve të njësisë publike të përgjigjen dhe të jenë transparentë për veprimtarinë e tyre, si edhe të sigurojnë se i administrojnë këto fonde në pajtim me kriteret ligjore e rregullatore.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë.

Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse aktiviteti i Institucionit, nuk paraqet anomali materiale, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion mbi përputhshmërinë e aktivitetit me kuadrin ligjor dhe rregullator në fuqi. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Anomalitë mund të lindin nga gabimet apo mashtrimet dhe konsiderohen si materiale, nëse individualisht ose në tërësi ato influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve të raportit të treguesve fiskalë të konsoliduar. Përveç standardeve të ISSAI, ne gjithashtu aplikojmë edhe gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese. Konkluzionet tona janë të bazuara në punën audituese, deri në përgatitjen e raportit të auditimit. Megjithatë, ngjarje apo kushte specifike në të ardhmen mund të ndryshojnë situatën aktuale të aktivitetit. Gjithashtu, ne u mundësojmë drejtuesve një deklaratë në lidhje me kërkesat etike të pavarësisë sipas të cilave ne kemi kryer punën tonë audituese, dhe komunikojmë me ta në rastet kur ekziston konflikt interesi apo çështje të tjera lidhur me etikën. Ne identifikojmë çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e përputhshmërisë dhe i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i

tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, në zbatim të projektit dhe programit të auditimit të miratuar nga Kryetari i KLSH nr. 580/1 prot., datë 04.06.2021, nga data 04.06.2021 deri 30.07.2021, në Autoritetin e Aviacionit Civil Tiranë (Në vijim AAC) për periudhën e veprimtarisë nga data 01.01.2018 deri më datë 30.07.2021, u krye auditimi “Përputhshmërisë” me përbërje:

1. F. I. , Përgjegjës grupi
2. M. B., Audituese
3. S. H., Auditues
4. A. A., Auditues

OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA

a. Objekti i auditimit: Objektivi kryesor i grupit të auditimit të KLSH-së, është dhënia e opinionit për përdorimin ligjor të fondeve dhe rregullshmëria financiare e paraqitjes së dokumentacionit, që Autoriteti i Aviacionit Civil, u ka bërë fondeve në dispozicion, në bazë të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi, udhëzuesve të donatorëve, duke audituar rregullaritetin, ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së Projektit.

b. Qëllimi i auditimit:

Auditimi ka për qëllim të vlerësojë dhe evidentojë shkeljet e parimeve të ligjshmërisë dhe menaxhimit të shëndoshë financiar, si edhe shfrytëzimin me efikasitet, efektivitet dhe ekonomikitet të pasurisë shtetërore dhe fondeve publike. Ky sistem bën të mundur ndërmarrjen e veprimeve korrigjuese sipas rastit, rritjen e përgjegjshmërisë, llogaridhënies, rikuperimin e dëmeve të shkaktuara si dhe parandalimin e shkeljeve, me synim rritjen e vlerës së parasë publike në mbrojtje të interesave të taksapaguesve.

c. Identifikimi i çështjes:

Autoriteti i Aviacionit Civil Tiranë duhet të ketë organizimin e duhur, duhet të funksionojë duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi për arritjen në cilësi të shërbimeve shëndetësore të ofruara, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomikitet, efikasitet dhe efektivitet.

d. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim:

Menaxhmenti është përgjegjës për kryerjen e transaksioneve financiare në pajtim me kornizën e aplikueshme ligjore dhe që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me Ligjin nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për autoritetin aviaionit civil”, i ndryshuar; Ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar; Udhëzimin e Përbashkët i MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 “Për caktimin e tarifave në aviaionin civil”; Udhëzimin nr. 1362, datë 16.3.2016 “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit”; VKM nr. 492, datë 30.06.2005

“Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve dhe mënyrën e ndarjes së të ardhurave që realizohen në aviacionin civil”.

e. Përgjegjësitë e audituesve:

Audituesit janë përgjegjës për shprehjen e konkluzioneve dhe dhënien e opinionit për auditimin. Auditimi është bërë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit INTOSAI. Janë respektuar kërkesat etike, është planifikuar dhe kryer auditimi, sipas të cilit është arritur niveli i sigurisë së kërkuar.

f. Kriteret e vlerësimit: Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI) të INTOSAI-t, Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISA) IFAC; Kushtetuta dhe Baza Ligjore:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë:

Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 10233 datë 11.02.2010 “Për autoritetin aviacionit civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 25/2018, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”; Ligji nr. 10081, datë 23.02.2009 Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr. 44/2015 datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative të Republikës së Shqipërisë; Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998 ”Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar; Ligji nr. 111/2018 datë 07.02.2019 “Për Kadastrën”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar. VKM nr. 791, datë 14.11.2012 “Për miratimin e strukturës e të organikës, si dhe të strukturës e të niveleve të pagave të Autoritetit të Aviacionit Civil”, i ndryshuar; VKM nr. 492, datë 30.06.2005 “Për përcaktimin e tarifave të shërbimeve dhe mënyrën e ndarjes së të ardhurave që realizohen në aviacionin civil”; VKM nr. 413, datë 26.05.2010 “Për miratimin e strukturës dhe organikës , si dhe të strukturës së nivelit të pagave të AAC-së”, me ndryshimet vijuese të tij; VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, me ndryshimet vijuese të tij. Udhëzimi i Përbashkët i MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 “Për caktimin e tarifave në aviacionin civil”; Udhëzimi nr. 1362, datë 16.3.2016 “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit”; Udhëzimi i APP nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin me mjete elektronike”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik, i ndryshuar.

g. Standardet e auditimit:

-ISSAI 100- (*Parimet themelore të auditimit të sektorit publik*).

-ISSAI 400- (*Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë*).

-Kodi etik i KLSH.

h. Metoda e auditimit:

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje.

i. Dokumentimi i auditimit:

Dokumentimi i rezultateve të auditimit u mbështetet në kërkesat e Manualit të Auditimit të Përputhshmërisë, miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH-së nr. 196, datë 29.12.2015, si edhe në Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit ISSAI 1230 “Dokumentimi i Auditimit”.

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Autoriteti është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë, në varësi të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të Ligjit nr. 10 040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë". Veprimtaria e Autoritetit, financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai.

Misioni i AAC-së është të promovojë zhvillimin e aviacionit civil, të adresojë dhe mbikëqyrë parrezikshmërinë dhe sigurinë, pa lënë mënjane çështje të mbrojtjes së mjedisit, mbrojtjen e të drejtave të pasagjerëve, ofrimin e shërbimeve cilësore si dhe konkurrencën e ndershme.

2. Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit

2.1. Zbatimi i rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH-së.

Për auditimin e nivelit të zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm, dërguar me shkresën e KLSH-së, nr.600/10, datë 07.01.2020.

-Korrespondenca shkresore e ndjekur nga AAC dhe KLSH-së.

-Dokumentacioni shoqëruar dhe justifikues për kryerjen e rekomandimeve.

-Dokumentacioni i mbajtur nga Këshilli Drejtues për këtë qëllim, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

- Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë, nuk ka respektuar afatin 20 ditor të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, veprim në kundërshtim me nenin 15 germa “j”, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë, ka marrë masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna dhe me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 ka dërguar në KLSH, “Programi i Punës për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ka informuar marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve dhe për çdo rekomandim të lënë ka ngarkuar strukturat përkatëse për zbatimin e tyre.

- Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë, nuk ka respektuar afatin 6 mujor të kthimit të përgjigjes për raportimin e ecurisë së zbatimit të rekomandimeve, në kundërshtim me nenin 30, pika 2 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

-Nga **28** (njëzetë e tetë) **masa organizative** të rekomanduara gjithsej: **11** (njëmbëdhjetë) masa janë zbatuar plotësisht, **1** (një) masë është në proces zbatimi, dhe **13** (trembëdhjetë) masa nuk janë pranuar dhe **3**(tre) janë zbatuar pjesërisht.

Theksojmë se, është arkëtuar vlera **149,260,654 lekë**, vlerë e cila është derdhur në Buxhetin e Shtetit nga detyrimet e mbajtura në llogari të institucionit.

-Nga **2** (dy) masa për **shpërblim dëmi** të rekomanduara gjithsej: **2** (dy) masa nuk janë pranuar. Në rekomandimet e sipërpërmendura citohet arkëtimi i 20,252.96 Euro dhe 66,000 lekë por theksojmë se edhe pse është zbatuar një rekomandim nuk është arkëtuar asnjë vlerë.

-Nga **4** (katër) masa për **dëm ekonomik potencialisht të mundshëm** nëse nuk plotësohet me dokumentacionin mbështetës të rekomanduara gjithsej: **3** (tre) masa nuk janë pranuar dhe **1**(një) masë është zbatuar.

-Nga **8** (tetë) **masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike** për shkak të parregullsive dhe paligjshmërive të konstatuara në administrimin e fondeve publike të rekomanduara gjithsej: **5**(pesë) masa janë zbatuar dhe **3** (tre) masa nuk janë pranuar.

-Nga **2** (dy) **masa për eliminimin e procedurave të realizuara jo në përputhje me kuadrin rregullator** ligjor të rekomanduara gjithsej: **2** (dy) masa janë zbatuar.

-Nga **7** (shtatë) **masa sugjerim për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë** të rekomanduara gjithsej: **7** (shtatë) masa nuk janë pranuar.

-Nga **2** (dy) **masa disiplinore** të rekomanduara gjithsej: **2** (dy) masa nuk janë pranuar.

Realizimi i rekomandimeve në mënyrë të detajuar pasqyrohet si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Nga auditimi i zbatimit të rekomandimeve nga auditimi i mëparshëm, u konstatua se:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion grupit të auditimit, u konstatua se, Vendimi i KD nr. 80, datë 21.12.2017, për krijimin e një fondi rezervë të AAC prej 107,000,000 lekë, është në kundërshtim me nenin 18, pika 3 i Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, i cili nuk parashikon mbajtjen e një fondi rezervë për Autoritetin por citon se: “Veprimtaria e Autoritetit financohet tërësisht nga të ardhurat e realizuara nga vetë ai. Të ardhurat e realizuara, por të pashpërndara në fund të vitit të parë buxhetor të veprimtarisë, mbarten për vitin pasardhës dhe reflektohen në nivelin e tarifave. Në vitet në vazhdim, të ardhurat e realizuara e të papërdorura, deri në fund të vitit, mbarten e përdoren për shpenzime të angazhuara deri për një periudhë 3-mujore të vitit pasardhës e më pas derdhen në Buxhetin e Shtetit”.

Shuma e gjendur në llogaritë e AAC pas muajit mars 2018, është në vlerën **181,846,000 lekë, ndërsa** shuma e gjendur në llogaritë e AAC pas muajit mars 2019, është në vlerën **279,917,654 lekë**. Nga auditimi i pasqyrave financiare rezultoi se, fitimi neto i vitit 2018 paraqitet në shumën 98,071,375 lekë dhe fitimi i vitit të mëparshëm paraqitet në shumën 51,189,279 lekë. Këto të ardhura në vlerën totale 149,260,654 lekë përbëjnë tepricat e mbetura në fund të viteve buxhetore, të cilat duhet të shkonin në Buxhetin e Shtetit. Në lidhje me këtë konstatim, nga strukturat drejtuese të AAC, nuk janë marrë masa për kalimin e këtyre fondeve për llogari të Buxhetit të Shtetit, duke i mbajtur ato në llogari rrjedhëse të institucionit, në bankat e nivelit të dytë, në mospërputhje me Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, neni 18, pika 3. Kjo situatë (fakt) është konstatuar edhe nga auditimet e mëparshme, por përsëri rezulton se AAC nuk ka marrë asnjë masë për zbatimin e rekomandimeve të KLSH, si detyrim ligjor.

Rekomandimi 1.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masat, për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të **shumës prej 149,260,654 lekë**, të konstatuara të pa derdhura si fitim i vitit 2017. Gjithashtu nga AAC të merren masat për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të detyrimeve të mbajtura në llogari të institucionit, që janë jo vetëm të periudhës së auditimit por, të akumuluar nga vitet e mëparshme, të cilat në total shkojnë në fund të periudhës së auditimit në shumën **279,917,654 (181,846,000 lekë + 98,071,654) lekë**.

Menjëherë

Rekomandimi 1.2: Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë të kërkojë që Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masa për derdhjen e të ardhurave të papërdorura në buxhet dhe të kërkojë llogari për mos zbatim të ligjit nga strukturat drejtuese.

Menjëherë dhe në vijimësi

Me Vendimin e Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil nr. 14, datë 18.12.2019 është miratuar derdhja në buxhet e fitimit të vitit 2017 dhe 2018, në vlerën 149,260,654 lekë. Me shkresën nr. 71, datë 10.01.2020, si dhe Autoriteti i Aviacionit Civil është drejtuar Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për të përcaktuar llogarinë bankare në të cilën do të derdhen të ardhurat. Me shkresën nr. 338 prot., datë 11.02.2020 të Drejtorit Ekzekutiv është kryer derdhja në Buxhetin e Shtetit. Me transaksionin bankar në Bankën Kombëtare Tregtare më datë 24.02.2020 janë kaluar të ardhurat nga Autoriteti i Aviacionit Civil në Degën e Thesarit në shumën 149,260,654 lekë. Rekomandimi 1.1 dhe 1.2 është zbatuar pjesërisht.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit mbi hartimin, miratimin dhe zbatimin e programit ekonomik të AAC rezulton se, në Vendimin nr. 10 të Këshillit Drejtues të AAC, datë 31.07.2018, miratohet një ndryshim në programin ekonomik për vitin 2018 duke shtuar zërin investime për pagesën e konsulentit të kompanisë “R. B.” GMBH, i cili do të asistojë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Ç. Con. & K. & K. Cons., sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: “...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qenë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”. Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “R. B.” GMBH, u konstatua se: Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019

sipas urdhër xhirimit të BKT, dega me kod 505, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “R. B.” GMBH në Deu. Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është me të njëjtën datë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur.

Nga sa më sipër rezulton se, vlera e investuar nga AAC prej 76,300 euro, nuk është e justifikuar me dokumente dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Financës dhe Buxhetit, të marrin masat që në të ardhmen, përpara kryerjes së pagesave për “Shërbimet e Konsulencës”, të plotësojnë dokumentacionin financiar sipas kriterëve të vendosura në DST dhe kontratë duke dokumentuar shpenzimet e drejtpërdrejta dhe ato të rimbursueshme, konform grafikut të miratuar.

Në vijimësi

Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar. Rekomandimi nuk është pranuar.

3. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 1208 prot., datë 27.06.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin e prokurimit me objekt: “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*” të llojit “*Shërbim Konsulence*”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH. Në fakt, fondi limit i përcaktuar nga grupi i përlllogaritjes së kësaj vlere, sipas procesverbalit të mbajtur për termat e referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit në datën 18.06.2018, është 29,029,513.12 lekë pa TVSH. Pra Drejtori i AAC, ka urdhëruar kryerjen e procedurës së prokurimit me një fond limit për të cilin nuk është kryer asnjë testim tregu dhe që është 513,328.16 lekë më i lartë se fondi i miratuar nga grupi i përlllogaritjes së tij. Fondi limit i përlllogaritur nga grupi i ngritur, nuk është marrë në konsideratë nga Drejtori i AAC, duke përcaktuar fondin limit në urdhrin e prokurimit pa ndjekur hapat e përcaktuara në ligj, aktet nënligjore dhe rregullat e prokurimit publik.

Rekomandimi 3.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, urdhrat e prokurimit, në përcaktimin e vlerës së fondit limit, ti referohen vlerës së përlllogaritur nga grupi i përlllogaritjes së vlerës së fondit limit, me qëllim shmangien e praktikave formale.

Në vijimësi

-Referuar praktikave të prokurimeve të kryera nga AAC, konstatohet se ky rekomandim është zbatuar. **Rekomandimi është zbatuar.**

4. Gjetje nga auditimi: Procedura e prokurimit me objekt “*Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO*”, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 698 prot., datë 28.03.2018. Në vazhdim, është anuluar për arsye se 2 (dy) ofertat e ardhura kanë pasur mangësi në dokumentacionin e dorëzuar. Pas anulimit, procedura e prokurimit, me të njëjtin objekt, është rishpallur sipas urdhrin të prokurimit nr. 1261 prot., datë 05.07.2018. Nga auditimi i dokumentacionit të publikuar në SPE nga AAC, u konstatua se:

-Dokumentet standarde të tenderit të shpallur për herë të parë, me nr. REF-62681-04-16-2018, nuk janë identike me ato të hedhura në SPE për procedurën e përsëritur (rishpallur) me nr. REF-78854-07-11-2018. Konkretisht, duke krahasuar DST nr. REF-78854-07-11-2018 (hera e dytë)

me DST nr. REF-62681-04-16-2018 (hera e parë), konstatohet se kanë ndryshim kriteret e vendosura.

-Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në SPE nga operatori ekonomik i shpallur fitues “T. C.” SHPK, u konstatuan mangësi lidhur me formularin e ofertës dhe kriteret e kualifikimit të cilat nuk ishin konform atyre të cilësuar në DST.

Rekomandimi 4.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentet standarde të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.

Në vijimësi

Rekomandimi 4.2: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, Komisionet e Vlerësimit të Ofertave, të kualifikojnë vetëm ata Konsulentë, oferta e të cilëve, plotëson kërkesat e ligjit për “Shërbimet e Konsulencës” dhe kriteret e vendosura në DST.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020, dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi 4.1. nuk është pranuar**

-Rekomandimi 4.2. është një rekomandim kërkesë ligjore dhe zbatohet vazhdimisht. **Rekomandimi 4.2. nuk është pranuar.**

5. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjete”, Titullari i institucionit, ka nxjerrë urdhrin me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit. Me shkresën nr. 567 prot., datë 30.05.2019, grupi i ngritur, për justifikimin e blerjes së dy automjeteve tip “Hibrid”, i është referuar ligjit nr. 162/2014 “Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis”. Kjo shkresë, i drejtohet Drejtorit të AAC i cili e ka nënshkruar me shënimin të veprohet “Sipas propozimit dhe ligjit”. Grupi i ngritur për hartimin e specifikimeve teknike, nuk ka në përbërje të tij specialist me profesion jurist. Profesionet e anëtarëve të grupit të hartimit të specifikimeve teknike, janë inxhinier dhe ekonomist. Pra gjykimi për vendosjen e bazës ligjore në këtë procedurë, i takon njësisë së prokurimit e cila ka në përbërje të saj, specialistë me profesion jurist. Ligji i përmendur në procesverbalin e mbajtur për hartimin e specifikimeve teknike, ka si objekt veprimtarie përcaktimin dhe vendosjen e vlerave kufi, pragut të alarmit, pragut të informacionit dhe vlerave të synuara për disa lloje ndotësish në ajër, të listuar në aneksin I, bashkëlidhur këtij ligji. Referuar anekseve të ligjit të mësipërm, konstatohet se ky ligj, ka si qëllim, monitorimin e cilësisë së ajrit nga institucionet përkatëse duke mbledhur informacione sipas zonave lokale, rajonale ose kombëtare me qëllim marrjen e masave për përmirësimin e cilësisë së ajrit. Pra, ky ligj, nuk i referohet në asnjë rast Autoriteteve Kontraktore duke i detyruar ato që në blerjen e mallrave ti referohen atij dhe jo ligjit të prokurimit publik, sidomos në blerjen e automjeteve ku institucioni përgjegjës për kontrollin e shkarkimeve në atmosferë të automjeteve, është S.G.de S. (SGS). Për më tepër, operatorët ekonomik që kanë në aktivitetin e tyre, shitjen e mjeteve të transportit, janë të detyruar që për çdo mjet të ri, të respektojnë standardet teknike të kufijve të lejuar të gazrave që shkarkojnë në atmosferë automjetet gjatë funksionimit të tyre.

Rekomandimi 5.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në kryerjen e procedurave të

prokurimit, ti referohen ligjit të prokurimit publik me qëllim rritjen e efijensës dhe efikasitetit, për të nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën.

Në vijimësi

*-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”. Është parashikuar në planin e punës që të kihet parasysh në të ardhmen. **Rekomandimi është zbatuar.***

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se AAC ka dhënë për periudhën e auditimit shpërblim të veçantë për punonjësit e saj, në dhjetor të vitit 2018, në vlerën 7,487,204 lekë, dhe për 6-mujorin e parë të vitit 2019, një shpërblim për punë të mirë në shumën 7,147,932 lekë. Shpërblimi i dhënë në 2019 është paguar vetëm me urdhra të brendshëm të Drejtorit Ekzekutiv, pa marrë miratim nga Këshillit Drejtues pa miratimin e Ministrit të linjës, ose pa respektuar ligjin nr. 10233, nenin 18, pikën 3, datë 11.2.2010 dhe ligjin nr. 10405, datë 24.03.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, si dhe janë përballuar nga fondi i mbetur i planifikuar i zërit “Shpërblime personeli”. Në këtë kuptim, vlera prej **7,147,932 lekë** e përfituar nga punonjësit e AAC si shpërblim për performancë pozitive në gjashtë mujorin e parë të vitit 2019 do të konsiderohet me efekt financiar negativ në buxhetin e saj.

Rekomandimi 6.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në dhënien e shpërblimeve të veçanta punonjësve në fund të vitit, të marrin paraprakisht miratimin nga Këshilli Drejtues dhe Ministri i MIE.

Në vijimësi

*-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar.***

7. Gjetje nga auditimi: Me shkresën nr. 777 prot., datë 16.04.2018, Organi Shtetëror i Autorizuar, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë të përfaqësuar nga ministrat përkatës, i dërgojnë Drejtorit të AAC K. K. , një kërkesë “Mbi mbulimin e shpenzimeve të këshilltarit financiar të kualifikuar, në kuadër të rishikimit të pavarur ekonomik të kontratës koncesionare me “T.” SHPK tek e cila midis të tjerash kërkohet mbulimi i kostove të vlerësimit të pavarur nga një këshilltar i përshtatshëm financiar i kualifikuar duke e urdhëruar AAC që procedura e përzgjedhjes, duke përfshirë edhe njoftimet e nevojshme të ndiqen nga AAC në përputhje me legjislacionin në fuqi. Referuar Ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004 Për ratifikimin e marrëveshjes së koncesionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe shoqërisë koncesionare “T. A. P.”, SHPK, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e aeroportit ndërkombëtar “Nënë Tereza”, Tiranë dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj shoqërie koncesionare, Organi Shtetëror i Autorizuar nga Qeveria Shqiptare (MIE dhe MFE), sipas nenit 8 të kontratës koncesionare, është palë në kontratën koncesionare me koncesionarin “T. A. P.”, SHPK dhe asnjë institucion apo organ tjetër nuk është i autorizuar për mbulimin e kostove e sidomos të rishikimit të pozicionit ekonomik të koncesionit sipas klauzolës nr. 19.4, pika (a) të kontratës koncesionare ku përcaktohet se kostoja e një vlerësimi të tillë (Rishikimi i Pavarur) i ngarkohet palës që e kërkon një Rishikim të tillë të Pavarur. Për më tepër referuar dhe nenit 34 të kontratës koncesionare lidhur me konfidencialitetin apo nenit 37.15 lidhur me të drejtat e palëve, asnjë palë tjetër nuk mund të ketë akses në asnjë dokument apo pjesë që ka lidhje me kontratën koncesionare pa miratimin e palëve nënshkruese të kontratës. Organi Shtetëror i Autorizuar (MIE dhe MFE) duhej të mbulonin vetë koston për një rishikim të pavarur të kontratës koncesionare dhe jo të kërkonin mbulimin e

kostos nga AAC. Mbulimi i shpenzimeve në këtë rast e kthen institucionin e AAC-së në rolin e një banke financuese që jep grante, duke sjellë rritje të shpenzimeve për institucionin.

Rekomandimi 7.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masat që në të ardhmen, të analizojnë kërkesat për financim të ardhura nga MIE dhe në çdo rast të kihet parasysh që ato të përmbushen vetëm nëse janë në interes të AAC-së, si dhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH, ky rekomandim nuk është pranuar. Rekomandimi nuk është pranuar.

8. Gjetje nga auditimi: Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e prokurimit me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare të TIA”, u konstatua se:

-Procedura e prokurimit me objektin e mësipërm, nuk ka qenë e parashikuar në regjistrin e parashikimeve të prokurimeve publike për AAC në vitin 2018, regjistër i cili është miratuar në programin ekonomik financiar nga Këshilli Drejtues i AAC me vendimin nr. 80, datë 21.12.2017, nr. 352 prot. Ndryshimet e programit ekonomik financiar të vitit 2018, janë miratuar me vendimin nr. 6, datë 24.05.2018, nr. 22 prot., tek i cili është shtuar nën zëri “Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA” tek zëri Aktive të patrupëzuara. Në vazhdim, regjistri i prokurimeve publike për vitin 2018 me ndryshimet e tij, është reflektuar në APP, në datën 26.06.2018. Kjo në fakt, duhej të ishte data, pas së cilës, AAC mund të ndërmerre ndonjë veprim për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e specifikimeve teknike për procedurën e prokurimit të shtuar në regjistër pas ndryshimeve të miratuara nga Këshilli Drejtues i AAC. Drejtori i AAC, ka filluar procedurën për përgatitjen e specifikimeve teknike duke lidhur edhe një kontratë me një ekspert të jashtëm në funksion të procedurës së prokurimit me objekt “Konsulencë vlerësim i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare TIA”, pa u miratuar më parë nga Këshilli Drejtues dhe APP.

-Procedura e prokurimit me objektin e mësipërm, lloji “Shërbim Konsulencë”, është iniciuar dhe anuluar dy herë radhazi. Konkretisht, është iniciuar për herë të parë me urdhrin e prokurimit nr. 1208 prot., datë 27.06.2018 dhe është anuluar për mungesë konkurrence. Është iniciuar përsëri me të njëjtin objekt dhe lloj procedure sipas urdhrin të prokurimit me nr. 1330 prot., datë 17.07.2018 dhe është anuluar përsëri për mungesë konkurrence. Njësia e prokurimit nuk ka analizuar/rishqyrtuar asnjë kriter të vendosur në DST por është shprehur në procesverbalet e mbajtura për të dyja anulimet me të njëjtin tekst, pra që nuk ka konkurrencë. Njësia e prokurimit, nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për të rritur konkurrencën por pa asnjë analizë dhe propozim të ndonjë ndryshimi në kriteret e kualifikimit, ka propozuar ri shpalljen e të njëjtave kriteret që nuk dhanë asnjë rezultat dy herë radhazi si pasojë e mungesës së konkurrencës.

-Gjatë zbatimit të kontratës (së procedurës së mësipërme) nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018 të lidhur midis palëve, u konstatuan vonesa jashtë afateve të përcaktuara sipas nenit 4 të kontratës së lidhur. AAC, në datën 20.12.2018, datë në të cilën duhej të përfundonte kontrata bazë, ka lidhur një kontratë shtesë duke e zgjatur afatin e kontratës bazë me 15 ditë pune ose me datë përfundimi datën 15.01.2019. Operatori ekonomik “B. A.” SHPK, ka dorëzuar raportin përfundimtar me 15 ditë vonesë referuar afateve të kontratës bazë. Zgjatja e afatit të kontratës bazë, sipas amendamentit nr. 1609/15 prot., datë 20.12.2018, ka ardhur si rezultat i vonesave të dorëzimit të dokumentacionit nga TIA. AAC, referuar nenit 6 të kushteve të veçanta të kontratës

bazë (Në pikën 6 të termave të referencës, përcaktohet se “AK duhet të marrë masat për pajisjen e kontraktorit me dokumentacionin, raportet dhe informacionet e nevojshme që lidhen me përmbushjen e misionit”), duhej të merrte masat që brenda 3 ditëve nga data e lidhjes së kontratës bazë pra nga data 15.10.2018, të vinte në dispozicion të operatorit ekonomik, dokumentacionin dhe informacionet përkatëse për fillimin e zbatimit të kontratës me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare”.

Rekomandimi 8.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, procedurat e prokurimit të paparashikuara, të fillojnë vetëm pasi të merret miratimi përkatës nga KD e në vazhdim, publikimi i regjistrit të ndryshuar të parashikimeve të procedurave të prokurimit në sistemin e prokurimit elektronik.

Në vijimësi

Rekomandimi 8.2: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa që në të ardhmen, për procedurat e prokurimit të anuluar, të analizojnë shkaqet e dështimit të procedurës së prokurimit duke reflektuar ndryshimet në dokumentet standarde të tenderit, me qëllim rritjen e konkurrencës.

Në vijimësi

Rekomandimi 8.3: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të respektohen kriteret e vendosura në DST dhe në kontratë dhe që kanë të bëjnë me afatet e ekzekutimit të shërbimit, me qëllim që ti paraprihet vonesave të paparashikuara të ekzekutimit të kontratave.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimet 8.1, 8.2 dhe 8.3 nuk janë pranuar.**

9. Gjetje nga auditimi. Me shkresën nr. 1023 prot., datë 22.05.2019, drejtori i AAC i dërgon kërkesën për mundësinë e ofrimit të shërbimit me roje të godinës së AAC-së, administratorit të shoqërisë “I. G.” SHA, për dijëni Sekretarit të Përgjithshëm të MB. Me shkresën nr. 1023/1 prot., datë 06.06.2019, “I. G.” SHA, i dërgon përgjigje Drejtorit të AAC duke cilësuar se shoqëria, do të jetë gati për ofrimin e shërbimit të ruajtjes fizike të godinës së AAC, në datën 15.06.2019. Me shkresën nr. 1378 prot., datë 12.07.2019, Drejtori i AAC, nxjerr urdhrin për përllogaritjen e vlerës së fondit limit duke u drejtuar tek shoqëria “I. G.” SHA, për ofrimin e shërbimit si organ i ngarkuar me VKM. Vlera e fondit limit të përllogaritur është 5,514,048 lekë pa TVSH. Në vazhdim, është nënshkruar kontrata me objekt “Shërbim i ruajtjes dhe sigurisë fizike të AAC”, në datën 17.07.2019 midis AAC me përfaqësues K. K. dhe “I. G.” SHPK me përfaqësues administratorin H. E. . Vlera e kontratës është 6,616,857 lekë me TVSH me afat 1 vit nga data e lidhjes. Kjo kontratë është nënshkruar pa ndjekur hapat konform ligjit dhe rregullave të prokurimit publik duke vendosur vetë Drejtori Ekzekutiv për përzgjedhjen e operatorit/shoqërisë që do të ofrojë shërbimin e ruajtjes së godinës së AAC dhe duke nënshkruar një kontratë në mënyrë të drejtpërdrejtë. Vlera e kontratës së lidhur pa TVSH është 5,514,048 lekë vlerë e cila krahasuar me kontratën e mëparshme me të njëjtin objekt dhe për të njëjtat kushte, është 3,344,857.7 lekë më e lartë. Për arsye se deri në këto momente, nuk u konstatua asnjë likuidim në favor të shoqërisë “I. G.” SHPK, grupi i auditimit nuk mund të shprehet për ndonjë vlerë të shpenzuar me efekt negativ financiar për AAC por, efekti i mundshëm është sa diferenca e vlerave midis dy kontratave.

Rekomandimi 9.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masa, që në të ardhmen, të nënshkruhen kontrata vetëm me ata operatorë ekonomikë që janë shpallur fitues nga një procedurë prokurimi në konformitet të plotë me ligjin e AAC dhe të prokurimit publik, pavarësisht faktit se shoqëria "I. G." SHPK, është shoqëri publike. Në të ardhmen, favorizimi i kësaj kompanie publike, kërkon një rregullim ligjor, i cili nuk është kompetencë e Drejtorit të AAC.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH", ky rekomandim nuk është pranuar. Rekomandimi nuk është pranuar.

10. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të procesit të inventarizimit rezultoi se inventarizimi i aktiveve të Aeroportit të Kukësit për vitin 2018, është bërë në aspektin sasior pa vlerat kontabël përkatëse të tyre. Ky konstatim është evidentuar edhe nga auditimet e mëparshme por përsëri rezulton se nuk është kryer asnjëherë një vlerësim i aseteve të tij. Pas relacionit të hartuar nga komisioni përkatës i cili ka kryer procesin e inventarizimit, nga titullari i AAC nuk ka asnjë vendimmarrje për vlerësimin e tyre, në mospërputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, neni 57. Gjithashtu vlen të përmendet që ky Aeroport është dhënë me konçension dhe asetet e tij janë dorëzuar në numër por pa vlerat përkatëse kontabël.

Rekomandimi 10.1: Këshilli Drejtues, Autoriteti i Aviacionit Civil dhe Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura që aktivet e Aeroportit të Kukësit, të vlerësohen dhe të evidentohen me vlerën e duhur në kontabilitet në të ardhmen pasi, aktualisht ky aeroport është dhënë me konçension. Gjithashtu të informohet Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për këtë situatë.

Menjëherë dhe në vijimësi

-Me shkresën nr. 8/2 prot., datë 04.10.2019 Autoriteti i Aviacionit Civil, drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për të caktuar një vlerësues të aseteve të Aeroportit të Kukësit. Me shkresën nr. 8700/1 prot., datë 07.11.2019 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë janë emëruar 2 ekspert vlerësues të pavarur dhe 1 auditues ligjor. Me shkresën nr. 884/2 prot., datë 19.06.2020 është dërguar pranë Autoritetit të Aviacionit Civil Tiranë, Raporti i Audituesve Ligjor për Auditimin e Pasqyrave Financiare për vitin 2019. Rekomandimi është zbatuar.

11. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018 rezulton se, Autoriteti i Aviacionit Civil, nuk ka hartuar regjistër kontabël të përditësuar të aktiveve që zotëron apo ka në administrim, i cili në varësi të llojit duhet të përmbajë kërkesat minimale në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 26-33.

Rekomandimi 11.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat e duhura për krijimin dhe përditësimin e regjistrit të aktiveve të AAC, në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH-së në auditimin në vijim.

Rekomandimi është zbatuar.

12. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të kryerjes së procesit të inventarizimit për vitin 2018, rezultoi se, në komisionin e ngritur nga Titullari i AAC në cilësinë e nëpunësit Autorizues, janë caktuar nëpunës të cilët kanë aktive materiale në ngarkim/përdorim dhe kanë

nënshkruar në kushtet e konfliktit të interesit, aktet e mbajtura për procesin e kryerjes së inventarizimit, në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", i ndryshuar, neni 8, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 81-82.

Rekomandimi 12.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në procesin e inventarizimit, me qëllim shmangien e konfliktit të interesit, përbërja e komisioneve të jetë në përputhje me kuadrin regullativ ligjor.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH-së në auditimin në vijim.

Rekomandimi është zbatuar.

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të pasqyrave financiare për vitin 2018, konstatohet se, mungon formati i pasqyrës nr. 5, relacioni dhe shënimet shpjeguese që shoqërojnë pasqyrat financiare pasi, në formatin nr. 1-4, të dhënat paraqiten thjeshtë, me informacion të përgjithshëm, mungojnë sqarime të nevojshme për ecurinë e zërave të pasqyrave financiare. Mungojnë tërësisht shpjegimet dhe analiza e pasqyrës së flukseve monetare, pasqyrat statistikore nr. 1, për investimet dhe burimet e financimit, pasqyra nr. 2/1, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike), pasqyra nr. 2/2, gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (vlera neto), pasqyra statistikore nr. 3, numri i punonjësve dhe fondi i pagave si dhe shënimet shpjeguese të këtyre pasqyrave. Veprime dhe mosveprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10233, datë 11.0.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar, nenin 19, me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit, SKK 1 "Kuadri i Përgjithshëm për Përgatitjen e Pasqyrave Financiare", pika 67, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", kreu III, pika 25, Aneksi 2.

Rekomandimi 13.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit të marrin masat që, gjatë hartimit të pasqyrave financiare, ato të përfshijnë të gjitha formatet e tyre sipas përcaktimeve ligjore, duke siguruar të dhëna dhe informacione të plota shpjeguese për përdoruesit e tyre.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH-së në auditimin në vijim.

Rekomandimi është zbatuar.

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të transferimeve kapitale të AAC, konstatohet se: Janë kryer dy transferime kapitale (automjete), konkretisht automjeti me nr. TM.AG6NE1E01..696 të shasisë, ngjyra e zezë, viti i prodhimit 2014, me kapacitet 4+1 vende, me targë AA415IZ, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë i cili është transferuar në Institucionin e Avokatit të Shtetit dhe automjeti me nr. TM.A6NEXE01..829 të shasisë me targë AA.27IZ me ngjyrë të zezë, vit prodhimi 2014, me naftë, me kapacitet 4+1 vende, me vlerë kontabël 3,214,800 lekë, i cili është transferuar tek MIE. Në të dy rastet për transferimin kapital të automjeteve, rezultoi se, në dosjet e transferimit, nuk ka akte respektive të konfirmimeve të cilat duhet të bëheshin për dërguesin brenda datës 20 të muajit pas ardhës të cilat dhe të nënshkruheshin nga nëpunësi autorizues e zbatues i njësisë pritëse. Gjithashtu nga Organet drejtuese të Autoritetit nuk është kryer ndonjë vlerësim për to, të cilat të jenë konsideruar të panevojshme përkohësisht për njësinë apo të jenë të papërdorshme nga AAC, për më tepër që gjatë vitit 2019 institucioni ka kryer procedurë prokurimi për blerjen e dy automjete të tjera të

reja me fond limit në vlerën 6,216,575 lekë pa TVSH, me argumentin si nevojë për aktivitetin e saj. Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, Urdhri i Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56, pika 108.

Rekomandimi 14.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa që në të ardhmen, në rastet e transferimeve kapitale, të kërkohet dhe plotësohet praktika me dokumentacionin përkatës sipas kuadrit ligjor.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH^{së} në auditimin në vijim. Referuar periudhës së auditimit, nga AAC është kryer 1(një) transferim kapital me objekt “Fikse zjarri” dhe praktika e ndjekur është plotësuar me dokumentacionin përkatës, që nga justifikimi i transferimit mbi nevojën/jo të përdorimit të tyre, vlerësimin, vendimin e këshillit Drejtues, ngritja e grupit të punës, miratimi nga Ministri i linjës e deri në marrjen në dorëzim nga institucioni përfitues. Rekomandimi është zbatuar.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dosjes së prokurimit për procedurën me vlerë të vogël, me objekt “Blerje vegla pune për Aeroportin e Kukësit”, u konstatua se me shkresën nr. 62 prot., datë 09.01.2018 Drejtori i Aeroportit të Kukësit i drejtohet Drejtorit Ekzekutiv të AAC-së, kërkesë për vegla pune bashkëngjitur ndodhet lista dhe preventivi i këtyre veglave. Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e Titullarit të Autoritetit Kontraktor nuk ka nxjerrë, urdhër prokurimi për fillimin e procedurës së prokurimit dhe urdhër për ngritjen e komisionit për marrjen në dorëzim të mallrave. Gjithsesi, mallrat janë bërë hyrje në magazinën e AAC-së, me fletë-hyrjen nr. 38, datë 31.08.2018 dhe dalje nga AAC me destinacion Aeroportin e Kukësit sipas fletë-daljes nr. 125, datë 31.08.2018. Për Aeroportin e Kukësit, mallrat janë marrë në dorëzim nga stafi i aeroportit. Vlera prej 83,300 lekë, është likuiduar nga AAC për llogari operatorit ekonomik sipas faturës nr. 21, datë 31.08.2018.

Rekomandimi 15.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masat, që për procedurat e prokurimit me vlera të vogla, të plotësohet dokumentacioni vërtetues i kryerjes së procedurës, në mënyrë që të justifikohet shpenzimi i kryer.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH^{së} në auditimin në vijim.

Rekomandimi është zbatuar.

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për hartimin dhe miratimin e buxhetit të viteve 2018 dhe 2019, u konstatua se Drejtori i AAC dhe Këshilli Drejtues nuk kanë bashkëpunuar paraprakisht, përpara datës së mbledhjes së KD, për studimin e Projekt Programit Ekonomik pasi, Këshilli Drejtues e ka marrë relacionin e Drejtorit të AAC-së për Projekt Buxhetin, në të njëjtën ditë që edhe e ka miratuar Vendimin për Buxhetin e Autoritetit për vitin 2018 me vendimin nr. 80, datë 21.12.2017, pra si një proces formal, duke mos respektuar kështu parimet e Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar.

Rekomandimi 16.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që të përcaktojnë në Rregulloren e tyre afatin, brenda një date të caktuar, për dorëzimin e Projekt Buxhetit në Këshillin Drejtues, disa ditë përpara se ai të mblidhet për shqyrtimin e tij.

Në vijimësi

-Në lidhje me këtë rekomandim, afatet për miratimin e programit financiar të AAC, janë përcaktuar në Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", i ndryshuar, neni 18 "Buxheti". Nga auditimi i kryer për vitet 2020 dhe 2021, konstatohet se miratimi i projekt programit ekonomik, në Këshillin Drejtues është kryer në datat 26.11.2020 dhe 22.12.2020, pra brenda afateve ligjore. **Rekomandimi është zbatuar.**

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumenteve të vëna në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se niveli i pagave të AAC është i ndryshëm nga niveli i pagave të institucioneve të tjera të ngjashme që përfshihen në legjislacionin e shërbimit civil.

Rekomandimi 17.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë ndryshime ligjore, me qëllim përshtatjen e nivelit të pagave të punonjësve të AAC me nivelin e pagave të punonjësve të institucioneve të tjera të ngjashme me AAC, konform me ligjin nr. 152, datë 26.02.2013 "Për nëpunësit civil", ose të përshtaten në ligjin funksional të AAC-së, niveli i pagave të tyre.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH", ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar**

18. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se për 3(tre) punonjës të AAC-së, nuk është aprovuar marrja e statusit brenda periudhës ligjore sipas kuptimit të nenit 67 të Ligjit nr. 152, "Për nëpunësin civil", datë 26.02.2013, si edhe në kundërshtim me ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë" me gjithë ndryshimet përkatëse dhe pika 2 e nenit 16, të Ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 "Për Aviacionin Civil", i ndryshuar.

Rekomandimi 18.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masat, që në të ardhmen, për të gjitha rastet, të revokohet akti i mëparshëm i deklaramit të statusit të punësimit dhe të nxirret akti i deklaramit të punësimit si Nëpunës Civil në periudhë prove.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH", ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar.**

19. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se ka pasur 2 raste të ndryshimit të strukturës së punonjësve të AAC. Konkretisht, me Vendimin nr. 79, datë 21.12.2017, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 69 punonjës dhe me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2018, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 73 punonjës. Këto vendime, janë miratuar nga Ministri i MIE përkatësisht me shkresat nr. 3868/5, datë 16.02.2018 dhe Urdhrin nr. 2, datë 11.01.2019. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës në organikë duke tejkaluar në mënyrë të parregullt me numrin e punonjësve me 17 punonjës. Struktura është ndryshuar pas arsytimit me Relacion nga ana e Drejtorit të AAC por të dy rastet nuk janë miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 17.12.2014, neni 30.

Rekomandimi 19.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen, të kërkojnë miratimin e strukturës nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Ministria e Financave dhe të implementojë vetëm strukturën e miratuar ligjërisht.

Në vijimësi

Rekomandimi 19.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 19.1 më lart të KLSH, të verifikojë dëmin ekonomik të konstatuar në lidhje me këtë pikë jo vetëm për periudhën e auditimit por edhe përpara kësaj periudhe.

Menjëherë

*-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”. Me shkresën nr. 7957/1, datë 24.11.2020 nga MIE është dërguar për mendim struktura dhe organika e AAC. Me shkresën nr. 6220/1, datë 26.11.2020 është kthyer përgjigje nga Departamenti i Administratës Publike, ku shprehet dakord me kompozimin e strukturës dhe organikës së AAC, sipas njërive organike të propozuara. Miratimi i strukturës është bërë me urdhrin nr. 359, datë 18.12.2020. Me shkresën nr. 351, datë 01.03.2021, është dërguar vendimi i komisionit për ristrukturimin e AAC nr. 34/1, prot, datë 10.02.2021. **Rekomandimi 19.1 është zbatuar dhe 19.2 nuk është pranuar.***

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit dhe Rregulloreve me të cilat ka punuar AAC u konstatua se Autoriteti nuk i ka pasqyruar (deri në miratimin e Rregullores në fuqi në datën 12.06.2019) në këtë dokument ndryshimet strukturore të realizuara pas 2 vendimeve përkatëse të KD dhe Ministrisë të MIE të përmendura më lart. Nga auditimi u konstatua se ndërhyrja në Rregulloren e parë nuk ishte bërë në harmonizim me strukturën e saj, duke përshtatur në disa raste vetëm përshkrimin e vendit të ri në strukturë tek Aneksat, pa respektuar hierarkinë e ligjit për të përshtatur së pari Rregulloren dhe pastaj aneksat e saj duke mos respektuar përcaktimet e sanksionuara në Ligji nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, neni 27. AAC ka hartuar dhe miratuar Rregulloren në fuqi me Vendimin nr. 5, datë 13.06.2019 me një vonesë prej mbi 5 muajsh nga miratimi i strukturës në fuqi nga Ministri me Urdhrin nr. 2 datë 11.01.2019.

Rekomandimi 20.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masa që në të ardhmen, para se të miratojnë e zbatojnë një strukturë të re duhet të përshtatin Rregulloren e brendshme me vendet e reja në organigramë.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga grupi i KLSH-së në auditimin në vijim.

Rekomandimi është zbatuar.

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me zgjedhje i listë pagesave të vëna në dispozicion nga sektori i financës u verifikua se për drejtuesin dhe punonjësit e tjerë të Aeroportit të Kukësit, nuk janë paguar kontributet për sigurimin suplementar, në kundërshtim me Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, Ligjin nr. 104/2014, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë, VKM nr. 343 datë 04.6.2006 neni 1 dhe 2, Udhëzimi i përbashkët mes Ministrisë të Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë të Financave nr. 2127/4, datë 07.7.2014, “Për administrimin e Aeroportit të Kukësit”, Rregulloren “Për pensionet vullnetare të punëdhënësit”, miratuar me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016.

Rekomandimi 21.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të shqyrtojnë të gjitha rastet e mos përfshirjes në skemën e kontributeve për sigurimin suplementar të punonjësve duke i përfshirë ata sipas rastit në këtë skemë, të llogaritet sa është masa e kontributit të secilit punonjës, si dhe të marrë masat për derdhjen e këtyre kontributeve.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar.**

22. Gjetje nga auditimi: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtori Ekzekutiv në cilësinë e nëpunësit autorizues, nuk ka hartuar strategjinë e riskut. Nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatis raporte vjetore mbi problematikat e hasura. Regjistrat e riskut janë mbajtur pjesërisht, jo në përputhje me formatin rregullativ ligjor.

Gjithashtu, Drejtori i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk ka nxjerrë urdhër, për hartimin e gjurmës së auditit, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme. Gjurma e auditit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces.

Rekomandimi 22.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për hartimin e strategjisë së riskut, ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik dhe krijimin e regjistratit të riskut sipas përcaktimeve ligjore, si dhe të marrë masat e duhura për hartimin dhe miratimin e gjurmës së auditit, në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor.

Në vijimësi

-Me Vendimin nr. 6, datë 07.06.2019 të Drejtorit Ekzekutiv të AAC janë miratuar dokumentet e Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë, sipas sistemit ISO 9001:2015, pjesë përbërëse e tij është dhe Grupi i Rishikimit të Cilësisë i cili kryen në mënyrë të përafërt funksionet e Grupit të Menaxhimit Strategjik. **Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

23. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të zbatimit të Rekomandimeve rezultoi se: Në lidhje me Ndryshime dhe Përmirësime Legjislacioni, janë rekomanduar 2 (dy) masa: 2 (dy) masa realizuar pjesërisht. Në lidhje me Masa Organizative, janë rekomanduar 11 (njëmbëdhjetë) masa, 9 (nëntë) masa të realizuara, 1 (një) masë nuk është zbatuar, 1 (një) masë në proces. Në lidhje me Masa për Shpërblim Dëmi, janë rekomanduar 21 (njëzetë e një) masa në vlerën 259,424 mijë lekë: 8 (tetë) masa nuk janë pranuar, 6 (gjashtë) masa janë zbatuar, 3 (tre) masa janë në proces dhe 4 (katër) janë zbatuar pjesërisht. Masa për dëm potencialisht të mundshëm nga 6 masa, 2(dy) janë zbatuar, 1(një) nuk është pranuar dhe 4(katër) janë në proces.

-Në lidhje me masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike, janë rekomanduar 7 (shtatë) masa: 1 (një) masë nuk është pranuar, 6 (gjashtë) masa janë zbatuar.

-Në lidhje me Masat Displimore, janë rekomanduar 6 (gjashtë) masa: 5 (pesë) masa të realizuara, 1 (një) masë pa pranuar.

Rekomandimi 23.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e duhura për zbatimin e plotë të rekomandimeve të lëna nga KLSH në auditimin e kaluar.

Në vijimësi

-Rekomandimet e KLSH-së, janë dërguar me shkresën nr. 1312/24, datë 02.05.2019.

Niveli i zbatimit të rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa pranuar	Në proces	Pjesërisht
Përmirësim legjislacioni	2				2
Masa Organizative	11	9	1	1	
Masa Shpërblim dëmi	21	6	8	3	4
Dëm potencialisht i mundshëm	6	2	1	4	
Eliminimi Efekteve negative	7	6	1		

Masa Disiplinore	6	5	1		
Total	53	28	12	8	6

Rekomandimi është në proces zbatimi.

Realizimi i rekomandimeve paraqitet në nivelin 53%.

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 2 masa për shpërblim dëmi përkatësisht:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me procedurën e marrjes me qira nga Autoriteti i Aviacionit Civil, të ambienteve për zyra tek Tir. Bus. Pa. , u konstatua se AAC me përfaqësues K. K., dhe Tir. Bus. Pa. me përfaqësues Stephanie Alexandra, kanë nënshkruar një kontratë për marrje ambientesh me qira në total 973.7 metra katror (sipërfaqe bruto) sipas nenit 1, pikës 1.1.1 të kontratës me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018. Për auditimin e kësaj çështjeje, grupi i auditimit, i është referuar vendimeve të marra nga KD, relacioneve nga Drejtori i AAC për KD dhe shkresave nga komunikimet e palëve të përfshira në këtë çështje.

-Relacioni nga Drejtori i AAC, drejtuar Këshillit Drejtues, është me nr. 781 prot., datë 16.04.2018. Tek ky relacion, Drejtori i AAC, në mënyrë të përmbledhur, cilëson: ***“AAC paraqet këtë propozim për mundësinë e transferimit të ambienteve të punës së AAC në një infrastrukturë më të përshtatshme duke konsideruar performancën e deritanishme të sektorit dhe zhvillimet e pritshme... Sipërfaqja totale e ndërtimit, parashikohet të jetë rreth 3600 m²”***.

-Këshilli Drejtues i AAC, me vendimin nr. 05, datë 17.04.2018, ka miratuar nismën **mbi nevojën e një godine të re** të AAC-së, pranë operatorëve dhe në një zone jo urbane.

-Sekretari i Përgjithshëm i MIE, G. K. , me shkresën nr. 1147/1 prot., datë 25.10.2018, e sqaron AAC lidhur me mundësinë e gjetjes së një toke për ndërtimin e një godine të re për institucionin, ku në vija të përgjithshme, i cilëson se: ***“...Sa më sipër, ndodhur në këto kushte dhe duke pasur parasysh nevojat e AAC për ambiente të reja, sugjerojmë që deri në miratimin e projektvendimit, AAC të marrë parasysh zgjidhjen e situatës me burimet e veta financiare”***.

-Në vazhdim, në pamundësi për gjetjen e një toke në dispozicion të AAC për ndërtimin e një godine të re për institucionin, Drejtori i AAC, i dërgon një relacion Këshillit Drejtues, duke i kërkuar transferimin me zyra me qira në ambientet e Tir. Bus. Pa. . Tek ky relacion, në vija të përgjithshme, cilësohet: ***“...nëpërmjet vendimit nr. 5, datë 18.04.2018 dhe shkresës nr. 8897/3 prot., datë 23.10.2018 nga MIE, ju paraqes kërkesën time me propozimin për lëvizje me zyra pranë Tirana International Airport”***. Me vendimin nr. 18, datë 07.11.2018, Këshilli Drejtues i AAC, ka miratuar propozimin e Drejtorit, për transferim me zyra të Aviacionit Civil për një periudhë 2 vjeçare, në qendrën e biznesit “T. B. P.” SHPK.

-Kontrata e nënshkruar midis AAC dhe TBP për marrje ambientesh me qira për zyra, është me nr. 2019/2 prot., datë 19.11.2018. AAC, ka likuiduar vlerën prej 20,252.96 Euro për llogari të qiradhënësit TBP, si garanci e cila do ti kthehej AAC pasi institucioni të merrte në dorëzim ambientet me qira.

-Shkresa me nr. 22 prot., datë **13.02.2019** TBP dhe nr. 306 prot., datë 14.02.2019 AAC, me anë të së cilës shoqëria “T. B. P.” SHPK, me shkresën nr. 306 prot., datë 14.02.2019, i kërkon AAC-së, që të merren në dorëzim zyrat sipas kontratës së qirasë së lidhur midis AAC dhe TBP me nr. 2054 Rep, nr. 419 Kol, datë 19.11.2018.

-Me shkresën nr. 1176/3 prot., datë **27.06.2019**, Drejtori i AAC, dërgon një relacion tek KD i AAC-së lidhur me kërkesat e TBP dhe parashtron si zgjidhje të vetme, mbajtjen e vlerës së garancisë prej **20,252.96 Euro** nga qiradhënësi. Me vendimin nr. 11, datë 28.06.2019, KD

vendos miratimin e zgjidhjes së kontratës së qirasë nr. 2019/2, datë 19.11.2019, ndërmjet TBP dhe AAC.

-Sa më sipër, referuar gjetjeve dhe konkluzioneve të grupit të auditimit, vlera e likuiduar nga AAC, në favor të TBP prej 20,252,96 Euro, konsiderohet dëm ekonomik për AAC/Buxhetin e Shtetit dhe duhet të dëmshpërblehet nga personat përgjegjës të cilët kanë vepruar në kundërshtim me interesat ekonomike të institucionit.

Rekomandimi 1.1: Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli Drejtues i Autoritetit të Aviacionit Civil, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Shërbimit Ligjor, të marrin masat për të analizuar shkaqet dhe personat përgjegjës për dëmin ekonomik që i kanë sjellë AAC/Buxhetit të Shtetit dhe në vazhdim, nga personat përgjegjës, të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, **arkëtimi i vlerës 20,252,96 Euro**, vlerë e konsideruar dëm ekonomik dhe që i përket garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP.

Menjëherë

*-Me urdhrin nr. 127, datë 02.03.2020 me shkresën nr. 556/1 prot., datë 02.03.2020 të Drejtorit Ekzekutiv është një grup pune për analizimin e gjetjes, është marrë vendimi nr.8, datë 30.07.2020, “Për miratimin e masave përmirësuese që rezultojnë nga analiza e shkaqeve që kanë krijuar gjetjet e KLSH-së”. Ndërsa rekomandimi i KLSH nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar.***

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, me urdhër transfertën bankare të datës 23.11.2018, është likuiduar fatura tatimore nr. 32, datë 30.10.2018, për gërmime dheu, ndaj operatorit “K.-B.M.E.” ShPK., në vlerën 66,000 lekë me TVSH, faturë e cila është nënshkruar nga vetë Drejtori Ekzekutiv dhe komisioni i blerjeve të vogla. Është mbajtur procesverbal nga K. K. , K. K. dhe P. R. më datë 30.10.2018, në të cilin citohet se “...pas kontaktit me përfaqësues të Kryeministrit të cilët kërkuan nga AAC-ja, në rolin e palës negociatore të asistojë ekspertët turq të C. Hol. Gr. si dhe të mbulojnë shpenzimet e verifikimit të përbërjes gjeologjike të tokës ku do të ndërtohet Aeroporti i Vlorës, nëse është në përputhje me të dhënat e fizibilitetit të Aeroportit të Jugut”. Ky shpenzim është i pa justifikuar pasi nuk ka asnjë dokumentacion vërtetues dhe justifikues, nuk ka asnjë kërkesë zyrtare për këtë veprim, nuk ka asnjë dokument për vendin ku është kryer verifikimi, nuk ka asnjë dokumentacion mbi planimetrinë, skicat apo vizatime për kryerjen e këtyre punimeve, nga të cilat dalin sasitë dhe volumet e punimeve, dhe shuma prej 66,000 lekë, konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e AAC. Veprime këto në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, neni 5, me ligjin nr. 10296, datë 10.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, nenet 2, 3, 8/1, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pika 35/a/b, pika 36, pika 56.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të kërkojnë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjyqimit, arkëtimin e shumës **66,000 lekë**, nga Drejtori i AAC K. K. .

Menjëherë

*-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar***

C. I. DËM EKONOMIK POTENCIALISHT I MUNDSHËM NËSE NUK PLOTËSOHET ME DOKUMENTACION MBËSHTETËS

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me Vendimin nr. 10, datë 31.07.2018, me anë të të cilit, Këshilli Drejtues i AAC miraton ndryshimet në programin ekonomik për vitin 2018, duke shtuar zërin investime për pagesën e konsulentit të kompanisë “R. B. GM.H”, i cili do të asistojë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Çe. Cons. & Kal. & Kol. Con. , sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: *“...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qenë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”*. Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “R. B.” GM.H, u konstatua se: Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhirimit të B.T, dega me kod 5.5, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “R. B.” GM.H në Deu. Bank, Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është e njëjtë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Gjithashtu, bashkangjitur urdhër xhirimit dhe faturës, është procesverbali i mbajtur nga grupi i negocimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 76,300 euro, nuk është e justifikuar me dokumente dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Rekomandimi 1.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “R. B.” GM.H, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 76,300 Euro nga operatori ekonomik “R. B.” GM.H**, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me nenin 6.1 të kontratës së lidhur.

Menjëherë

Rekomandimi 1.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 1.1 më lart të KLSH, të verifikojë plotësinë e dokumentacionit mbështetës për të vërtetuar kryerjen dhe ekzekutimin e shërbimit nga operatori ekonomik “R. B.” GM.H, sipas kushteve të kontratës së lidhur midis MIE dhe këtij operatori.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 566 prot., datë 02.03.2020 dhe urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 126, datë 02.03.2020, është ngritur grup pune për analizën e kësaj gjetje, ku është përgatitur dhe një relacion. Nga MIE, janë paraqitur dokumentet për kryerjen e pagesës pra, shkresa që konfirmon kryerjen e shërbimit. Sa i takon kryerjes së një auditimi, rezulton se nuk ka një të tillë.
Rekomandimi 1.1 është zbatuar, ndërsa 1.2 nuk është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: *“Rishikim i pavarur*

ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se operatori ekonomik “B. A.” SHPK, nuk ka dorëzuar pranë AAC, dokumentacion që vërteton angazhimin e ekspertëve të huaj të deklaruar në formularin e ofertës sipas ditëve dhe kohës së tyre të punës por edhe shpenzimet e rimbursueshme të likuiduara nga AAC lidhur me kostot e transportit ndërkombëtar dhe hotelet apo dietat. Nuk ka në dosjen e zbatimit të kontratës, asnjë dokumentacion që vërteton se ekspertët e huaj të angazhuar në zbatimin e kontratës me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”, kanë qenë prezent në Shqipëri gjatë ekzekutimit të kontratës, kanë udhëtuar, akomoduar në hotel dhe punuar në ambientet e përcaktuara sipas kontratës së lidhur dhe konkretisht kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, nenit nr. 5 të Kushteve të Veçanta, pika 5.1 ku cilësohet se: “*Shërbimet do të kryhen në zyrat e administratës Tirana International Aeroport Rinas, Tiranë, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1, P.O Box 205, Tiranë, Shqipëri ose zyrat e kontraktuesit sipas rastit*” dhe pikës 3.2, të seksionit “Profil i operatorit ekonomik” të kontratës së lidhur, vendndodhja dhe ekzekutimi ku cilësohet se: “*Ekipi i ekspertëve të kontraktorit, do të kryejë detyrën në Tiranë, Republika e Shqipërisë*”. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë sektorit të financës së AAC, konkludohet se në total, vlera e likuiduar prej **134,928 EURO**, në favor të operatorit ekonomik “B. A.” SHPK, që i përket zërave të preventivit të ofertës (për ekspertët e huaj) së dhënë nga operatori ekonomik i shpallur fitues konform shtojcës nr. 4 të Dokumenteve standarde të Tenderit dhe nenit 37 Shërbimet e Konsulencës të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pika 4, gërma a), duhet të analizohet nga AAC dhe vetëm nëse AAC nuk vërteton kryerjen e shërbimit me dokumentacion ligjor, atëherë të nxirren përgjegjësitë dhe të kërkohet kthimi i vlerës së investuar.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 134,928 EURO nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK.**

Menjëherë

Rekomandimi 2.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 2.1 më lart të KLSH, të verifikojë mangësitë e konstatuara për plotësimin e dokumentacionit mbështetës për të vërtetuar kryerjen dhe ekzekutimin e shërbimit nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK sipas kushteve të kontratës së lidhur midis AAC dhe këtij operatori.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar sepse oferta ekonomike nuk parashikon shpenzime të rimbursueshme dhe detajimin e tyre. Rekomandimi 2.1 dhe 2.2 nuk është pranuar.

C. II. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE PËR SHKAK TË PARREGULLSIVE DHE PALIGJSHMERIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Likuidimi i vlerës prej **7,774,200 lekë**, për llogari të operatorit ekonomik “T. C.” SHPK për kontratën me objekt **“Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC”**, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, e kryente prej vitesh me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: **“Asistencë teknike për hartimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë ISO për nevojat e AAC”**, lloji procedurës **“Shërbim Konsulence”**, me fond limit 6,966,189 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC në të njëjtën kohë që institucioni ka pasur struktura të ngritura sipas rregullores së brendshme për menaxhimin dhe kontrollin e cilësisë. AAC ka pasur nën përgjegjësinë e saj, edhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në termat e referencës sipas shtojcës nr. 14, të DST, REF-78854-07-11-2018, Shërbimi që kërkohet, ku cilësohet: **“Objekti i Konsulencës është rritja, konsolidimi dhe fuqizimi i kapaciteteve të AAC-së për të mbështetur ngritjen e një sistemi efikas të menaxhimit të cilësisë në AAC në përputhje me kërkesat e standardit ISO 9001:2015”**. Objektivi i Drejtorisë së Kontrollit të Cilësisë së AAC-së, ka qenë **“Monitorimi i përmbushjes së vazhdueshme të standardeve të cilësisë ISO 9001:2008”** duke nënkuptuar se përfshihen edhe standardet ISO 9001:2015, të cilat vetëm përmirësohen por nuk janë asnjëherë të ndryshme nga njëra tjetra. **Kjo vlerë e likuiduar nga AAC prej 7,774,200 lekë dhe që mund të shmangej, përbën investim me efekt negativ financiar për institucionin.**

Rekomandimi 1.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontrollit dhe Ruajtjes së Cilësisë, të bashkëpunojnë me menaxherët e cilësisë dhe organet standardizuese për akreditimin, çertifikimin e institucionit me standardet ISO.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil “Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH”, ky rekomandim nuk është pranuar. Rekomandimi nuk është pranuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt **“Blerje Automjete”**, viti 2019, me fond limit 6,216,575 lekë pa TVSH, u konstatua se:

a) Titullari i institucionit, ka nxjerr urdhrin e prokurimit pa u kryer më parë argumentimi nga strukturat përkatëse lidhur me nevojën e blerjes së automjeteve të reja. Shkresa e parë e identifikuar në dosjen e prokurimit, është ajo me nr. 762 prot., datë 17.04.2019, për ngritjen e grupit të punës për hartimin e specifikimeve teknike. Përpara kësaj shkrese, njësia e prokurimit, nuk ka në dosjen e prokurimit, asnjë argumentim lidhur me arsyet e fillimit të procedurës së prokurimit. Nga verifikimet e kryera pranë AAC, tek strukturat përkatëse u konstatua se institucioni ka pas në përdorim 5 automjete për vitin 2018 dhe konkretisht automjetet me targa: AA 4.5 IZ, AA 4.2 SU, AA 5.6 IZ, AA 4.4 DV dhe AA 5.7 IZ. Automjeti me targë AA 5.7 IZ, është transferuar tek Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë në datën 21.12.2018 dhe automjeti me targë AA 4.5 IZ, është transferuar tek Avokatura e Shtetit në datën 14.02.2019. Pra në një hark kohor prej afro 6 muaj pasi AAC dhuron dy automjete, pretendon se ka nevojë për automjete të reja. Pas datës 14.02.2019, AAC ka pasur në funksion 3 automjetet e mbetura. Si rezultat, nuk është aspak e qartë se përse AAC transferon automjetet që ka në përdorim tek institucionet e tjera duke i falur ato, pa kryer paraprakisht një vlerësim të nevojave të saj. Si rezultat, vlera e likuiduar për blerjen e dy automjeteve referuar faturave me nr. 74 dhe nr. 75, datë 03.10.2019 që në total është **7,358,400 lekë, konsiderohet investim me efekt negativ financiar për buxhetin e shtetit.**

b) Komisioni i vlerësimit të ofertave, sipas raportit përmbledhës propozon të shpallet fitues oferta më e lartë me vlerë 6,132,000 lekë pa TVSH e operatorit ekonomik “A. M. C.” SHPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i s’kualifikuar “H. A. A.” SHPK, u konstatua se të dhënat teknike të deklaruara nga KVO si mangësi, duhej të pranoheshin si devijime të vogla nga KVO edhe për faktin se operatori i shpallur fitues ka mangësi. Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik i shpallur fitues “A. M. K.” SHPK, u konstatua se ky operator në sistemin e SPE, nuk ka paraqitur në katalogun e dorëzuar, mjetet që kërkohen dhe as specifikimet teknike sipas atyre të specifikuara nga AK. Gjithashtu, vlen të përmendet se ky operator sipas tabelës së automjeteve që disponon, dhe përkatësisht në faqen 49 të katalogut të paraqitur, ka deklaruar se nuk disponon automjetet që kërkohet nga AK (HYBRID) dhe konkretisht përcaktohet se nuk disponohet automjeti: 2.0 l ivct 14 atk hev 187 PS, faza VI, hibrid elektrik, hf 35 ectv automatik. Pra, KVO, duhej ta s’kualifikonte operatorin ekonomik “A. M. K.” SHPK, për mangësi thelbësore në dokumentacionin e dorëzuar dhe jo ta kualifikonte atë. KVO duhej ta kualifikonte operatorin ekonomik “H. A. A.” SHPK me ofertën me vlerë 5,990,000 lekë si oferta më me leverdi ekonomike ose të anulonte procedurën e prokurimit për mangësi të të dy ofertave të ardhura. Diferenca e ofertave prej 142,000 lekë, konsiderohet si shpenzim në kundërshtim me parimet e ekonomicitetit, efektivitetit dhe efikasitetit të administrimit dhe përdorimit të fondeve publike.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, në fillim të kryhet vlerësimi i aktiveve dhe vetëm nëse aktivet konsiderohen të panevojshme për Autoritetin e Aviacionit Civil, atëherë mund të merret vendimi për dhurimin e tyre.

Në vijimësi

Rekomandimi 2.2: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Komisionet e Vlerësimit të ofertave, të marrin masat që në të ardhmen, të kualifikojnë vetëm ato oferta që plotësojnë kriteret e vendosura në DST dhe që janë me leverdi ekonomike për institucionin.

Në vijimësi

*-Për këtë rekomandim na u vu në dispozicion dokumentacioni i cili është hartuar për vlerësimin e aktiveve të panevojshme si edhe nga praktikat e tjera të zhvilluara në AAC (për fikse zjarri) transferuar Bashkisë Tiranë, me vendimin e KD nr.13, datë 18.12.2019. Po kështu edhe nga kvo është mbajtur në konsideratë dhe zbatuar legjislacioni në lidhje me vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë. **Rekomandimi 2.1 dhe 2.2 është zbatuar.***

3. Gjetje nga auditimi: Kontraktimi ekspertëve të jashtëm për hartimin e termave të referencës dhe për anëtar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”, ka qenë i panevojshëm pasi AAC disponon në stafin e saj, punonjës me kualifikimet dhe eksperiencat përkatëse.

a) Me shkresën pa nr. protokollit dhe datë 16.04.2018, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve të Përgjithshme Feim Godo dhe Përgjegjësja e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve . Aida Pipiko, i dërgojnë një relacion Drejtorit të AAC mbi nevojën për ekspert të jashtëm për hartimin e ToR të procedurës së prokurimit me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”.

b) Me shkresën me nr. 1208/3 prot., datë 02.07.2018, Titullari i AAC, nxjerr urdhrin për pajtimin e një eksperti të jashtëm për antar të KVO për procedurën e prokurimit me objekt “*Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s*”. Me shkresën nr. 1208/4 prot., datë

04.07.2018, Titullari i AAC, nënshkruan kontratën me ekspertin e jashtëm R. S. Në dosjen e procedurës së prokurimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion verifikues për mënyrën e përzgjedhjes së ekspertit të jashtëm si antar i KVO në ndryshim nga mënyra e përzgjedhjes së ekspertit për hartimin e DST për të cilin është shpallur vendi vakant në faqen ëeb të AAC. Kontraktimi i ekspertit të jashtëm nga Drejtori i AAC duke nënshkruar kontratën është bërë në mënyrë të drejtpërdrejtë, jo transparente dhe diskriminuese. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit dhe konkretisht të dosjeve të personelit, u konstatua se AAC në stafin e saj ka punonjës të specializuar në shkencat ekonomike me profesion ekspert kontabël të regjistruar madje edhe auditues me eksperiencë në auditimin e programeve IPA pa përmendur këtu personelin permanent të AAC i cili ka kryer prej kohësh auditim në TIA. Si rezultat, AAC nuk kishte pse të kërkonte ekspert të jashtëm me diplomë master në shkencat ekonomike apo edhe me certifikata në të njëjtën kohë që në stafin e saj ka pasur specialistë të fushave përkatëse. Të paktën, AAC duhej të respektonte radhën e përzgjedhjes së ekspertit duke kontaktuar me institucione të tjera si p.sh me MFE. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, për hartimin e termave të referencës, sipas urdhër xhirimit të Un. Ba. me nr.ref 117FTR..83620008 dhe datë 28.12.2018, është 186,150 lekë. Vlera e shpenzuar për kontraktimin e ekspertit të jashtëm, si anëtar i KVO, sipas urdhër xhirimit të bankës BK. me kod 205/1..52 dhe datë 15.02.2019, është 94,581 lekë. **Në total, vlera e shpenzuar prej 280,731 lekë, përbën shpenzim me efekt negativ financiar për AAC dhe buxhetin e shtetit.**

Rekomandimi 3.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të marrin masat që në të ardhmen, të propozojnë kontraktimin e ekspertëve të jashtëm për procedurat e prokurimit, vetëm pasi të jetë konkluduar se AAC ose dhe Autoritete të tjera Kontraktore, nuk kanë në përbërje të strukturave të tyre, punonjës të specializuar.

Në vijimësi

*-Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 dërguar në KLSH nga Autoriteti i Aviacionit Civil "Mbi planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH", ky rekomandim nuk është pranuar. **Rekomandimi nuk është pranuar***

4. Gjetje nga auditimi: Kryerja e shpenzimit në vlerën e **33,186,387 lekë**, për rishikimin e pozicionit ekonomik të kontratës koncesionare të Aeroportit Nënë Tereza Tiranë, mund të shmangej pasi AAC këtë detyrë, për zërat më të shumtë të kërkuar, mund ta kryente me strukturat e saj pa patur nevojë të kryente procedurë prokurimi. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me fillimin e procedurës së prokurimit me objekt: *"Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s"*, lloji procedurës *"Shërbim Konsulence"*, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se kjo procedurë është iniciuar nga AAC pasi i është kërkuar përzgjedhja e konsulentit dhe mbulimi i shpenzimeve nga MIE dhe MFE sipas shkresës dërguar AAC-së me nr. 777 prot., datë 16.04.2018. Autoriteti i Aviacionit Civil, përpara se të nxirrte urdhrin për hartimin e termave të referencës apo urdhrin e prokurimit, duhej që Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, të analizonin detyrat dhe përgjegjësitë e punonjësve referuar rregullave në fuqi dhe vlerësimit 6 mujor të performancës së punonjësve. Konkretisht, nga auditimi i ligjit të AAC dhe rregullores së brendëshme të institucionit, nga grupi i auditimit, konstatohet se AAC e ka pasur si detyrë të përcaktuar në rregulloren e brendëshme, monitorimin e performancës së Marrëveshjeve Koncesionare. Këtë detyrë, AAC e ka zbatuar prej vitesh aq më tepër që procedura e prokurimit kërkon rishikimin e pozicionit ekonomik për vitet e kaluara pra kontrata do ketë fuqi para

vepruese dhe ndryshimi i strukturës në vazhdimësi pas vitit 2018, nuk ka luajtur rol në humbjen e aftësisë së AAC për të monitoruar Koncesionarët gjë që e ka bërë vazhdimisht në të kaluarën. Si rrjedhojë, AAC ka pasur nën përgjegjësinë e saj, edhe zbatimin e detyrave të përcaktuara në termat e referencës sipas shtojcës nr. 13, të DST, REF-85.4-09-12-2018, pika 1.2, Objektivat Specifikë, për procedurën e prokurimit me objekt *“Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së koncesionit të TIA-s”*. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC për kryerjen e një procedure prokurimi me objektiva të cilat mund të realizoheshin nga strukturat e AAC sipas ligjeve dhe rregullave në fuqi për funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil, është vlerë e investuar në kundërshtim me ligjin e AAC, rregulloren e brendshme dhe fushën e veprimtarisë së AAC e cila të ardhurat e saj i përdor vetëm për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit. Vlera e investuar në total prej 33,186,387 lekë, përbën investim me efekt financiar negativ për Autoritetin e Aviacionit Civil/Buxhetin e Shtetit dhe një dëm ekonomik i mundshëm në të ardhmen nëse nuk përmbushet objektivi i përgjithshëm i kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, rikthimi i ekuilibrit ekonomik të Koncesionit (nëse ka pasur disekuilibër ekonomik pasi TIA nuk e ka pranuar ekzistencën e tij) gjithmonë duke zbatuar një nga skenarët e propozuar nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK, siç paraqiten në faqet 208 deri 231 të raportit përfundimtar, seksioni 16, Skenarët e Moderuar. Objektivi final i kontratës së lidhur midis AAC dhe operatorit ekonomik “B. A.” SHPK, nuk është dorëzimi i një raporti lidhur me *“Rishikimin e pavarur të pozicionit ekonomik të Koncesionit”* por rikthimi i ekuilibrit ekonomik i konstatuar nga “B. A.” SHPK (nëse ka pasur disekuilibër) sipas gjermës b) dhe gjermës c) të Klauzolës nr. 19.4 të ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004 (Kontrata Koncesionare) duke zbatuar një ose më shumë nga rekomandimet e dhëna nga operatori ekonomik pas kryerjes së vlerësimit të pavarur ekonomik të koncesionit. **Sa më sipër, investimi në vlerën e 33,186,387 lekë, konsiderohet investim me efekt financiar negativ për AAC dhe Buxhetin e Shtetit.**

Rekomandimi 4.1: Këshilli Drejtues i AAC, Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të analizojnë vlerën e investuar prej 33,186,387 lekë për kryerjen e rishikimit të pavarur ekonomik, duke verifikuar nëse me kryerjen e këtij shpenzimi, janë zbatuar Rekomandimet e Konsulentit “B. A.” SHPK për arritjen e objektivave të përcaktuara më parë për *“Rikthimin e ekuilibrit ekonomik të Koncesionit të TIA-s”*. Në të kundërt, të nxirren përgjegjësitë për Drejtorin Ekzekutiv të AAC dhe Sektorin e Kontratave dhe Shërbimeve, lidhur me fillimin e një procedure prokurimi dhe kryerjen e një investimi në kundërshtim me parimet e economicitetit, eficientësisë dhe efektivitetit të shpenzimeve të fondeve publike.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 566/2 prot., datë 02.03.2020 dhe urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 128, datë 02.03.2020 është ngritur grupi i punës për analizimin e kësaj gjetjeje dhe është marrë vendimi nr.8, datë 30.07.2020, “Për miratimin e masave përmirësuese që rezultojnë nga analiza e shkaqeve që kanë krijuar gjetjet e KLSH-së”. Ndërsa rekomandimi i KLSH nuk është pranuar.

Rekomandimi nuk është pranuar.

5. Gjetje nga auditimi: AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i detyruar i titujve ekzekutivë për punonjës të larguar nga puna, në total, për periudhën 20 mujore të auditimit, shumën 6,112,547 lekë gjithsej, të ndarë në dy periudhat e ndryshme vjetore përkatësisht në shumën 528,396 lekë (viti 2018) dhe në shumën 5,584,151 lekë (8 muajt e parë të vitit 2019), të konsideruara si efekte negative financiare për buxhetin e AAC.

Rekomandimi 5.1: Këshilli Drejtues të analizojë shkaqet e humbjes së procesve gjyqësore si dhe rastet e mos ndjekjes me kompetencë e profesionalizëm të këtyre proceseve në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim shmangien e efekteve financiare negative për buxhetin e AAC.

Në vijimësi

-Me shkresën nr. 566/3 prot., datë 02.03.2020 dhe urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 129, datë 02.03.2020 është ngritur grupi i punës për analizimin e kësaj gjetje. Këshilli Drejtues ka marrë Vendimin nr.8, datë 30.07.2020 “Për miratimin e masave përmirësuese që rezultojnë nga analiza e shkaqeve që kanë krijuar gjetjet e KLSH-së”. Nga AAC, janë ndjekur të gjitha shkallët e gjyqimit deri në fund të procesit. Rekomandimi është zbatuar.

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i shpenzimeve dhe konsumit të karburantit referuar verifikimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se:

-Për automjetet që disponon AAC rezulton se nuk kanë kartela përkatëse, në të cilat të regjistrohen të gjitha të dhënat e automjetit si dhe shpenzimet që do të kryhen për to ku, gjithashtu duhet të jetë evidentuar kilometrazhi i tij në fillim të vitit dhe në fund të vitit për të bërë ndjekjen e shpenzimeve periodike për goma, filtra e vaj, karburant, riparime etj. Këto shpenzime të cilat nuk mund të përlllogariten pa pasqyruar elementin bazë i cili është kilometrazhi, për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e tyre.

-Në varësi të konsumit të karburantit, të vendosur nga një komision i posaçëm, sasia e tërhequr nuk përputhet me kilometrat e përshkuara dhe nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës. Nga verifikimi dhe llogaritja e të dhënave të dokumentacionit rezulton se, janë tërhequr më tepër 6,270 litra benzinë në vlerën 970,118 lekë dhe 1,367 litra naftë në vlerën 221,090 lekë, të cilat nuk janë të plotësuara më dokumentacion. Nga ana e administrimit të AAC, Drejtori ekzekutiv në cilësinë e titullarit të njësisë publike e nëpunësit autorizues, drejtori i financës dhe buxhetit, në cilësinë e nëpunësit zbatues, si dhe përgjegjësi i sektorit e caktuar për menaxhimin e aktiveve rezulton se, nuk janë marrë masa për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për monitorimin dhe mbrojtjen e aktiveve të AAC-së, nuk janë kryer kontrole për llogaritjen e konsumit real të karburantit. Veprime në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 5-10, 35 dhe 36. Nga veprimet dhe mosveprimet konform procedurave që parashikohen nga ligji, shuma prej **1,191,208 lekë përbën efekt financiar negativ për buxhetin e AAC-së.**

Rekomandimi 6.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrë masat, për monitorimin e shpenzimeve të karburantit, në mënyrë kronologjike, me qëllim përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të tij. Nga sektori i financës dhe buxhetit, të hartohen kartelat përkatëse të automjeteve, ku të evidentohen dhe përditësohen të gjitha të dhënat dhe shpenzimet e automjeteve.

Në vijimësi

-Referuar auditimit të shpenzimeve mbi harxhimin e karburantit për vitet 2020-2021, nuk u konstatuan shpenzime të panevojshme si edhe janë hartuar kartelat e automjeteve duke pasqyruar lëvizjet, km, sasinë e konsumit, etj. Rekomandimi është zbatuar.

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës rezultoi se, me shkresën nr. 275 prot., datë 07.02.2019 është lëshuar Urdhër i brendshëm për kryerjen e procedurës të prokurimit me vlerë të vogël “Për blerje letër murale për ambient zyre”, me fond limit deri në vlerën 100,000 lekë. Kjo procedurë ka nisur bazuar në memon e bërë datë 07.01.2019 nga K. G. , në të cilën citohet se në kuadrin e përgatitjes së ambienteve të

zyrave të reja pranë Ti. Bus. Pa. . Është e nevojshme planifikimi dhe arredimi i zyrave të administratës dhe për këtë arsye është e nevojshme dekorimi i një prej ambienteve me letër murale e cila duhet të jetë ekologjike dhe antibakteriale me përmasat 785cm*325cm dhe të jetë e printuar me bojëra ekologjike. Me datë 08.02.2019 është mbajtur procesverbali nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla i cili ka hartuar specififikimet teknike dhe karakteristikat e letër murale. Komisioni është drejtuar 3 operatorëve ekonomikë dhe ka mbajtur procesverbalin më datë 08.02.2019, duke përcaktuar si ofertë fitues operatorin ekonomik “K. N.”(person fizik), me vlerën e ofertës 65,000 lekë pa TVSH. Me datë 14.05.2019 nga A. P. është përcjellë për pagesë praktika ndaj sektorit të financës për likuidimin e faturës nr. 86, datë 08.02.2019, ndaj këtij operatori me transaksionin bankar, më datë 28.02.2019 në shumën 78,000 lekë. Letra është bërë hyrje në magazinë me FH nr. 7, datë 08.02.2019, dhe është bërë dalje me FD nr. 26, datë 08.02.2019. Ky shpenzim në **shumën 78,000 lekë konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e AAC-së pasi, këto ambiente nuk janë marrë e vënë në funksion dhe AAC nuk ka ushtruar asnjëherë aktivitetin e saj në Tirana Business Park, çka do të thotë se është një shpenzim i pa nevojshëm për ushtrimin funksional të institucionit.** Veprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, nenin 2, 3 e 8/1.

Rekomandimi 7.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, të marrin masa, që të mos kryhen në të ardhmen, investime në kundërshtim me parimet e ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet në administrimin e fondeve publike.

Në vijimësi

-Referuar auditimit të procedurave të prokurimit të blerjeve me vlera të vogla për vitet 2020-2021, nuk u konstatuan shpenzime të panevojshme dhe që nuk i shërbejnë aktivitetit të AAC. Rekomandimi është zbatuar.

C.III. MASA PËR ELEMENIMIN E PROCEDURAVE TË REALIZUARA JO NË PËRPUTHJE ME KUADRIN RREGULLATIV LIGJOR

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 2 masa për eliminimin e procedurave të realizuara jo në përputhje me kuadrin rregullator ligjor përkatësisht:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me aktivet e nxjerra jashtë përdorimit dhe asgjësimit të tyre, konstatohet se;

-Në përbërje të listës së aktiveve të cilat rezultojnë që nuk janë në përdorim dhe që duhet të dalin nga regjistri i aktiveve të Institucionit me vlerë kontabël të mbetur në shumën 1,790,010 lekë, *ka materiale elektronike të cilat konsiderohen të dëmshme dhe nuk duhet të hidheshin apo të asgjësoheshin, pa një procedurë të mirëfilltë për shkak të natyrës dhe përbërjes së tyre, me qëllim parandalimin dhe pakësimin e mbetjeve nga pajisjet elektrike dhe elektronike të destinuara për asgjësim, si dhe të përmirësimit të performancës mjedisore.* Nga AAC nuk janë përcaktuar rregulla për mënyrën e asgjësimit të tyre. Nuk ka korrespondencë me Agjencinë Kombëtare të Mjedisit për lejimin e asgjësimit dhe gruposjes së pajisjeve të dëmshme për shëndetin e njeriut, impaktin që kanë në komunitet dhe nuk ka asnjë procedurë për vlerësimin dhe ndikimin që kanë në mjedis.

-Nuk vërtetohet kryerja e transportimit aktiveve nga AAC në vendin e përcaktuar për asgjësimin e tyre pasi, automjeti i caktuar për transportin, nuk rezulton të ketë përshkuar lëvizje në landfillin e sharrës. Konkretisht në datat pas urdhrin nr. 412, datë 19.10.2018 të titullarit të AAC e deri në datën e hartimit të procesverbalit, itinerari i automjetit me të cilin do transportoheshin aktivet, sipas sistemit GPS, nuk rezulton të ketë qenë në landfillin e Sharrës. Gjithashtu për aktivet e

dërguara në landfillin e Kukësit rezulton se ka një itinerar në datën 01.11.2018 por, nuk ka dokumentacion të mënyrës së asgjësimit të aktiveve. Veprime dhe mosveprime jo në përputhje me Ligjin nr. 10431, “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar, ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 957, datë 19.12.2012, “Për mbetjet nga pajisjet elektrike dhe elektronike”, kreu I, pika 1, pika 2, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", pikat 35 dhe 36.

Rekomandimi 1.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Financës dhe Buxhetit, të marrin masa në të ardhmen që, në lidhje me procesin e asgjësimit të aktiveve, të mbahet parasysh kuadri rregullativ ligjor për mbrojtjen e mjedisit, gjithashtu të kërkohet plotësimi i saktë i dokumentacionit, të rregullt dhe justifikues, sipas përcaktimeve ligjore.

Në vijimësi

-Gjatë viteve 2019-2021, nga AAC janë kryer dalje jashtë përdorimit, por praktika e ndjekur më parë është ezauruar me lidhjen e kontratës koncensionare nr.6021, datë 31.08.2017 nga Ministria e Mjedisit, “Për ndërtim landfilli, inceneratori dhe rehabilitim i vend depozitimeve ekzistuese Tiranë dhe prodhimin e energjisë elektrike”. Rekomandimi është zbatuar.

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla rezulton se;

-Për vitin 2018, janë realizuar 23 procedura, me fond limit në shumën totale 7,436,499 lekë pa TVSH dhe në vlerë kontrate në shumën totale 5,107,733 lekë pa TVSH, dhe -Për vitin 2019, deri në muajin gusht janë realizuar 21 procedura, me fond limit në shumën totale 5,717,297 lekë pa TVSH dhe në vlerë kontrate në shumën totale 3,673,053 lekë pa TVSH, (pa përfshirë këtu procedurat e blerjeve për biletat e udhëtimeve jashtë shtetit), të cilat u audituan në masën 100%, konstatohet se;

-Për vitin 2018 janë kryer 2 (dy) procedura duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale të fondit limit në vlerën 921,666 lekë pa TVSH, pra këto procedura janë mbi limitin prej 800,000 lekë dhe duhet të kryheshin me procedura normale prokurimi.

-Nga dosjet e arkivuara dhe inventarizuara në arkivën e AAC-së, të procedurave për prokurimet me vlera të vogla konstatohet se: Në 11(njëmbëdhjetë) procedura deklaratat e konfliktit të interesit, nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

-Në 10 (dhjetë) procedura të prokurimit me vlera të vogla, faturat tatimore nuk janë nënshkruar nga të gjithë anëtarët e komisionit.

-Në 14 (katërmbëdhjetë) procedura të prokurimit me vlera të vogla, nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

-Në 1(një) procedurë prokurimi me vlerë të vogël, e zhvilluar në sistemin elektronik në APP konstatohet se ftesa për ofertë nuk është dërguar 5 (pesë) operatorëve ekonomik.

-Në 1(një) procedurë prokurimi me vlerë të vogël konstatohet se, për zbatimin e saj, mallrat e zëvendësuar nuk janë bërë hyrje në magazinën rikupero, si dhe nga Drejtori i AAC, nuk është ngritur një komision për vlerësimin dhe asgjësimin e tyre.

-Për vitin 2019 janë kryer 2 procedura blerje me vlera të vogla *duke copëzuar fondin dhe duke shmangur procedurat normale të prokurimit, në shumën totale të fondit limit në vlerën 1,466,666 lekë pa TVSH*, pra këto procedura duhet të kryheshin me tenderim.

-Në të gjitha rastet e audituara procesverbalet e mbajtura nga komisioni i prokurimit, për procedurat blerje me vlera të vogla, të kryera me mjete elektronike, në lidhje me vijueshmërinë e kalimit nga operatori i renditur në vendin e parë dhe deri në përcaktimit të ofertës fituese, si dhe procesverbalet e mbajtura në procedurat e prokurimit për rastet emergjente, përcjelljet e praktikave për pagesë tek sektori i financës, nuk janë të protokolluara.

-Në 1 (një) rast shpenzimi është kryer duke mos e justifikuar nevojën e kryerjes së tij.

-Në 2 (dy) raste nuk ka urdhër nga titullari për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve.

-Në një rast preventivi i punëve dhe shërbimeve nuk është i argumentuar dhe i hartuar nga një specialist i fushës.

-Në një rast Operatori ekonomik i ofertuar nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit.

-Në 7 (shtatë) raste nuk dokumentohet kërkesa nga sektorët përkatës për nevojën e fillimit të procedurës së prokurimit, adresuar personit përgjegjës të prokurimit, i cili duhet të administrojë dokumentacionin e çdo procedure prokurimi.

-Në 5 (pesë) raste konstatohet se, faturat tatimore nuk janë të nënshkruara nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

Veprime të cilat janë në mospërputhje me Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, neni 2, 3 e 8/1, VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregulla të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 4 pika 1, neni 40 pika 1, 3 dhe 8, neni 57 pika 2 dhe 3, neni 64 pika 2, neni 77 pika 3, Udhëzimin nr. 3, datë 08.01.2018 “Mbi përdorimin e procedurës së prokurimit me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike” i ndryshuar, neni 7 dhe 19, Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësinë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Kontratave dhe Shërbimeve, Përgjegjësi i Prokurimeve, të marrin masat që, për procedurat e prokurimit të blerjeve me vlera të vogla, të mos përsëriten shkeljet e konstatuara sa më sipër, gjithashtu të veprohet në përputhje me kuadrin rregullativ ligjor në fuqi.

Në vijimësi

-Zbatimi i këtij rekomandimi është vërtetuar nga auditimi në vijim. Rekomandimi është zbatuar.

C.IV. Të tjera (Sugjerim për Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë)

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 7 masa Sugjerim për Drejtorinë e Auditit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë përkatësisht:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të shpenzimeve të kryera nëpërmjet bankës, rezultoi në 32 raste shpenzimet e kryera për përballimin e shpenzimeve të punonjësve për shërbimet e udhëtimit jashtë vendit, faturat e hotelit të paraqitura nga punonjësit, janë pa vullë vërtetuese të subjektit i cili e ka lëshuar, çka bën që dokumentacioni i paraqitur të mos e justifikojë shpenzimin në shumën 24,601 euro dhe sipas kursit mesatar të euros=123.8 lekë, rezulton në **shumën 3,046,753 lekë**, shpenzim i pajustificuar me dokumentacion vërtetues, për të cilin grupi i auditimit, nuk mund të shprehet nëse përbën dëm ekonomik apo efekt financiar negativ për buxhetin e AAC. Këto veprime të konsideruara nga grupi i auditimit në mospërputhje me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar dhe me VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me

shërbim jashtë vendit”, Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, duhen analizuar e shqyrtuar nga strukturat përkatëse.

Rekomandimi 1.1: Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, të shqyrtojë shumën 3,046,753 lekë, cilësuar si shpenzim i pajustificuar me dokumentacion vërtetues, e cila ka të bëjë me shkeljet e konstatuara në pagesat e kryera me bankë për përbalimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim jashtë vendit si dhe të vendosë se si do cilësohen ato duke përcaktuar personat përgjegjës. Vetë AAC të plotësojë të gjitha këto praktika me dokumentacionin e duhur.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 209/1 prot., datë 21.01.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është bërë kërkesë për informacion në lidhje mbi planin e masave të marra nga Autoriteti i Aviacionit Civil Tiranë, mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas shkresës 600/10 prot., datë 07.01.2020, kërkesë e cila është protokolluar në AAC me nr.159 prot., datë 21.01.2020.

*Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020, Autoriteti i Aviacionit Civil është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. **Rekomandimi nuk është pranuar.***

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me Vendimin nr. 10, datë 31.07.2018, me anë të të cilit, Këshilli Drejtues i AAC miraton ndryshimet në programin ekonomik për vitin 2018 duke shtuar zërin investime për pagesën e konsulentit të kompanisë R. B. GMBH, i cili do të asistojë për negocimin dhe lidhjen e kontratës, ndërmjet Shtetit Shqiptar dhe shoqërive Ç. Con. & K. & K. Con. , sipas shkresës së MIE me nr. 8607/1 prot., datë 20.06.2018. Në relacionin e drejtorit të AAC bashkangjitur vendimit të KD, cilësohet se: “...Duke patur parasysh që pagesa e këtij shërbimi nuk është parashikuar në programin buxhetor të MIE dhe duke qenë se AAC është pjesëmarrëse në këtë proces, përcaktohet se ky i fundit do të paguajë vlerën e kontratës prej 152,600 Euro pa TVSH”. Nga Auditimi i dokumentacionit të dorëzuar pranë grupit të auditimit lidhur me likuidimet e kryera nga AAC në llogari të Konsulentit “R. B.” GM.H, u konstatua se: Likuidimi i vlerës së dytë prej 76,300 Euro, pagesë finale sipas pikës 1.6 të kontratës bazë, është kryer nga AAC në datën 25.07.2019 sipas urdhër xhirimit të BK. , dega me kod 505, nga llogaria bankare e AAC në Euro me nr. 401612629 në llogarinë bankare të “R. B.” GM.H në Deu. Ba., Munchen. Bashkangjitur urdhër xhirimit, është fatura e dërguar në adresë të MIE, e protokolluar në AAC me nr. 1167/3 prot., datë 08.08.2018. Fatura për pagesën finale, është e njëjtë me faturën për pagesën e paradhënies. Pra, nuk vërtetohet se operatori e ka lëshuar faturën pasi ka përfunduar kryerjen e shërbimit. Gjithashtu, bashkangjitur urdhër xhirimit dhe faturës, është procesverbali i mbajtur nga grupi i negocimit. Në dokumentacionin e dorëzuar pranë grupit të auditimit, nuk u gjet asnjë dokumentacion tjetër që të vërtetojë shërbimet e kryera nga Konsulenti në përputhje me pikën 6.1 të kontratës së lidhur. Si rezultat, vlera e investuar nga AAC prej 76,300 euro, nuk është e justifikuar me dokumente dhe fakte sipas rregullave dhe ligjeve në fuqi.

Rekomandimi 2.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “R. B.” GM.H, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohe në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit,

arkëtimi i vlerës 76,300 Euro nga operatori ekonomik “R. B.” GMBH, si vlerë që i përket zërave të pa argumentuar në kundërshtim me nenin 6.1 të kontratës së lidhur.

Menjëherë

Rekomandimi 2.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 2.1 më lart të KLSH, të verifikojë plotësinë e dokumentacionit mbështetës për të vërtetuar kryerjen dhe ekzekutimin e shërbimit nga operatori ekonomik “R. B.” GM.H sipas kushteve të kontratës së lidhur midis MIE dhe këtij operatori.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 209/1 prot., datë 21.01.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është bërë kërkesë për informacion në lidhje mbi planin e masa të marra nga Autoriteti i Aviacionit Civil Tiranë mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas shkresës 600/10 prot., datë 07.01.2020, kërkesë e cila është protokolluar në AAC me nr.159 prot., datë 21.01.2020.

*Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 Autoriteti i Aviacionit Civil është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. **Rekomandimi nuk është pranuar.***

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit lidhur me zbatimin e procedurës së prokurimit me objekt: *“Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”*, me fond limit 29,542,841.28 lekë pa TVSH, zhvilluar nga AAC, u konstatua se operatori ekonomik “B. A.” SHPK, nuk ka dorëzuar pranë AAC, dokumentacion që vërteton angazhimin e ekspertëve të huaj të deklaruar në formularin e ofertës sipas ditëve dhe kohës së tyre të punës por edhe shpenzimet e rimbursueshme të likuiduara nga AAC lidhur me kostot e transportit ndërkombëtar dhe hotelet apo dietat. Nuk ka në dosjen e zbatimit të kontratës, asnjë dokumentacion që vërteton se ekspertët e huaj të angazhuar në zbatimin e kontratës me objekt *“Rishikim i pavarur ekonomik të kontratës së konçesionit të TIA-s”*, kanë qenë prezent në Shqipëri gjatë ekzekutimit të kontratës, kanë udhëtuar, akomaduar në hotel dhe punuar në ambientet e përcaktuara sipas kontratës së lidhur dhe konkretisht kontratës me nr. 1609/10 prot., datë 15.10.2018, nenit nr. 5 të Kushteve të Veçanta, pika 5.1 ku cilësohet se: *“Shërbimet do të kryhen në zyrat e administratës Tirana International Aeroport Rinas, Tiranë, pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, Rr. Sulejman Delvina, Nr. 1, P.O Box 205, Tiranë, Shqipëri ose zyrat e kontraktuesit sipas rastit”* dhe pikës 3.2, të seksionit “Profilin e operatorit ekonomik” të kontratës së lidhur, vendndodhja dhe ekzekutimi ku cilësohet se: *“Ekipi i ekspertëve të kontraktorit, do të kryejë detyrën në Tiranë, Republika e Shqipërisë”*. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik në SPE, dhe dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik pranë sektorit të financës së AAC, konkludohet se në total, vlera e likuiduar prej **134,928 EURO**, në favor të operatorit ekonomik “B. A.” SHPK, që i përket zërave të preventivit të ofertës (për ekspertët e huaj) së dhënë nga operatori ekonomik i shpallur fitues konform shtojcës nr. 4 të Dokumenteve standarde të Tenderit dhe nenit 37 Shërbimet e Konsulencës të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 me ndryshime, pika 4, gërma a), duhet të analizohet nga AAC dhe vetëm nëse AAC nuk vërteton kryerjen e shërbimit me dokumentacion ligjor, atëherë të nxirren përgjegjësitë dhe të kërkohet kthimi i vlerës së investuar.

Rekomandimi 3.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Drejtoria e Shërbimeve të Përgjithshme, Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori i Shërbimit Ligjor, të analizojnë vlerën e investuar nga AAC dhe të përfituar nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK, dhe vetëm nëse nuk justifikohet me

dokumentacion mbështetës, të konsiderohet dëm ekonomik dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, **arkëtimi i vlerës 134,928 EURO nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK.**

Menjëherë

Rekomandimi 3.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 3.1 më lart të KLSH, të verifikojë mangësitë e konstatuara për plotësimin e dokumentacionit mbështetës për të vërtetuar kryerjen dhe ekzekutimin e shërbimit nga operatori ekonomik “B. A.” SHPK sipas kushteve të kontratës së lidhur midis AAC dhe këtij operatori.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 209/1 prot., datë 21.01.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është bërë kërkesë për informacion në lidhje mbi planin e masa të marra nga Autoriteti i Aviacionit Civil Tiranë mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas shkresës 600/10 prot., datë 07.01.2020, kërkesë e cila është protokolluar në AAC me nr.159 prot., datë 21.01.2020.

*Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 Autoriteti i Aviacionit Civil është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. **Rekomandimi nuk është pranuar.***

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion të grupit të auditimit, u konstatua se ka pasur 2 raste të ndryshimit të strukturës së punonjësve të AAC. Konkretisht, me Vendimin nr.79, datë 21.12.2017, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 69 punonjës dhe me Vendimin nr. 21, datë 28.12.2018, KD miraton strukturën me numër punonjësish në total, 73 punonjës. Këto vendime, janë miratuar nga Ministri i MIE përkatësisht me shkresat nr. 3868/5, datë 16.02.2018 dhe Urdhrin nr. 2, datë 11.01.2019. Ndërsa para shkurtit të vitit 2018 në strukturën e AAC ka pasur 83 punonjës në organikë duke tejkalluar në mënyrë të parregullt me numrin e punonjësve me 17 punonjës. Struktura është ndryshuar pas arsyetimeve me Relacion nga ana e Drejtorit të AAC por të dy rastet nuk janë miratuar nga Ministri i Ekonomisë dhe Financave, në kundërshtim me VKM nr. 893, datë 17.12.2014, nenin 30.

Rekomandimi 4.1: Autoriteti i Aviacionit Civil, Sektori i Shërbimit Ligjor dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të marrin masa, që në të ardhmen, të kërkojnë miratimin e strukturës nga Departamenti i Administratës Publike dhe nga Ministria e Financave dhe të implementojë vetëm strukturën e miratuar ligjërisht.

Në vijimësi

Rekomandimi 4.2: I sugjerojmë Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, që duke marrë në konsideratë rekomandimin 4.1 më lart të KLSH, të verifikojë dëmin ekonomik të konstatuar në lidhje me këtë pikë jo vetëm për periudhën e auditimit por edhe përpara kësaj periudhe.

Menjëherë

-Me shkresën nr. 209/1 prot., datë 21.01.2020 të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë është bërë kërkesë për informacion në lidhje mbi planin e masa të marra nga Autoriteti i Aviacionit Civil Tiranë mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas shkresës 600/10 prot., datë 07.01.2020, kërkesë e cila është protokolluar në AAC me nr.159 prot., datë 21.01.2020.

*Me shkresën nr. 159/2 prot., datë 07.02.2020 Autoriteti i Aviacionit Civil është drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH. **Rekomandimi 4.1 dhe rekomandimi 4.2 nuk janë pranuar.***

D. MASA DISIPLINORE

Nga Kontrolli i Lartë i Shtetit janë propozuar 2 masa disiplinore përkatësisht:

Referuar konstatimeve në këtë raport, mbështetur në nenin 15, pika “dh” dhe “e” të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës, nenit 12 të ligjit nr. 168/2014 për AAC, i rekomandojmë Ministrin të Industrisë dhe Energjisë, marrjen e masës disiplinore në varësi të shkeljeve të konstatuara si më poshtë;

Për:

Krislen Keri me detyrë Drejtor Ekzekutiv i AAC, për:

*-Miratimin e likuidimit të vlerës prej **20,252.96 Euro**, në favor të ‘T. B. P.’ SHPK, e konsideruar **dëm ekonomik** që i përket vlerës së garancisë të likuiduar nga AAC në favor të TBP;*

*-Mos marrjen e masave për derdhjen në buxhet të shtetit të fitimit për vitet 2017 dhe 2018, i cili paraqitet në **shumën 149,260,654 lekë**, dhe së bashku me vitet e mëparshme paraqitet në **shumën 279,917,654 lekë**;*

*-Kryerjen e procedurave të prokurimit me objekte të cilat mund të mbuloreshin nga stafi i AAC duke shkaktuar **efekte financiare negative në vlerën e 52,915,679 lekë**;*

*-Për shkelje të tjera të trajtuara në raportin përfundimtar dhe në pikën CII të këtij Vendimi, **efekte negative financiare në vlerën e 211,228 EURO** që i përkasin shpenzimeve pa dokumentacion mbështetës.*

-Nxjerrjen e urdhrin të prokurimit me fond limit të ndryshëm dhe më të lartë se fondi i përlllogaritur;

-Kryerjen e shpenzime për vendime gjyqësore për punonjës të larguar padrejtësisht nga puna në vlerën 6,112,547, duke rënduar Buxhetin e AAC-së;

b. Referuar konstatimeve në këtë raport, mbështetur në nenin 15, pika “dh” dhe “e” të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 37, 141 e 153 pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, Kontratën individuale të punës të hartuar dhe miratuar nga AAC, nenit 12 të ligjit nr. 168/2014 për AAC, i rekomandojmë drejtorit ekzekutiv të AAC, që referuar pikës 4 të nenit 59 të ligjit nr. 152/2013 “PËR NËPUNËSIN CIVIL”, ti kërkojë Komisionit Disiplinor, marrjen e masës disiplinore:

“Largim nga shërbimi civil”, parashikuar në nenin 58, gërma (ç) për nëpunësin civil, për: **A. P.** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Kontratave dhe Shërbimeve për arsye se:

*-Kryerjen e procedurave të prokurimit me objekte të cilat mund të mbuloreshin nga stafi i AAC duke shkaktuar **efekte financiare negative në vlerën e 52,915,679 lekë**;*

-Nxjerrjen e urdhrin të prokurimit me fond limit të ndryshëm dhe më të lartë se fondi i përlllogaritur;

-Nuk ka analizuar/rishqyrtuar asnjë kriter të vendosur në DST, por është shprehur në procesverbalet e mbajtura për shkaqet e anulimit dy herë radhazi për procedurën e prokurimit me objekt “Rishikimi i pavarur ekonomik i kontratës koncesionare me TI.” vetëm se nuk ka konkurrencë;

-Ka copëzuar fondin duke shmangur procedurat normale të prokurimit, për katër procedura prokurimi për vitin 2018 dhe 2019.

-Nuk ka protokolluar procesverbalet e mbajtura për procedurat blerje me vlera të vogla, të kryera me mjete elektronike;

-Në 8 (tetë) raste, nuk ka justifikuar/argumentuar nevojën e kryerjes së investimit;

- Në 2 (dy) raste, nuk ka marrë masat për nxjerrjen e urdhrin për krijimin e komisionit të marrjes në dorëzim të shërbimeve;
 - Në një rast preventivi i punëve dhe shërbimeve nuk është i argumentuar dhe i hartuar nga një specialist i fushës;
 - Në një rast, ka miratuar kualifikimin e një operatori ekonomik i cili nuk ka në fushën e veprimtarisë së tij, objektin e prokurimit;
 - Në 5 (pesë) raste, nuk ka marrë masat për nënshkrimin e faturave tatimore nga të gjithë anëtarët e komisionit të prokurimit me vlera të vogla;
 - Nuk ka marrë masat për plotësimin me dokumentacion mbështetës, për të bërë të mundur ndjekjen e shpenzimeve periodike të konsumit të karburantit të automjeteve.
 - Autoriteti i Aviacionit Civil ka ngritur komisionin disiplinor referuar ligjit nr.152/2013 “Për Nëpunësin civil”, i ndryshuar, në lidhje me këtë rekomandim, komisioni me vendimin nr.41, datë 22.10.2020 ka vendosur ndërprerjen e ecurisë disiplinore. **Rekomandimi nuk është pranuar.***
- Zbatimi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm paraqitet si më poshtë:

Emërtimi	Rekomanduar	Zbatuar	Pa pranuar	Në proces	Pjesërisht
Masa Organizative	28	11	13	1	3
Masa Shpërblim dëmi	2		2		
Dëm potencialisht i mundshëm	4	1	3		
Eliminimi Efekteve negative	8	5	3		
Eliminimin e procedurave jo ligjore	2	2			
Të tjera sugjerime	7		7		
Masa Disiplinore	2		2		
Total	53	19	30	1	3

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:

Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

K. K. , ish Drejtor Ekzekutiv (10.11.2017-22.04.2020), E. K. , me detyrë Drejtor Ekzekutiv për periudhën 22.04.2020 - e në vazhdim dhe A. P. , me detyrë Drejtore Ekonomike për periudhën 04.12.2019 - e në vazhdim.

Për sa më lart është mbajtur Aktkonstatimi nr.4, datë 30.07.2021.

Në përgjigje të akt-konstatimit nr. 4, datë 30.07.2021 të grupit të auditimit, është paraqitur observacioni nr.1418/17, datë 06.08.2021 nga A. P. , protokolluar në KLSH me nr. 580/20, datë 11.08.2021, me pretendimet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Për sa më sipër sqaroj se nuk kam qenë pjesë e grupit të punës për ndjekjen dhe zbatimin e rekomandimeve dhe me shkresën nr.600/10, datë 07.01.2020 të Kryetarit të Këshillit Drejtues A. Sh. dhe përcjellë prej tij në AAC me shkresën nr.209, datë 21.01.2020. Në këtë shkresë është caktuar edhe personi përgjegjës për ndjekjen e rekomandimeve. Ju lutem rishikoni qëndrimin tuaj për ngarkimin tim me përgjegjësi.*

Oëndrimi i grupit të auditimit: *Në lidhje me pretendimin tuaj sqarojmë se: Personi të cilit i drejtohet shkresa e kryetarit të Këshillit Drejtues është titullari i institucionit i cili ka nxjerrë programin për zbatimin e tyre përfshirë edhe Drejtorinë Ekonomike. Në këto kushte nga grupi auditimit nuk vlerësohet përgjegjësia individuale por zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin e punës së institucionit.*

Pretendimi i subjektit: Për sa më sipër sqarohet se me shkresën nr.159/2, datë 07.02.2020 AAC ka dërguar pranë KLSH planin e masave për zbatimin e rekomandimeve, duke venë në dijeni Kryetarin e Këshillit Drejtues, duke respektuar afatin 20 ditor nga dita që është njohur zyrtarisht me vendimin dhe raportin. Afati 6-mujor nuk është zbatuar si pasojë e situatës Covid-19.

Ju lutem rishikoni qëndrimin tuaj për ngarkimin tim me përgjegjësi.

Oëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimin tuaj sqarohet se respektimi i afateve ligjore përcakton afatin për kthimin e përgjigjes në KLSH dhe jo në Këshillin Drejtues. Po kështu, edhe pretendimi në lidhje me mosrespektimin e afatit 6-mujor, nuk qëndron sepse institucioni ka ushtruar veprimtari edhe gjatë kohës së pandemisë. Në këto kushte nga grupi auditimit nuk vlerësohet përgjegjësia individuale por respektimi i afateve ligjore dhe zbatimi i rekomandimeve për përmirësimin e punës së institucionit.

1. Titulli i gjetjes:	Autoriteti Aviacionit Civil (AAC), nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.
Situata:	<p>KLSH me shkresën nr. 600/10, datë 07.01.2020, ka rekomanduar 53 masa gjithsej, nga këto 28 masa organizative, 2 masa për shpërblim dëmi, 8 masa për eliminimin e efekteve negative, 4 masa dëm potencialisht i mundshëm, 2 masa për eliminimin e procedurave jo ligjore, 7 sugjerime dhe 2 masa disiplinore.</p> <p>-Autoriteti Aviacionit Civil, nuk ka respektuar afatet 20 ditore dhe 6-mujor, të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me nenet 15 germa “j” dhe 30 pika 2, të ligjit nr.154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:</p> <p>-Nga 28 masa organizative gjithsej, të rekomanduara, 11 janë zbatuar plotësisht, 13 nuk janë pranuar, 1 është në proces dhe 3 janë zbatuar pjesërisht.</p> <p>-Nga 2 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara, nuk është pranuar asnjë prej tyre.</p> <p>-Nga 4 masa dëm potencialisht i mundshëm gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 1 është zbatuar.</p> <p>-Nga 8 masa për eliminimin e efekteve negative gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 5 janë zbatuar.</p> <p>-Nga 2 masa për eliminimin e procedurave jo ligjore gjithsej, 2 masa janë zbatuar.</p> <p>-Nga 7 masa sugjerime gjithsej, nuk është pranuar asnjë prej tyre.</p> <p>-Nga 2 masa disiplinore, nuk është pranuar asnjë prej tyre.</p> <p>Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:</p> <p>-Niveli i pranimit dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet në nivele të ulta, rreth 36%.</p> <p>-Drejtorja e AAC nuk ka marrë në konsideratë 64% të rekomandimeve të lëna nga KLSH.</p> <p>-Nuk janë respektuar afatet e kthimit të përgjigjes mbi rekomandimet e</p>

	lëna nga KLSH sipas përcaktimeve ligjore. -Rekomandimet e KLSH-së, dërguar me shkresën nr.1312/24, datë 02.05.2019, rezultojnë të zbatuara në nivelin 53%.
Kriteri:	Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, nenet 15 germa “j” 30, pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Në arritjen e objektivave dhe politikave të miratuara për AAC.
Shkaku:	Organet drejtuese nuk kanë vlerësuar zbatimin korrekt të legjislacionit në fuqi.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandimi 1.1:	Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose në proces, si edhe të ndiqen në të gjitha shkallët e gjykimit, ato që janë në procese gjyqësore.

2.2. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e organeve drejtuese, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra.

Këshilli Drejtues është organ kolegjal i përbërë nga kryetari dhe katër anëtarë. Ai është organ vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare dhe funksionon sipas dispozitave të këtij ligji dhe të rregullores të funksionimit të miratuar prej tij.

Këshilli drejtues i AAC-së është emëruar me VKM nr. 752, datë 13.12.2017, VKM nr. 755, datë 19.12.2018, VKM nr. 221, datë 12.03.2020 dhe VKM nr. 80, datë 10.02.2021. Këshilli Drejtues paguhet në zbatim të VKM nr. 776, datë 24.9.2010 “Për caktimin e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të këshillit drejtues të AAC”.

Me vendim të Këshillit Drejtues nr. 68, datë 23.02.2017, është miratuar Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”.

Për periudhën objekt auditimi Këshillit Drejtues ka marr 51 vendime. Konkretisht në vitin 2018, vendime 21, vitin 2019 vendime 15, vitin 2020 vendime 13 dhe për periudhën janar-prill 2021, vendime 2.

Auditimi u krye me zgjedhje²

Konkretisht u audituan 20 vendime, nga këto tre për vitin 2018, pesë për vitin 2019, dhjetë për vitin 2020 dhe dy për vitin 2021.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se organizimi, funksionimi i Këshillit Drejtues, si dhe përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra prej Tij, përgjithësisht është bërë në zbatim të Ligjit nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij, Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë", me ndryshimet vijuese të tij, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

²Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

Pavarësisht nga sa u deklarua mësipërm, u konstatuan shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

Në vitin 2020 janë zhvilluar 6 mbledhje online të Këshillit Drejtues, në të cilat janë marrë dy vendime. Vendimi nr. 1, datë 24.04.2020 dhe vendimi nr. 13 datë 24.12.2020, ndërsa në vitin 2021 është zhvilluar një mbledhje online e Këshillit Drejtues ku nuk është marrë asnjë vendim. Për mbledhjet e zhvilluara online, nuk ka regjistrim audio të mbledhjeve të zhvilluara. Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet online dhe si merret vendim marrja e tyre.

-Këshilli Drejtues për vitin 2020 ka marrë 7 vendime qarkulluese. Konkretisht vendimi nr. 2, datë 14.05.2020, vendimi nr. 4, datë 15.06.2020, vendimi nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 datë 30.07.2020, vendimi nr. 12, datë 16.11.2020, ndërsa për vitin 2021 ka marrë 2 vendime qarkulluese konkretisht vendimin nr. 1, datë 08.01.2021 dhe vendimi nr. 2, datë 23.03.2021.

Rregullorja “Për rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura, si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendim marrja me vendime qarkulluese.

Përputhshmëria ligjore e vendimeve qarkulluese të marra është kryer në zbatim të Ligjit nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10.040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

-Vendimi nr. 2, datë 23.03.2021 “Mbi miratimin e financimit dhe kontraktimit të “Asistencë për negociim të termave të kontratës konçensionare të Aeroportit të Vlorës”. Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje, është protokolluar me nr. 488/2 prot., datë 23.03.2021, *dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.* Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11 “Mbledhjet e këshillit drejtues” pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit nënshkruhen nga kryetari”, Rregulloren “Për rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 68, datë 23.02.2017, neni 9 pika 2.

Për mangësitë e trajtuara për vendimin nr. 2 datë 23.03.2021, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Drejtues pjesëmarrës në kë mbledhje. D.Gj., kryetar, E.K., anëtar, A.G., anëtar, E. M., anëtar, E. Xh., anëtar.

-Vendimi nr. 4, datë 15.06.2020 “Për miratimin e propozimit për përfshirjen në paketën lehtësuese financiare për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, të Organizatës Europiane për Sigurinë e Lundrimit Ajror (këtu e në vijim Euro.).

Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, ndërsa vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe kryetari, është protokolluar në datën 15.06.2020 me nr. 992/1 prot., dhe është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11 “Mbledhjet e këshillit drejtues” pika 5 ku është shprehur në mënyrë eksplicite “Për çdo mbledhje mbahet procesverbal, i cili nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e pranishëm, ndërsa vendimet e këshillit nënshkruhen nga kryetari”, Rregulloren “Për rregullat e brendshme e

organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 2.

Për mangësitë e trajtuara për vendimin nr. 4 datë 15.06.2020, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Drejtues pjesëmarrës në kë mbledhje. D. Gj. , kryetar, E. K. , anëtar, A. G., anëtar, E. M. , anëtar, A. Sh. , anëtar.

Këshilli Drejtues në lidhje me “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO. , nuk ka vendimmarrje në mbledhjen e datës 18.12.2020, datës 24.12.2020 dhe datës 29.01.2021, me pasoja financiare për Autoritetin e Aviacionit Civil, duke konsideruar faktin se tarifa en-route e mbledhur nga Euro. për llogari të RSH-së, për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për AAC.

Konkretisht:

Mbledhja e Këshillit Drejtues datë 18.12.2020, nuk ka vendimmarrje

Këshilli Drejtues është mbledhur datë 18.12.2020, online dhe nuk ka vendimmarrje. Rendi i ditës është miratimi i programit ekonomik për vitin 2021 me relacion të Drejtorit Ekzekutiv nr. 1965 prot., datë 26.11.2020.

Mbledhja është zhvilluar me pjesëmarrjen e D. Gj., E. K., A. G., dhe A. Sh. Në këtë mbledhje janë bërë rekomandime mbi draftin e propozuar dhe është lënë vendimmarrja në një mbledhje tjetër të Këshillit Drejtues. Përveç tregueseve të programit ekonomik në këtë mbledhje është diskutuar edhe sekuestrimi fondeve të Shqipërisë në Euro. që sipas informacionit të Drejtorit Ekzekutiv kapin vlerën 170 mijë euro. Çdo e ardhur që do mblidhet është e ngrirë dhe nuk do të merret deri sa të merret një vendim në lidhje me këtë çështje dhe nëse nuk ka një veprim së shpejti atëherë ato kalojnë në llogari të palës paditëse.

Në këtë mbledhje është deklaruar se detyrimi në total i çështjes Bech. & C. është mbi 140 milion euro. Sekuestrimi që është bërë aktualisht në zbatim të këtij vendimi, do të mbulohet aktualisht vetëm më të ardhurat e Euro. në favor të autoriteteve shqiptare, dhe kjo do të ndodhi për shumën totale.

Çështja e urdhrin të sekuestrimit të fondeve është trajtuar dhe në mbledhjen e datës 24.12.2020, ku është marrë vendimi mbi programin ekonomik të vitit 2021 dhe nuk është marr asnjë vendimmarrje për këtë çështje.

Mbledhja Këshillit Drejtues datë 29.01.2021, nuk ka vendimmarrje.

Këshilli Drejtues është mbledhur datë 29.01.2021, online dhe nuk ka vendimmarrje. Informacioni i Drejtorit Ekzekutiv nr. 148, datë 26.11.2021 “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO.”.

Përmbajta e informacionit: Në datën 07.12.2020 AAC është njoftuar nga Euro. mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO. Sekuestro është vendosur mbi një vendim arbitrazh të çështjes “Bech.” kundër shtetit shqiptar.

AAC njofton MIE dhe Alb. përkatësisht me shkresat nr. 2015, datë 07.12.2020 “Informacion lidhur me shkresën e ardhur nga EURO, mbi ekzekutimin e urdhrin mbi mbajtjen e pagesave të Shtetit Shqiptar” dhe 2015/1, datë 07.12.2020 “Njoftim mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO.”.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 8544/1, datë 16.12.2020, i drejtohet Avokaturës së Shtetit për asistencë juridike lidhur me këtë çështje dhe bën me dije se Autoriteti i

Aviacionit Civil, angazhohet për përballimin e shpenzimeve ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të kësaj asistence.

Afati i ankimimit është data 18 Dhjetor 2020. Në përmbajtje të shkresës MIE thekson se ka vënë në dijeni Avokaturën e Shtetit nëpërmjet komunikimeve elektronike ndërinstitucionale të datës 7 Dhjetor 2020.

Me Urdhrin e Drejtorit Ekzekutiv nr. 450, datë 17.12.2020 “Për pajtimin e një zyre ligjore Belge për depozitimin e ankimimit të veprimeve përbarimore lidhur me llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO.”, është pajtuar një studio ligjore për depozitim të ankimimit me qëllim vazhdimin e apelimit të vendimit gjyqësor.

Duke marr në konsideratë:

-a. Zgjidhja e kësaj çështje rezulton me pasoja financiare, duke konsideruar se tarifa en-route e mbledhur nga Eurocontrol për llogari të RSH-së për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për Autoritetin e Aviacionit Civil, e cila përbën rreth 30% të të ardhurave totale.

Nga tarifa en-route për vitin 2020 AAC ka arkëtuar 46 milion lekë nga 168 mil të planifikuara në fillim të vitit (kosto e miratuar nga EURO.). Vlera 46 mil përfshin të ardhurën për muajt Janar, Qershor, Korrik & Gusht 2020.

Masat kufizuese kundër përhapjes së COVID-19 krijuan një krizë e thellë likuiditeti në sektorin e aviacionit civil. Për të zbutur riskun e mungesës së të ardhurave në Qershor të vitit 2020, AAC është angazhuar në paketën lehtësuese financiare të EUR. dhe ka nënshkruar me Alb. marrëveshjen për ndarjen e kësaj pakete duke rishikuar tarifën sipas periudhës së disbursimit të kredisë dhe pagesës së interesave.

Nga kjo paketë lehtësuese AAC ka përfituar 21.4 mil lekë nga 28.5 mil të angazhuara, edhe pse EURO. e ka disbursuar të gjithë vlerën të llogaritë e Alb. nëpërmjet 4 kësteve. AAC nëpërmjet shkresës nr. 2130, datë 28.12.2020 ka përcjellë në Alb. faturën për muajt Shtator 2020 në vlerën 12,425,138 lekë dhe Shkurt 2020 në vlerën 7,852,490 lekë sipas Marrëveshjes “Mbi ndarjen e paketës financiare të kredisë së EURO. dhe rishikimin e tarifës së AAC për vitin 2020”, protokolluar në AAC me nr. 1348 prot., datë 30.07.2020. E ardhura nga tarifa en-route për muajin Shtator 2020 rezulton e pa arkëtuar nga Alb. edhe pse Euro. ka disbursuar këstin e katërt të ndihmës financiare në datë 29.09.2020 në vlerën 1,199,505.68 EUR. Pra, detyrimet e faturuara që Alb. ka ndaj AAC është në vlerën 12,425,138 lekë.

-b. Njoftimi i Euro. për AAC datë 07.12.2020, ka të evidentuar shumën totale të mbajtur ose që i detyrohet Republika e Shqipërisë, duke përfshirë shumat që janë mbajtur ose detyrimet që janë për t’u paguar nëpërmjet Alb.-it.

Theksojmë se nëpërmjet komunikimit elektronik EURO bën me dije se në bazë të ligjit belg për përbarimin ka detyrimin t’i njoftoj kërkuarit (në këtë rast Bechetti dhe të tjerë) shumën e mbajtur nga llogaria e Shqipërisë. Deri në datën 15 Dhjetor 2020 kjo shumë **është 171,653 Euro**. Në shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, përcjellë në AAC me shkresën nr. 1879/1, datë 23.03.2021 njoftohet se kjo shumë në datën 28 Janar 2021 është **në vlerën 1,687,755 Euro**.

- c. Urdhri i ekzekutimit dhe vendimi i gjykatës së shkallës së parë belge për të cilën është lëshuar, nuk është realizuar në mënyrë zyrtare për Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” të vitit 1965. Ky njoftim është bërë nëpërmjet

Eurocontrol, e cila ka njoftuar mbi objektin e urdhrin të ekzekutimit, me anë të shkresës Ref. DCF 126_20 të datës 7 dhjetor 2020.

-ç. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përballojë shpenzimet ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për çështjen e ngrirjes së llogarive të Republikës së Shqipërisë, në EURO, sipas Urdhër Ekzekutimit të autoriteteve Belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë Belge të datës 1 Dhjetor 2020, pra do t'i duhet të përshijë në programin ekonomik të viti 2021 shpenzimet të asistencës juridike, që nga auditimi rezultuan se nuk ka asnjë korrespondencë me Avokaturën e Shtetit n.q.s ka/ose jo të kontraktuar zyrë avokatie dhe sa shkojnë kostot e gjykimit.

-d. Edhe pse çështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e shtetit dhe AAC, ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacionit Ndërkombëtar dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe urgjencën e kohës, Avokatura e Shtetit, nuk ka vepruar në përputhje me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008, si dhe të Kapitulli 4 pika D të VKM nr. 893, datë 18.11.2020 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës", pasi ka deleguar një të drejtë që është tagër ekskluziv i saj.

-dh. Kjo mbledhje e Këshillit Drejtues është zhvilluar në fillim të viti buxhetor, ku AAC gjendet në pozitë financiare të vështirë që pasqyron qartazi vetëm një krizë të mprehtë likuiditeti, si rrjedhojë e mungesës së tarifës en-route dhe uljen rreth 50% të tarifës së sigurisë për shkak të numrit të ulët të fluturimeve nga kufizimet e COVID-19.

Mos vendimmarrja e Këshillit Drejtues mbi bazën informacionit të Drejtorit Ekzekutiv nr. 148, datë 26.11.2021 "Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO.", është në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 "Për autoritetin e aviacionit civil", me ndryshimet vijuese të tij Neni 5 "Këshilli drejtues", pika 1 ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Këshilli drejtues është organi vendimmarrës për çështjet administrative dhe financiare të Autoritetit", neni 6 "Kompetencat e këshillit drejtues" pika d dhe e, ku është shprehur në mënyrë eksplicite se "Merr vendime për çështje të tjera, në përputhje me detyrimet e legjislacionit në fuqi".

Korrespondenca shkresore mbi të cilën është dhënë konsiderata:

- Njoftimi i Euro. mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur datë 07.12.2020

- Shkresa drejtuar Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (këtu dhe në vijim MIE) me nr. 2015/1 prot., datë 07.12.2020, me lëndë "Informacionin lidhur me shkresën e ardhur nga Euro. , mbi ekzekutimin e Urdhrit Bashkëlidhur mbi mbajtjen e pagesave të Shtetit Shqiptar"

- Shkresa drejtuar Alb. me nr. 2015/1 Prot., datë 07.12.2020, me lëndë "Njoftim mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në Euro."

- Shkresa dërguar nga MIE drejtuar Avokaturës së Shtetit, për dijeni AAC me nr. 8544/1 prot., datë 16.12.2020 me lëndë "Kërkesë për asistencë juridike".

- Shkresa dërguar nga Avokatura e Shtetit drejtuar MIE me nr. 4996/1 prot., datë 24.12.2020, me lëndë "Mbi kërkesën për asistencë juridike në vijim të shkresës së ardhur nga Euro. , lidhur me ekzekutimin e urdhrin të autoriteteve belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë".

- Shkresa dërguar nga AAC drejtuar MIE me nr. 2074/4 prot., datë 31.12.2020, me lëndë “Mbi shkresën e Avokaturës së Shtetit, Nr. 4996 prot., datë 24.12.2020”.

- Shkresa dërguar nga MIE drejtuar Avokaturës së Shtetit, për dijeni AAC me nr. 8544/4 prot., datë 31.12.2020, me lëndë “Kthim përgjigje”.

Për mos vendimmarrjen e Këshillit Drejtues në mbledhjen e datës 18.12.2020, datës 24.12.2020 dhe datës 29.01.2021, ngarkohen me përgjegjësi anëtarët e Këshillit Drejtues pjesëmarrës në këto mbledhje D. Gj. me detyrë Kryetar i Këshillit Drejtues dhe anëtarët, A. Sh. , E. M. , E. K. , A. G. .

Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil K. K. është emëruar në detyrë me VKM nr. 653, datë 10.11.2017 dhe është liruar nga detyra me VKM 339, datë 22.04.2020, i cili për periudhën nga data 10.11.2017 -22.04.2020 ka marr 24 vendime.

Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil E. K. është emëruar me VKM nr. nr. 340, datë 22.04.2020, e cila për periudhën 22.04.2020-30.04.2021 ka marr 43 vendime.

Në të 67 vendimet e Drejtorëve Ekzekutiv, nga dokumentacioni i vënë në dispozicion u konstatua se përputhshmëria ligjore e vendimeve të marra, është kryer në zbatim të Ligjit nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, i ndryshuar, si dhe të Ligjit nr. 10.040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë”, si dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tyre.

Pavarësisht nga sa u deklarua mësipërm në ushtrimin e detyrave dhe përgjegjësi, u konstatuan edhe disa shkelje të dispozitave dhe ligjore dhe mangësi të cilat në mënyrë të detajuar paraqiten si më poshtë vijon:

-Nuk është paraqitur në këshillin drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, neni 13, pika iii.

Për mangësitë e mësipërme ngarkohet me përgjegjësi E. K. me detyrë Drejtor Ekzekutiv për periudhën 22.04.2020 dhe në vazhdim.

1. Titulli i gjetjes:	Këshilli Drejtues në lidhje me “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO. , nuk ka vendimmarrje në mbledhjen e datës 18.12.2020, datës 24.12.2020 dhe datës 29.01.2021.
Situata:	Këshillit Drejtues për programin ekonomik të vitit 2021 ka zhvilluar mbledhjen e datës 18.12.2020 dhe të datës 24.12.2020. Në këto dy mbledhje dhe në veçanti në mbledhjen e datës 29.01.2021 është diskutuar “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO.” dhe nuk është marr vendimmarrje, pavarësisht se zgjidhja e kësaj çështjeje rezulton me pasoja financiare, duke konsideruar se tarifa en-route e mbledhur nga Eurocontrol për llogari të RSH-së për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për Autoritetin e Aviacionit

Civil, e cila përbën rreth 30% të të ardhurave totale.

Vendimmarrja e Këshillit Drejtues nuk ka marr në konsideratë për sa më poshtë vijon:

-a. Njoftimi i Eurocontrol për AAC nëpërmjet komunikimit elektronik bën me dije se shuma e mbajtur nga llogaria e Shqipërisë për llogari të Bechetti, deri në datën 15 dhjetor 2020 **është në vlerën 171,653 Euro**, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1879/1, datë 23.03.2021, njofton AAC se kjo shumë në datën 28 Janar 2021 është **në vlerën 1,687,755 Euro**.

Theksojmë se referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 28.12.2020 ,detyrimi total është mbi në vlerën 140 milion euro.

- b. Urdhri i ekzekutimit dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Belge për të cilën është lëshuar, nuk është realizuar në mënyrë zyrtare për Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” të vitit 1965. Ky njoftim është bërë nëpërmjet Eurocontrol, e cila ka njoftuar AAC mbi objektin e urdhrin të ekzekutimit, me anë të shkresës Ref. DCF 12._20 të datës 7 dhjetor 2020.

-c. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përballojë shpenzimet ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për çështjen e ngrirjes së llogarive të Republikës së Shqipërisë në EURO. , sipas Urdhër Ekzekutimit të Autoriteteve Belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë Belge të datës 1 Dhjetor 2020, pra do t’i duhet të përshijë në programin ekonomik të viti 2021 shpenzimet të asistencës juridike, që nga auditimi rezultuan se nuk ka asnjë korrespondencë me Avokaturën e Shtetit n.q.s ka/ose jo të kontraktuar zyrë avokatie dhe sa shkojnë kostot e gjykimit.

-c. Edhe pse çështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e Shtetit dhe AAC, ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacionit Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe urgjencën e kohës, Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008, si dhe të Kapitulli 4 pika D të VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, pasi ka deleguar një të drejtë AAC që është tagër ekskluziv i saj.

-d. Mbledhja e Këshillit Drejtues e datës 29.01.2021 me pikë të parë të rendit të ditës mbi mbarëvajtjen e procesit të kundërshtimit të veprimeve përmbareme lidhur me llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO. , është zhvilluar në fillim të viti buxhetor, ku AAC gjendet në pozitë financiare të vështirë që pasqyron qartazi vetëm

	një krizë të mprehtë likuiditeti, si rrjedhojë e mungesës së tarifës en-route dhe uljen rreth 50% të tarifës së sigurisë për shkak të numrit të ulët të fluturimeve nga kufizimet e COVID-19.
Kriteri:	Ligji nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij neni 5 “Këshilli drejtues”, pika 1.
Ndikimi/Efekti:	Me pasoja financiare për buxhetin e Autoritetit të Aviacionit Civil.
Shkaku:	Mungesa e vëmendjes së duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 1.1:	Nga Organet Drejtuese të AAC ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pozita financiare e AAC e krijuar, si rrjedhojë urdhrin të ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO.” dhe pamundësia e deritanishme e zgjidhjes së kësaj situatë nga institucionet e përfshira në këtë çështje si Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, jo vetëm për sa i përket mos përfitimit të tarifës en-route, por edhe për shpenzimet e pritëshme të asistencës juridike (shpenzime avokatie).
2. Titulli i gjetjes:	Rregullorja Këshillit Drejtues nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura, si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja me vendime qarkulluese.
Situata:	Këshilli Drejtues për vitin 2020 ka marrë 7 vendime qarkulluese. Konkretisht Vendimi nr. 2 datë 14.05.2020, vendimi nr. 4 datë 15.06.2020, vendimi nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 datë 30.07.2020, vendimi nr. 12 datë 16.11.2020, ndërsa për vitin 2021 ka marrë 2 vendime qarkulluese konkretisht vendimin nr. 1 datë 08.01.2021 dhe vendimi nr. 2 datë 23.03.2021. Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja me vendime qarkulluese.
Kriteri:	Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja me vendime qarkulluese.
Ndikimi/Efekti:	Risk për vendimmarrjen e gabuar.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë.

Rekomandimi 2.1:	<p>- Këshillit Drejtues të bëjë amendimin e Rregullores “Për rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 68, datë 23.02.2017, ku të përcaktoj rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja e tyre.</p> <p>-Këshilli Drejtues të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të rritet performanca e AAC, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur vendimmarrjet nëpërmjet vendimeve qarkulluese.</p>
-------------------------	---

3. Titulli i gjetjes:	Në dy mbledhje të Këshillit Drejtues nuk është mbajtur proces verbal, si dhe një vendim nuk është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.
Situata:	<p>Vendimi nr. 2 datë 23.03.2021 “Mbi miratimin e financimit dhe kontraktimit të “Asistencë për negociim të termave të kontratës konçensionare të Aeroportit të Vlorës”. Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje, është protokolluar me nr. 488/2 prot., datë 23.03.2021, dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.</p> <p>-Vendimi nr. 4 datë 15.06.2020 “Për Miratimin e Propozimit për Përfshirjen në Paketën Lehtësuese Financiare për Shkak të Situatës së Krijuar nga Covid-19, të Organizatës Europiane për Sigurinë e Lundrimit Ajror (Euro.). Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, ndërsa vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe kryetari, është protokolluar në datën 15.06.2020 me nr. 992/1 prot., dhe është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika 5, Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 2.
Ndikimi/Efekti:	Mos publikimi i vendimeve të Institucionit në web faqen e internetit, krijon mos respektim të ligjit dhe mungesë të transparencës së kërkuar.
Shkaku:	Mungesa e vëmendjes së duhur institucionale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 3.1:	Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mbledhjet e Këshillit Drejtues, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

4. Titulli i gjetjes:	Mos paraqitje në Këshillin Drejtues i një raporti të hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara.
Situata:	Nuk është paraqitur në këshillin drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera

	individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit.
Kriteri:	Ligji nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, neni 13, pika iii.
Ndikimi/Efekti:	Mos dërgim raporti të hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, në Këshillin Drejtues rrit rrezikun e vendimarrjeve të magnta dhe të pa qarta me mundësinë e interpretimit të ceshtjeve sipas intersit të palëve.
Shkaku:	Mungesa e vëmendjes së duhur institucionale.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 4.1:	Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, dërgimit të raportit të hollësishëm në Këshillin Drejtues për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave dhe të dhënave të regjistrave.

2.3. Planifikimi, realizimi dhe monitorimi i programit ekonomik.

Auditimi u krye me zgjedhje³,

Konkretisht u auditua periudha 01.09.2019-30.04.2021.

Për vitin 2019, Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 20, datë 28.12.2018 dhe është dërguar te Ministri për informacion me shkresën nr. 2258/2 prot., datë 31.12.2018.

Ndryshimet vijuese:

-Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 7, datë 13.06.2019

Për vitin 2020, Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 15, datë 18.12.2019 dhe është dërguar te Ministri për informacion me shkresën nr. 446 prot. datë 21.02.2020.

Ndryshimet vijuese:

Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 2 datë 14.05.2020

Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 3 datë 04.06.2020

Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 7 datë 05.08.2020

Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 12 datë 16.11.2020

Për vitin 2021, Programi Ekonomik është miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 13, datë 24.12.2020 dhe është dërguar te Ministri për informacion me shkresën nr. 35 prot. datë 08.01.2021.

Ndryshimet vijuese:

³Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) “Kampioni i auditimit”, i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: “Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur” .

-Vendimi i Këshillit Drejtues nr. 2, datë 23.03.2021

Në zbatim të Nenit 20 të Ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, paraqitja te Ministri e raporteve vjetore të veprimtarisë së AAC përfshirë të gjitha vendimet e marra nga Këshilli Drejtues është kryer si më poshtë:

Viti 2017 Raporti për MIEme nr. 855 prot., datë 27.04.2018

Viti 2018 Raporti për MIE me nr. 818 prot., datë 25.04.2019

Viti 2019 Raporti për MIE me nr. 810 prot., datë 29.04.2020

Viti 2020 Raporti për MIE me nr. Prot. 722, datë 27.04.2021

Miratimet e buxhetit fillestar të Autoriteti i Aviacionit Civil për vitin 2019, 2020 dhe 4-mujori 2021, paraqiten sipas pasqyrës së mëposhtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani i vitit 2019		Plani i vitit 2020		Plani i vitit 4-mujori i parë 2021	
		Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzime	Të Ardhurat	Shpenzime
1	Trashëguar të ardhurat e viti kaluar	181,846		32,585		79,788	
2	Plani i të ardhurave viti ushtrimor	397,300		389,400		155,900	
3	Financime nga buxheti i shtetit	0		0		0	
4	Financime të huaja	0		0		0	
5	Totali të Ardhura	579,146		421,985		235,688	
6	Total Shpenzime		346,474		345,216		233,788
6/a	Shpenzime për pagat (600+601)		201,664		197,392		163,723
6/b	Trajnim stafi dhe takime		66,500		56,844		7,900
6/c	Shpenzime operative 602		78,310		90,980		62,165
6/c/1	Mallra		10,430		9,070		5,340
6/c/2	Furnitura dhe shpenzime		27,750		31,643		21,263
6/c/3	Shërbime gjithsej		18,640		28,777		19,451
6/c/4	Tatime, taksa etj		11,340		11,340		10,461
6/c/5	Shpenzime financiare		650		650		650
6/c/6	Shpenzime për vendime gjyqësore		5,000		5,000		5,000
6/c/7	Amortizimi		4,500		4,500		
6/c/8	Të tjera		0		0		
7	Investime		232,672		76,769		1,900

Burimi i të dhënave AAC

Programimi dhe realizimi i shpenzimeve për vitet 2019, 2020 dhe 4-mujorin e parë 2021 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2019 (Programi Ekonomik i Rish.)			Viti 2020 (Programi Ekonomik i Rish.)			4-mujori parë		
		Plan	Fakt	Real. %	Plan	Fakt	Real. %	Viti 2021		
								Plan	Fakt	Real. %
	Totali (1+2+3+4)	579,146	309,485	53	269,897	186,621	69	234,728	55,130	24
1	Shpenzime për pagat (600+601)	201,664	146,318	73	150,000	123,896	83	163,723	43,604	27
2	Trajnim stafi dhe takime	66,500	33,397	50	23,700	2,529	11	7,900	575	7
3	Shpenzime operative 602	113,315	63,952	56	75,902	52,409	69	63,124	10,951	18

3/1	Mallra	13,210	6,393	48	6,190	3,836	62	5,340	1,112	21
3/2	Furnitura dhe shpenzime	35,340	6,907	20	15,473	6,988	45	21,263	1,144	5
3/3	Shërbime gjithsej	43,275	31,966	74	25,628	18,070	71	20,410	4,379	23
3/4	Tatime dhe taksa	11,340	9,644	85	10,461	9,581	92	10,461	4,316	41
3/5	Shpenzime financiare	650	0	0	650			650	0	0
3/6	Shpenzime për vendime gjyqësore	5,000	9,040	181	17500	13,934	80	5,000	0	0
3/7	Amortizimi	4,500	0							
4	Investime	197,667	65,816	33	20,295	7,787	38	940		

Burimi i të dhënave AAC

Programimi dhe realizimi i të ardhurave për vitet 2019, 2020 dhe 4-mujorin e par 2021 paraqiten në mënyrë të detajuar si më poshtë vijon:

Në programim e AAC, burimi i shpenzimet janë të ardhurat nga burime të veta që realizon AAC nga aktiviteti i saj të cilat janë parashikuar në Ligjin nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr. 10233 datë 11.02.2010 "Për autoritetin aviacionit civil", i ndryshuar, Udhëzimin e Përbashkët i MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 "Përcaktimin e tarifave në Aviacionin Civil" dhe Udhëzimin nr. 1362, datë 16.3.2016 "Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit".

Të ardhurat e AAC realizohen nga tarifat e vendosura për veprimtaritë që kryen Autoriteti në bazë të kostos. Të ardhurat e Autoritetit përfshijnë: Të ardhurat nga tarifat e rrugës (en-route), të ardhura nga tarifa e sigurisë së aviacionit, të ardhurat nga autorizimet, licensimet dhe certifikimet e parashikuara në Kodin Ajror të Republikës së Shqipërisë, të ardhurat nga sanksionet në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe të ardhura të tjera të lejuara nga legjislacioni në fuqi.

Në mënyrë të detajuar programimi dhe realizimi i të ardhurave paraqitet në tabelën si më poshtë vijon:

Në 000/lekë

Nr	Emërtimi	Viti 2019 (Programi Ekonomik i Rish.)			Viti 2020 (Programi Ekonomik i Rish.)			4-mujori par 2021		
		Plan	Fakt	Real.%	Plan	Fakt	Real.%	Plan	Fakt	Real.%
1	Të ardhurat	579,146	571,712	99	269,897	261,779	97	235,688	38,896	16
A	Tarifa mbikalimit ^e	167,000	167,000	100	82,763	87,783	106		7,853*	
B	Tarifa e sigurise	211,000	218,185	103	87,599	75,574	86	135,000	20,973	16
C	Licenca Aeroportit ^e	7,000	6,169	88	6,296	6,625	105	6,400	6,161	96
D	Te ardhura te tjera	12,300	12,429	101	13,451	12,009	89	14,500	3,909	27
E	Te Ardhura te mbartura nga vitet e tjera	181,846	181,846	100	79,788	79,788	100	79,788		

Burimi i të dhënave AAC

*Realizimi i të ardhurës nga tarifa en-route për 4 mujorin e parë të vitit 2021, i përket të ardhurës së muajit Shkurt 2020, e arkëtuar me vonesë.

-a. Të ardhurat nga tarifa e koston en-route (Tarifa e mbikalimit)

Tarifa e rrugës (en-route), është e ardhur e AAC e cila mbliidhet dhe faturohet nga EURO.. Kjo e ardhur merret nëpërmjet ofruesit të shërbimit të lundrimit ajror Albcontrol, duke qenë se tarifa en-route arkëtohet në total bashkë me koston e Albcontrol-it.

Kosto e AAC-së për pjesën en-route, bazohet në VKM nr. 342, datë 12/4/2006 “Për përcaktimin e detyrimit të anta sha-së, për kryerjen e pagesave, që rrjedhin nga anëtarësimi në eurocontrol”. Kjo kosto përcaktohet në Marrëveshjen Multilaterale me Eurokontrollin dhe përfaqëson koston e AAC-së për aktivitetin en-route që kalkulohet sipas metodologjisë së Eurokontrollit në unit rate për Shqipërinë. Vlen të theksohet se kjo kosto është variabël dhe reflekton vetëm shpenzimet që bën realisht institucioni për këtë aktivitet. Ndryshimet që mund të lindin midis programit dhe shpenzimeve në fakt duhet të reflekton në unit rate në vitet pasardhëse.

E ardhura nga tarifa en-route për vitin 2019 ka zënë 29 % të të ardhurave (167,000 mijë lekë : 571,712 mijë lekë = 29 %), për vitin 2020 nga ka zënë 34 % të të ardhurave (87,783 mijë lekë : 261,779 mijë lekë = 34 %) dhe për 4-mujorin e parë 2021 nuk ka zënë asnjë % të të ardhurave.

Për vitin 2020, masat kufizuese kundër përhapjes së COVID-19 krijuan një krizë e thellë likuiditeti në sektorin e aviacionit civil. Për të zbutur riskun e mungesës së të ardhurave në Qershor të vitit 2020, AAC është angazhuar në paketën lehtësuese financiare të EURCONTROL dhe ka nënshkruar me Alb. marrëveshjen për ndarjen e kësaj pakete duke rishikuar tarifën sipas periudhës së disbursimit të kredisë dhe pagesës së interesave.

Nga kjo paketë lehtësuese AAC ka përfituar 21.4 mil lekë nga 28.5 mil të angazhuara, edhe pse EURO. e ka disbursuar të gjithë vlerën të llogaritë e Albcontrol nëpërmjet 4 kësteve. AAC nëpërmjet shkresës nr. 2130, datë 28.12.2020 ka përcjellë në Alb. faturën për muajt Shtator 2020 në vlerën 12,425,138 lekë dhe Shkurt 2020 në vlerën 7,852,490 lekë sipas Marrëveshjes “Mbi ndarjen e paketës financiare të kredisë së EURO. dhe rishikimin e tarifës së AAC për vitin 2020”, protokolluar në AAC me nr. 1348 prot., datë 30.07.2020. E ardhura nga tarifa en-route për muajt Shtator 2020 rezultoi e pa arkëtuar nga Alb. edhe pse Euro. ka disbursuar këstin e katërt të ndihmës financiare në datë 29.09.2020 në vlerën 1,199,505.68 EUR. Pra, detyrimet e faturuara që Alb. ka ndaj AAC është në vlerën 12,425,138 lekë.

-b. Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit.

Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, merret nëpërmjet Aeroporti Nënë Tereza (këtu e në vijim TIA). Për të garantuar sigurinë, TIA do të ketë të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarifë sigurie ("Pagesa e Sigurisë") deri në 4 EUR për pasagjer (2 EUR për pasagjeret që mbërrijnë dhe 2 EUR për pasagjeret që largohen) me qëllim që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënien e shërbimit të sigurisë. TIA do të paguaj 25% (**ose 1 euro**), të tarifës së sigurisë të mbledhur AAC në baza mujore me vonesë, dhe do të ketë të drejtën të mbajë diferencën. TI., bazuar në Ligjin nr. 9312, datë 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44” do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, këto regjistrime do t'i paraqiten AAC-së për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme.

Nga AAC nuk është kryer asnjë inspektim në Aeroporti Nënë Tereza referuar SHTOJCËS 44.

E ardhura nga tarifa e sigurisë së aviacionit për vitin 2019 ka zënë 38 % të të ardhurave (218,185 mijë lekë : 571,712 mijë lekë = 38 %), për vitin 2020 ka zënë 29 % të të ardhurave (75,574 mijë lekë : 261,779 mijë lekë = 29 %) dhe për 4-mujorin e parë 2021 ka zënë 54 % të të ardhurave (20,973 mijë lekë : 38,896 mijë lekë = 54 %).

Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart, pasi të dhënat mbi pasagjer në dalje duke llogaritur 1 euro për pasagjer për llogari të AAC dhe tarifa e komunikimi

duke llogaritur 25 euro për fluturim, bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza. Pra nuk ka as verifikim nga ndonjë burim tjetër p.sh. operatorët e fluturimit, etj, për saktësinë e pasagjerëve që raporton TIA.

Referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtron aktivitetin AAC, nuk i mundësohet të kërkoj të dhëna të tjera nga burime alternative për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga TI.

Për sa më sipër grupi i auditimit mori në përzgjedhje dy operatorë shqiptar të cilët kryejnë fluturime të rregullta (skedulë) në TI. Konkretisht u morën në auditim operatori A. dhe A. A. Duke marrë për bazë aplikimet për leje fluturimi dërguar nga dy kompanitë e mësipërme për sezonin veror IATA 2020, u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Gjithashtu, këto të dhëna i referohen vetëm numrit të fluturimeve sipas frekuencës së kërkuar nga secili operator. Bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare”, AAC nuk ka tagër ligjor për ti kërkuar operatorëve të dhënat statistikore për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Nga informacioni verbal i dhënë nga Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, jemi bërë me dije se AAC po bashkëpunon me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 (e cila ka pësuar 5 ndryshime), “ Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”. Aktualisht Bashkimi Evropian ka në fuqi Rregulloren me nr. 437/2003 “Mbi statistikën në lidhje me transportin e udhëtarëve, transportin e mallrave dhe postës” (Regulation (EC) No 437/2003 of the European Parliament and of the Council of 27 February 2003 on statistical returns in respect of the carriage of passengers, freight and mail by air). Pra Bashkimi Evropian e ka, Republika e Shqipërisë nuk ka një rregullore për këtë qëllim.

-c. E ardhura nga Liçensa e Aeroportit.

Kjo e ardhur është përcaktuar në Ligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes së konçensionit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë Konçensionare Tirana Airport Partners sh.p.k, për ndërtimin, vënien në punë, operimin dhe mirëmbajtjen e Aeroportit Ndërkombëtar “Nënë Tereza” dhe për dhënien e disa stimuljeve kësaj Shoqërie. Kjo e ardhur është në vlerën 50,000 Euro në vit dhe paguhet në një pagesë të vetme nga Aeroporti.

-d. Të ardhura të tjera nga licencat, certifikime, etj.

Përfshihen të ardhurat që AAC realizon nga dhënia e liçensave, autorizimeve dhe certifikimeve në fushën e aviacionit civil, në bazë të Udhëzimit të Përbashkëti MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 “Përcaktimin e tarifave në Aviacionin Civil”.

Këto të ardhura për vitin 2019, ka zënë 2 % të të ardhurave (12,429 mijë lekë : 571,712 mijë lekë = 2 %), për vitin 2020 ka zënë 5 % të të ardhurave (12,009 mijë lekë : 261,779 mijë lekë = 5 %) dhe për 4-mujorin e parë 2021 ka zënë 10 % të të ardhurave (3,909 mijë lekë : 38,896 mijë lekë = 10 %).

Nga Drejtorët Ekzekutiv, nuk është paraqitur në këshillin drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, neni 13, pika iii.

Për periudhën nga data 10.11.2017 -22.04.2020, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil vendimet lidhur me dhënien, pezullimin apo anulimin e licencave të operimit. Veprim në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 11 të Udhëzimit të Ministri të Punëve

Publike Dhe Transportit nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi Rregullat e Zbatueshme të Operimit në Fushën e Shërbimeve Ajrore", i ndryshuar.

Për këtë arsye për zbatimin e tarifave ne zbatim te Udhëzimit te Përbashkëti MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 "Përcaktimin e tarifave në Aviacionin Civil" dhe Udhëzimit nr. 1362, datë 16.3.2016 "Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit", u krye auditim me zgjedhje⁴ për liçencat, certifikime, etj nga operatorët si me poshtë:

1. Operatori A.

-a. Pajisja me licence e operatorit ajror ndërkombëtar Rreg p1 / 5 vite, për periudhën 01.09.2019 deri ne datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultojë se nuk është lëshuar nga AAC.

-b. Pajisja me licence COA Ndërkombëtar p1 / 1 vit, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019 është lëshuar me nr. 42, datë 04.04.2019, datë pagese 05.04.2019, për vlerën 500,000 lekë. Për vitin 2020 është lëshuar me nr. 46, datë 08.04.2020, datë pagese 09.04.2020, për vlerën 500,000 lekë, për vitin 2021 është lëshuar me nr. 64, datë 12.04.2021, datë pagese 21.04.2021, për vlerën 500,000 lekë.

-c. Pajisja me Certifikatë te Vlefshmërisë Ajrore P3 / 1 vit – formulë, për periudhën 01.09.2019 deri ne datën 30.04.2021 dhe nga verifikimi rezultojë se nuk është lëshuar nga AAC për vitin 2019, për vitin 2020 është lëshuar me nr. 100, datë 30.07.2020, datë pagese 03.08.2020, për vlerën 6,529,100 lekë.

-d. Pajisja me Certifikatë të Vlefshmërisë P4, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021 dhe nga verifikimi rezultoi se nuk është lëshuar nga AAC për vitin 2019 dhe 2020, ndërsa për vitin 2021 është lëshuar me nr. 14, datë 25.01.2021, datë pagesë 25.01.2021, për vlerën 20,000 lekë.

2. Operatori A. A.

-a. Pajisja me licencë të operatorit ajror ndërkombëtar Rreg p1 / 5 vite, për periudhën 01.09.2019 deri ne datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019 është lëshuar me nr. 45, datë 16.04.2019, datë pagese 16.04.2019, për vlerën 1,000,000 lekë.

-b. Pajisja me COA Ndërkombëtar p1 / 1 vit, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019 është lëshuar me nr. 33, datë 25.03.2019, datë pagese 26.03.2019, për vlerën 500,000 lekë. Për vitin 2020 është lëshuar me nr. 45, datë 08.04.2020, datë pagesë 10.04.2020, për vlerën 500,000 lekë, për vitin 2021 është lëshuar me nr. 63, datë 12.04.2021, datë pagesë 19.04.2021, për vlerën 500,000 lekë.

-c. Pajisja me Certifikë të Vlefshmërisë Ajrore P3 / 1 vit – formulë, për periudhën 01.09.2019 deri ne datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019 është lëshuar me nr. 27, datë 19.03.2019, datë pagesë 19.03.2019, për vlerën 7,020,000 lekë, ndërsa për vitin 2020 dhe 2021 nuk është lëshuar.

-d. Pajisja me Certifikatë të Vlefshmërisë P4, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është lëshuar.

⁴ Auditimi me zgjedhje zhvillohet sipas ISA 530 (i rishikuar) "Kampioni i auditimit", i cili tregon tipet e ndryshme të testeve që audituesi kryen.

Përkufizimi i një kampioni të zgjedhur për auditim sipas ISA 530 është: "Aplikimi i procedurave të auditimit në më pak se 100% të artikujve brenda një grupi të caktuar të transaksioneve ose llogarive kontabël etj, në atë mënyrë që të gjithë kampionët të kenë të njëjtin shans për tu zgjedhur".

3. Albcontrol

a. Aprovim i qendrave të trajnimit P4 / 1 vit, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitet 2019, 2020 dhe 2021 nuk është lëshuar.

4. TIA

-a. Pajisja me Licencë e operimit të aeroportit P1(50000 Euro) /1 vit, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019 është lëshuar me nr. 44, datë 05.04.2019, datë pagesë 30.04.2019, për vlerën 6,261,000 lekë. Për vitin 2020 është lëshuar me nr. 44, datë 08.04.2020, datë pagesë 16.04.2020, për vlerën 6,296,000 lekë, për vitin 2021 është lëshuar me nr. 73, datë 28.04.2021 për vlerën 6,161,500 lekë.

6. **Licensë Agjencie te shitjes Biletave ajrore P9 / 6 muaj, për periudhën 01.09.2019 deri në datën 30.04.2021, dhe nga verifikimi rezultoi se për vitin 2019, 2020 dhe 2021 nuk ka të lëshuara, pasi licencohen në QKB.**

Tarifat e sipër cituara janë kryer në zbatim te Udhëzimit te Përbashkëti MTI dhe MF nr. 2225, datë 13.05.2013 “Përcaktimin e tarifave në Aviacionin Civil” dhe Udhëzimit nr. 1362, datë 16.3.2016 “Mbi rregullat në vendosjen e tarifave të aeroportit”.

Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 31.12.2019:

Në 000/lekë

Detyrime e AAC	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2018/lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2019 - 31.12.2019 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2019/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2019/ lekë
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrimi total me TVSH	3,245		3,245	2,342	903
Vendime gjyqësore	-	6,235	6,235	6,235	-
Të tjera	-				
TOTALI	3,245	6,235	9,480	8,577	903

Burimi i të dhënave AAC

Për vitin 2019, detyrimet afatshkurta zëri të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit janë të raportuara në vlerën 4,719 mijë lekë, në PF të vitit 2019, nga të cilat detyrime të mbartura nga periudhat paraardhëse janë 3,245 mijë lekë, pra me një diferencë prej 1,474 mijë lekë, që i përket detyrimeve të vitit 2019, të cilat mbyllen brenda 3-mujorit të parë të vitit 2020.

Detyrimet e mbartura janë si me poshtë:

Furnitori E. (tregtar) vlera e detyrimit 864 mijë lekë.

Furnitori P. S. (tregtar) vlera e detyrimit 29 mijë lekë.

Furnitori D. K. (tregtar) vlera e detyrimit 3.6 mijë lekë.

Furnitori A. SHPK (tregtar) vlera e detyrimit 7.23 mijë lekë.

Furnitori Se. Con. (tregtar) vlera e detyrimit 2,342 mijë lekë.

Zhvillimi i shumës së detyrimit të prapambetur në fund të periudhës 31.12.2020

000/lekë

Detyrime e AAC	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2019/lekë	Detyrimi i krijuar në periudhën 01.01.2020 - 31.12.2020 (lekë)	Total detyrime/lekë	Shlyerja e detyrimeve gjate vitit 2020/lekë	Mbetja e detyrimeve në fund të periudhës 31.12.2020/ lekë
----------------	---	--	---------------------	---	---

a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
Detyrimi total me TVSH	913		913		913
Vendime gjyqësore	-	13,295	13,295	13,295	-
Të tjera	-				
TOTALI	913	13,295	14,208	13,295	913

Burimi i të dhënave AAC

Për vitin 2020, detyrimet afatshkurta zëri të pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit janë të raportuara në vlerën 3,770,959 lekë, në PF të vitit 2020, nga të cilat detyrime të mbartura nga periudhat paraardhëse janë 913,010 lekë, pra me një diferencë prej 2,857,949 lekë, që i përket detyrimeve të vitit 2020, të cilat mbyllen brenda 3-mujorit të parë të vitit 2021.

Detyrimet e mbartura për periudhat e mëparshme janë si me poshtë:

Furnitori E. (tregtar) vlera e detyrimit 864 mijë lekë.

Furnitori P. S. (tregtar) vlera e detyrimit 29 mijë lekë.

Furnitori D. K. (tregtar) vlera e detyrimit 3.6 mijë lekë.

Furnitori A. SHPK (tregtar) vlera e detyrimit 7.23 mijë lekë.

Furnitori N. Prom. (tregtar) vlera e detyrimit 9.6 mijë lekë.

Për mos kryerje inspektimi në Aeroportin Nënë Tereza, referuar ë Ligjit nr. 9312, datë 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare”, “SHTOJCA 44”, për tarifën e sigurisë së aviacionit mbajnë përgjegjësi K. K. me detyrë ish-Drejtor Ekzekutiv për periudhën 01.09.2019 deri më 22.04.2020 dhe E. K. me detyrë Drejtor Ekzekutiv për periudhën 22.04.2020-30.04.2021.

1. Titulli i gjetjes:	Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart pasi bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza.
Situata:	<p>Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, merret nëpërmjet Aeroporti Nënë Tereza. Për të garantuar sigurinë, TIA ka të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarife sigurie "Pagesa e Sigurisë" deri në 4 EUR për pasagjer (2 EUR për pasagjeret që mbërrijnë dhe 2 EUR për pasagjeret që largohen) me qëllim që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënien e shërbimit të sigurisë. TIA do të paguaj 25% (ose 1 euro), të tarifës së sigurisë të mbledhur AAC në baza mujore me vonesë, dhe do të këtë të drejtën të mbajë diferencën. TIA, bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44” do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, këto regjistrime do t'i paraqiten AAC-së për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme.</p> <p>Nga AAC nuk është kryer asnjë inspektim në Aeroporti Nënë Tereza referuar SHTOJCËS 44.</p> <p>Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart, pasi të dhënat mbi pasagjer në dalje duke llogaritur 1 euro për pasagjer për llogari të AAC dhe tarifa e komunikimi duke llogaritur 25 euro për fluturim, bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza. Pra nuk ka as verifikim nga ndonjë burim tjetër p.sh. operatorët e fluturimit, për saktësinë e pasagjerëve që raporton TIA.</p>

	<p>Referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtron aktivitetin AAC, nuk i mundësohet të kërkoj të dhëna të tjera nga burime alternative për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga TIA.</p> <p>Për sa më sipër grupi i auditimit mori në përzgjedhje dy operatorë shqiptar të cilët kryejnë fluturime të rregullta (skedulë) në TIA. Konkretisht u morën në auditim operatori A. dhe A. A. Duke marrë për bazë aplikimet për leje fluturimi dërguar nga dy kompanitë e mësipërme për sezonin veror IATA 2020, u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Gjithashtu, këto të dhëna i referohen vetëm numrit të fluturimeve sipas frekuencës së kërkuar nga secili operator. Bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare”, AAC nuk ka tagër ligjor për ti kërkuar operatorëve të dhënat statistikore për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Nga informacioni verbal i dhënë nga Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, jemi bërë me dije se AAC po bashkëpunon me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 (e cila ka pësuar 5 ndryshime), “Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”. Aktualisht Bashkimi Evropian ka në fuqi Rregulloren me nr. 437/2003 “Mbi statistikën në lidhje me transportin e udhëtarëve, transportin e mallrave dhe postës” (Regulation (EC) No 437/2003 of the European Parliament and of the Council of 27 February 2003 on statistical returns in respect of the carriage of passengers, freight and mail by air). Pra Bashkimi Evropian e ka, Republika e Shqipërisë nuk ka një rregullore për këtë qëllim.</p>
Kriteri:	Ligji nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44”.
Ndikimi/Efekti:	Risk i lart në të ardhurat e përfituara nga tarifa e sigurisë.
Shkaku:	Keq interpretim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 1.1:	Nga Drejtori Ekzekutiv të merren masa për kryer inspektime të herë pas herëshme në regjistrat e mbajtura nga TIA për numrin e pasagjerëve dhe shumën e tarifës së sigurisë së mbledhur.
Rekomandimi 1.2:	Nga Drejtori Ekzekutiv t’i kushtohet vëmendje e duhur institucionale bashkëpunimit me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 “Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”, edhe për AAC.
2. Titulli i gjetjes:	Mos publikim në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil.
Situata:	Për periudhën nga data 10.11.2017 -22.04.2020, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil vendimet lidhur me dhënien, pezullimin apo anulimin e licencave të operimit. Veprim në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 11 të Udhëzimit të Ministri të Punëve

	Publike dhe Transportit nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi Rregullat e Zbatueshme të Operimit në Fushën e Shërbimeve Ajrore", i ndryshuar.
Kriteri:	Udhëzimi i Ministri të Punëve Publike dhe Transportit nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi Rregullat e Zbatueshme të Operimit në Fushën e Shërbimeve Ajrore", i ndryshuar, neni 1, pika 3.
Ndikimi/Efekti:	Mos publikimi i vendimeve të Institucionit në web faqen e internetit, krijon mos respektim të ligjit dhe mungesë të transparencës së kërkuar.
Shkaku:	Mungesa e vëmendjes së duhur institucionale.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 2.1:	Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara për periudhën 10.11.2017 - 22.04.2020, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

2.4. Zbatimi i strukturës organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Për periudhën e auditimit nga 01.10.2019 – 01.04.2020 niveli i pagave në AAC ka qenë i miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 62, datë 21.11.2016, mbi miratimin e Rregullores “Për strukturën, nivelin e pagave bazuar në klasifikimin e vendeve përkatëse të punës dhe shpërblimet për performancë në Autoritetin e Aviacionit Civil”. Nga 01.04.2020-01.09.2020 për shkak situatës të krijuar nga pandemia COVID 19 dhe për përballimin e situatës së vështirë financiare , niveli i pagave është reduktuar me 30% me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.1, datë 24.04.2020 “Për një ndryshim të rregullores së pagave nr.299, datë 21.11.2016, miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr.62, datë 21.11.2016 “ Ky vendim ka ardhur dhe pas relacionit të dërguar nga Titullari i AAC ku i ka parashtruar vështirësitë ekonomike të shoqërisë e cila ka ardhur si pasojë e pandemisë ku aviacioni ka pësuar goditje në mënyrë direkte për shkak të pezullimit të fluturimeve në botë. Niveli i pagave ka ndryshuar sërish me vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 11.09.2020 “ Për një ndryshim të vendimit nr. 1, datë 24.04.2020 I KD ”, ku pagat janë rikthyer në nivelin para pandemisë. Ky vendim ka ardhur pasi që nga qershori i vitit 2020 fluturimet ndërkombëtare kanë rifilluar aktivitetin normalisht. Në lidhje me strukturat e AAC, konstatohet se ato janë miratuar si më poshtë vijon:

-Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 28.06.2019.

-Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 28.06.2019.

-Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 10, datë 27.10.2020, miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, me shkresën nr. 359, datë 18.12.2020, protokolluar në AAC me nr. 2118, datë 28.12.2020.

Nga auditimi i këtyre vendimeve, konstatohet se:

-Në 2 raste struktura nuk është miratuar nga Ministri, në kundërshtim me Ligjin nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 16, pika 1, e cila përcakton se: “1. Struktura dhe organika e autoritetit miratohen nga ministri, pas konsultimit me ministrin përgjegjës për administratën publike. Këshilli drejtues miraton nivelet e pagave të punonjësve, brenda kufirit minimal e maksimal, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësisë financiare dhe pas miratimit nga ministri”.

Nga K. K. me detyrë Drejtor Ekzekutiv janë marrë në punë me kontratë 2 punonjëse pastrimi, përkatësisht V. Sh. me pagë mujore bruto 45,581 lekë, M. P. me pagë bruto 46,080 lekë si edhe specialistja A. M. me pagë bruto 96,000 lekë.

Me V. Sh. dhe M. P. janë nënshkruar kontratat si më poshtë :

Me datë 10.07.2019 është firmosur kontrata për një periudhë 3 mujore.

Kontrata nr.500, datë 10.10.2019 mes K. K. dhe V. Sh. për një periudhë 6 mujore.

Kontrata nr.501, datë 10.10.2019 mes K. K. dhe M. P. për një periudhë 6 mujore.

Kontrata me nr.1743/1, date 20.09.2019 mes A. M. dhe K. K. , për një periudhë kohore 3 mujore në pozicionin e inspektorit në Sektorin e Mbikëqyrjes Operacionale.

Për vitin 2020 janë lidhur kontratat si më poshtë :

Kontrata nr.158, datë 08.04.2020 mes K. K. dhe V. Sh. për një periudhë 6 mujore.

Kontrata nr.157, datë 08.04.2020 mes K. K. dhe M. P. për një periudhë 6 mujore.

Kontrata nr.362, datë 08.04.2020 mes E. K. dhe V. Sh. për një periudhë 6 mujore.

Kontrata nr.361, datë 08.04.2020 mes E. K. dhe M. P. për një periudhë 6 mujore.

Në strukturën e vitit 2019 janë miratuar 73 të punësuar por në muajin qershor organika është shtuar dhe me 4 punonjës (veprim ky që nuk është miratuar nga Ministri).

Për vitin 2020 janë miratuar 77 punonjës.

Për vitin 2021 janë miratuar 79 punonjës.

	2019		2020		2021	
	plan	fakt	plan	fakt	plan	fakt
<i>Janar</i>	73	60	77	73	79	62
<i>Shkurt</i>	73	60	77	66	79	63
<i>Mars</i>	73	65	77	66	79	63
<i>Prill</i>	73	63	77	66	79	62
<i>Maj</i>	73	63	77	63		
<i>Qershor</i>	77	63	77	64		
<i>Korrik</i>	77	68	77	63		
<i>Gusht</i>	77	68	77	63		
<i>Shtator</i>	77	68	77	61		
<i>Tetor</i>	77	69	77	62		
<i>Nentor</i>	77	72	77	63		
<i>Dhjetor</i>	77	73	77	63		

Nga auditimi i strukturës organizative është konstatuar se numri i miratuar i punonjësve nuk është tejkaluar , madje nuk është arritur asnjëherë numri i punonjësve të miratuar, siuate kjo e ardhur për arsye të vendeve të shumta vakante (veçanërisht në drejtorinë e mbikëqyrjes së sigurisë në operim të operatorëve ajror), ku pjesa më e madhe e teknikëve janë në prag pensioni dhe mungesa e aplikimeve në këto vende pune mund të sjellë pasoja të rënda për AAC duke qenë se kjo është një nga drejtoritë kryesore në funksionimin e institucionit.

Të dhëna për pagat:

Emërtimi	2019	2020	01.01.2021-30.04.2021
Shpenzime për pagat dhe shperblime	111,002,267	88,773,804	33,192,750

Kontribute shoqërore e shëndetësore	14,234,941	12,744,966	6,934,792
Numri i miratuar i punonjësve	73-77	77	79

Nga auditimi i pagave u konstatua se nuk ka mospërputhje mes listës së punonjësve të paguar dhe atyre të miratuar në strukturë. Gjithashtu janë mbajtur dhe sigurimet shoqërore dhe shëndetësore në përputhje me Ligjin nr.7703 datë 11.05.1993 “Për sigurimet Shoqërore”, i ndryshuar dhe Ligji nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Lidhur me dokumentacionin justifikues janë plotësuar gjithë listë prezencat mujore dhe listë pagesat janë firmosur nga specialistja e pagave, specialistja e burimeve njerëzore, shefja e financës dhe drejtori i institucionit.

Këshilli Drejtues.

Këshilli Drejtues i AAC paguhet në bazë të VKM nr.776, datë 24.9.2010 “Për caktimin e shpërblimit të kryetarit dhe anëtarëve të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Aviacionit Civil”.

Të dhënat për pagesat e Këshillit Drejtues për periudhën e auditimit janë si më poshtë:

	SHUMA	TATIMI	NETO
01.09.2019-31.12.2019	462,640	69,396	393,244
2020	1,299,780	194,967	1,104,813
01.01.2021-30.04.2021	346,360	51,954	294,406

Rregullorja e Brendshme

AAC për periudhën e auditimit ka funksionuar me Rregulloren e Brendshme të miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 5, datë 13.06.2019.

Rregullorja e Rekrutimit

Me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 6, datë 13.06.2019, është miratuar Rregullorja “Mbi rregullat e rekrutimit dhe kërkesat e punësimit në Autoritetin e Aviacionit Civil”. Në këtë rregullore janë përcaktuar kërkesat dhe kriteret që duhet të plotësohen për çdo vend pune.

Përshkrimi i pozicioneve të punës.

Nga ana e AAC për periudhën 01.10.2019-01.04.2021, është vepruar në kundërshtim me VKM nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pasi përshkrimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës është miratuar vetëm me miratimin e Këshillit Drejtues dhe jo nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga DAP.

Marrëdhëniet e punës

Në zbatim të pikës 2, të Ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, marrëdhëniet e punës për nëpunësit e autoritetit rregullohen me legjislacionin e shërbimit civil, ndërsa marrëdhëniet e punës së punonjësve administrativë rregullohen me Kodin e Punës.

Gjithashtu për marrëdhëniet e punës është në fuqi edhe Rregullorja “Mbi rregullat e rekrutimit dhe kërkesat e punësimit në Autoritetin e Aviacionit Civil”, e miratuar me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 6 datë 13.06.2019.

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore në fuqi për rregullimin e marrëdhënieve të punës, u konstatohet si më poshtë vijon:

Në lidhje me emërimet dhe largimet.

Për periudhën e auditimit janë emëruar në punë 7 punonjës, ku 2 prej tyre janë rikthyer në punë pas vendimit të gjykatës, 1 punonjëse ka ardhur si studente e ekselencës dhe 4 prej tyre pas

konkurimit në DAP. Janë larguar 13 punonjës për arsye të ndryshme (dorëheqje, pension, pezullim i përkohshëm, përfundim kontrate ose lëvizje paralele).

Telefonat.

Nga auditimi i listë pagesave për punonjësit e AAC , është konstatuar se pjesë përbërëse e pagës totale është dhe pagesa për shërbimin e telefonisë celulare. Pagesat për telefonin celular për administratën janë paguar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 5, date 20.01.2011 “Për tarifat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC”, vendim ky që është marr në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” i ndryshuar. Edhe pse ky fenomen është konstatuar dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së, vazhdon dhe zbatohet nga ana e AAC.

Për periudhën 1.11.2020-30.04.2021 pagesa e këtij shërbimi është rregulluar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 27.10.2020, konform VKM nr.673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë ”

Nga data 01.09.2019-31.10.2020 punonjësit që kanë përfituar pagesën për shërbimin e telefonive celulare në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” janë paraqitur si më poshtë:

Nr.	Emërtesa sipas strukturës së miratuar	Niveli/Klasa/Kat	Paga Bruto		Viti 2018		Viti 2019		Viti 2020 6 mujori I pare		Viti 2020 6 mujori I dyte		Viti 2021	
					sipas VKM		sipas VKM			sipas VKM		sipas VKM		sipas VKM
1	Drejtor Ekzekutiv	I/I	250,560	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1	1
2	Drejtor Drejtorie	II/II/B	185,940	8	8	4	4	6	6	6	6	6	6	6
3	Përgjegjës Sektori Sektori	III/III/A	161,746	12	12	13	13	14	14	14	14	14	14	14
4	Inspektor	IV/IV/B	139,200	18		19		21		2			2	
5	Specialiste	V/V/A	143,280	21		23		23						
6	Spektori I Shërbimeve të Brendshme	VI/VI	77,376	6		8		8						

Vlera totale e përfituar për këtë periudhë është **1,288,125 lekë** e cila ka shkaktuar efekt negativ për buxhetin e Institucionit.

Gjetjet dhe rekomandimet për këtë pikë:

1. Titulli i gjetjes:	Mos miratimi i strukturës nga Ministri.
Situata:	Miratimi i strukturës organizative vetëm me miratim të Këshillit Drejtues dhe pa miratimin e Ministrit të linjës. Konkretisht struktura organizative është miratuar vetëm me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 28.06.2019 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 28.06.2019, ndërsa struktura organizative e vitit 2021 është miratuar

	nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 359, datë 18.12.2020, protokolluar në AAC me nr. 2118, datë 28.12.2020. Në strukturën e vitit 2019 dhe 2020 janë miratuar 73 të punësuar, por organika është shtuar dhe me 4 punonjës me kontratë me Vendim të Këshillit Drejtues, struktura nuk është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilët janë përfshir në strukturën e vitit 2021.
Kriteri:	Ligji nr. 10233, datë 11.2.2010 “Për Aviacionin Civil”, i ndryshuar, neni 16, pika 1, e cila përcakton se: “1. Struktura dhe organika e autoritetit miratohen nga ministri, pas konsultimit me ministrin përgjegjës për administratën publike. Këshilli drejtues miraton nivelet e pagave të punonjësve, brenda kufirit minimal e maksimal, të përcaktuar nga Këshilli i Ministrave, në varësi të mundësisë financiare dhe pas miratimit nga ministri”.
Ndikimi/Efekti:	Marrja në punë e punonjësve pa miratimin e Ministrit.
Shkaku:	Mos respektimi i kuadrit ligjor.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim 1.1:	Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa që të ardhmen, në rastet e ndryshimit të strukturës së Institucionit, çdo ndryshim duhet të hyj në fuqi vetëm pas miratimit nga Ministri.
2. Titulli i gjetjes:	Përshkrimi i pozicioneve të punës.
Situata:	Nga ana e AAC për periudhën 01.10.2019-01.04.2021, përshkrimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës është miratuar vetëm me miratimin e Këshillit Drejtues dhe jo nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga DAP.
Kriteri:	VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.
Ndikimi/Efekti:	Për periudhën e auditimit, punonjësit e AAC kanë punuar duke ju përshtatur pozicione të punës të pa miratuara nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë dhe nga DAP.
Shkaku:	Mos respektimi i VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim 2.1:	Për shkeljen e konstatuar në përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës për periudhën e auditimit, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2021, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.
3. Titulli i gjetjes:	Pagesa të padrejta për shërbimet telefonike për punonjësit.

Situata:	<p>Nga auditimi i listë pagesave për punonjësit e AAC , është konstatuar se pjesë përbërëse e pagës totale është dhe pagesa për shërbimin e telefonisë celulare. Pagesat për telefonin celularë për administratën janë paguar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 5, date 20.01.2011 “Për tarifatat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC”, vendim ky që është marr në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” i ndryshuar. Edhe pse ky fenomen është konstatuar dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së, vazhdon dhe zbatohet nga ana e AAC.</p> <p>Për periudhën 1.11.2020-30.04.2021 pagesa e këtij shërbimi është rregulluar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 27.10.2020, konform VKM nr.673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë ” (Tabela me punonjësit që e kanë përfituar pa të drejtë këtë shërbim paraqitet në aneksin nr.3 të këtij Projekt Raporti).</p> <p>Nga data 01.09.2019-31.10.2020 punonjësit që kanë përfituar pagesën për shërbimin e telefonive celulare në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” janë paraqitur në aneksin nr.3. Vlera totale e përfituar për këtë periudhë është 1,288,125 lekë e cila ka shkaktuar efekt negativ për buxhetin e shoqërisë.</p>
Kriteri:	<p>VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” i ndryshuar.</p> <p>Vendimi të Këshillit Drejtues nr. 5, datë 20.01.2011 “Për tarifatat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC”.</p> <p>Vendimi të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 17.10.2020 “Për tarifatat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC”.</p>
Ndikimi/Efekti:	<p>Këto veprime në kundërshtim me ligjin kanë shkaktuar një efekt negativ financiar me vlerë 1,288,125 lekë.</p>
Shkaku:	<p>Caktimin e tarifës për shërbimin e telefonisë dhe pagesës së saj në kundërshtim me kuadrin ligjor.</p>
Rëndësia:	<p>E Lartë</p>
Rekomandimi 3.1:	<p>Për shkeljen e konstatuar në pagesat e kryera për shërbimet telefonike dhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2020, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.</p>

Pretendimi i subjektit:

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1678/1 prot, datë 14.10.2021(protokoll AAC) për Projektraport Raportin e Auditimit, nga Drejtori Ekzekutiv E. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

Gjetje nr. 6: Shkelja e rregullave të rekrutimit dhe kërkesave të punësimit në AAC

Në përgjigje të Projekt Raport Auditimit për Autoritetin e Aviacionit Civil në kapitullin 2.4 “Zbatimi i Strukturës Organizative, dhënien e pagave dhe shpërblimeve në përputhje me dispozitat ligjore” fq.61 mbi Dosjen e Personelit dhe përputhja e arsimit e kualifikimeve të punës si dhe mbi Gjetjen Nr. 4 “Shkelja e rregullave të rekrutimit dhe kërkesave të punësimit në AAC” fq.64-65, si dhe duke marrë në konsideratë dhe argumentimin që është bërë në Projekt Raport referuar observacioneve bërë nga ne mbi këtë çështje (fq.66-67) sqarojmë si më poshtë:

-Për znj. J. Gj. në faqen 66-67 të këtij Projekt Raporti theksohet se observacioni jonë është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit dhe kërkojmë që kjo të reflektohet.

-Për znj. D. O. në faqen 66-67 të këtij Projekt Raporti theksohet se observacioni i dërguar nga ne është marrë në konsideratë nga grupi i auditimit. Kërkojmë që kjo të reflektohet.

Për znj. A. D. : është vënë në dispozicion kopje e diplomës në degën histori dhe Filologji të Universitetit të Tiranës, 1997-2003, dhe duke qënë se se përfshihet te kriteret e shkencave shoqërore kërkojmë nga ana juaj marrjen në konsideratë të këtij fakti. Bashkëlidhur vendosim në dispozicionin tuaj Diplomën me Vërtetimin e Njesisë së Kopjes me Originalin.

Për znj. I. P. ju kemi vënë në dispozicion Diplomën e ciklit 4 vjeçar të gjuhës italiane si dhe dhe Diplomën në degën Drejtësi për vitet 2012-2015 të cilat janë të fushës shkenca shoqërore sipas kriterëve të punës që përmban vëndi i saj.

Për z. R. Gj. referuar eksperiencës në punë vjen nga një përvojë e më parshme Përgjegjes Sektori e cilën e tregon librezja e punës, duke marrë në konsideratë dhe shkollimin formim inxhinierik. Gjithashtu në vijim të shpalljes në DAP me kod numër 1851. Bashkelidhur.

Për z. G. B. në të cilën i jeni referuar se mungon “eksperienca e punës e kërkuar për këtë pozicion minimum 3 vjet” sqarojmë se

Punonjesi G. B. i eshte nenshtruar procedurës se rekrutimit sipas Ligjit Nr. 152/2013 per Nëpunësin Civil dhe eshte kualifikuar ne baze te aplikimit qe ai ka bere,

Në datën 09.08.2021 u dërgua observacioni me nr. 580/6 nga ana e Drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe Shërbimeve Mbështetëse S. R. dhe Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore dhe Arkivës M. Xh. në të cilin kanë bashkangjitur disa nga dokumentet e konstatuara me mangësi nga auditimi në terren nga grupi i KLSH-së për disa punonjës të AAC-së.

Referuar kriterëve të reja të miratuara nga Keshilli Drejtues për pozicionin e inspektorit të certifikimit, master planeve , mjedisit dhe cilesise se sherbimit ne aeroporte është vendosur një vit përvojë pune në fusha të lidhura me aviacionin, faqe 19 pika 5.2 e dokumentit bashkëlidhur. Ne kohen e rekrutimit Z.G. B. , ka pasur më shumë se 1 vit eksperience ne AAC si inspektor ne Drejtorine e Mbikqyrjes së Aeroporteve, pjese e programit te qeverise per studentet ekselente dhe arsimin përkatës. Për sa më lart Z.G. B. është marrë në përputhje me kërkesat dhe kriteret e përcaktuara nga institucioni dhe DAP.

Kërkojmë që observacionet e marrë në konsideratë dhe në projekt auditin të reflektohen në tërësinë e kësaj gjetje si dhe të merren në konsideratë argumentet shprehur më sipër referuar gjetjes mbi dosjet e personelit (fq.123 Gjetje Nr.6 mbi dosjet e personelit).

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Pretendimi qëndron. AAC ka vënë në dispozicion argument shtesë të pa vënë paraprakisht në dispozicion të grupit të auditimit në fazën e punës në AAC si dhe në observacionet për aktkonstatimet.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit:

Gjetje nr. 9: Largime të padrejta nga puna dhe proceset gjyqësore (trajtuar në faqe 63)

Gjatë periudhës së audituar, Autoriteti i Aviacionit Civil është paditur nga 13 punonjës pas shkëputjes së marrëdhënieve të punës. Shkaku i largimit për gjashtë nga këta punonjës, ka qënë fakti se janë emëruar në mënyrë të paligjshme në pozicionin e punës. Që nga data 26.02.2014, AAC-ja është pjesë e shërbimit civil dhe për rrjedhojë Drejtori Ekzekutiv nuk ka asnjë tagër kundrejt emërimit të nëpunësve civilë. Prej kësaj date, ky institucion duhet ti rregullojë marrëdhëniet e punës në zbatim të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil”, ligj i cili është akti i vetëm juridik me tagër të plotë për të njohur dhe rregulluar çdo marrëdhënie pune të nëpunësit civil. Akti i emërimit në këtë rast ka qënë një akt administrativ absolutisht i pavlefshëm referuar Nenit 108 të Kodit të Procedurave Administrative, pasi organi që ka nxjerrë aktin ka vepruar në mungesë të kompetencës. Gjendur në këto kushte, titullari i institucionit ka konstatuar pavlefshmërinë absolute të akteve të emërimit duke i shfuqizuar urdhrat e emërimit për këtë kategori punonjësish, të cilët kanë qënë punonjës me kontratë, të emëruar në kundërshtim me ligjin, në pozicione të përcaktuar në strukturë për nëpunës civilë. Gjykata e Shkallës së Parë, në të gjithë rastet e sipërpërmendur, ka gjykuar se këta punonjës, përpos faktit që janë emëruar në mënyrë të paligjshme, duhet të ishin trajtuar sipas Kodit të Punës, në momentin e shkëputjes së marrëdhënieve të punës.

Pesë procese të tjerë, kanë të bëjnë me punonjës të Aeroportit të Kukësit. Arsyeja e shkëputjes së marrëdhënieve të punës, ka qënë lidhja e kontratës konçensionare të Aeroportit të Kukësit sipas VKM-së Nr. 146, datë 20.03.2019. Të gjithë punonjësit e Aeroportit të Kukësit kanë qënë me kontrata pune të rregullta, dhe përfundimi i kontratave është kryer konform Kodit të Punës. Gjykata ka rrëzuar të gjitha paditë, në favor të AAC.

Dy raste të tjera të largimit nga puna, kanë qënë si pasojë e masës disiplinore dhe si pasojë e lirimit nga detyra për shkak të ligjit. Për këto raste Gjykata e Shkallës së Parë ka pranuar paditë, AAC ka apeluar dhe jemi në pritje të zhvillimit të proceseve në Gjykatën e Apelit Administrativ.

Referuar rekomandimit 2.1, AAC ka qënë e përfaqësuar në çdo rast, në të gjitha proceset gjyqësore fizikisht, si dhe me deklaratat e mbrojtjes, prapësimet dhe provat e dokumentuara. Për çdo proces gjyqësor, disponohet dosje e vecantë me të gjithë dokumentacionin mbështetës. Për çdo kërkesë padi, është depozituar, benda afateve ligjore, mbrojtja, deklarata e mbrojtjes me prapësimet për pretendimet përkatëse, provat e kërkuara nga gjykata si dhe diskutimet përfundimtare. Për çdo vendim kundër institucionit janë depozituar, brenda afateve ligjore ankime të vecanta dhe ankimet e themelit sipas rastit. Të gjitha proceset janë ndjekur fizikisht nga specialistët e sektorit përkatës, jo vetëm në gjykatat në Tiranë por edhe në çdo seancë në Gjykatën e Rrethit Kukës, për punonjësit e Aeroportit të Kukësit.

Për sa trajtohet nga audituesi në këtë gjetje nuk paraqitet qartë se mbi cilat evidenca është gjykuar që AAC nuk paraqitet në gjykatë apo nuk parashtron fakte mbrojtëse të cilat bëhen shkak për humbjen e gjyqeve. Asnjë evidencë nuk është kërkuar nga audituesit në lidhje me këtë çështje. Për sa më sipër, lutemi rishikoni gjetjen dhe rekomandimin. Bashkëlidhur evidencat për ndjekjen e proceseve.

Qëndrimi i Grupit të auditimit:

Pretendimi qëndron. AAC ka vënë në dispozicion argument shtesë të pa vënë paraprakisht në dispozicion të grupit të auditimit në fazën e punës në AAC si dhe në observacionet për aktkonstatimet.

Prandaj ky koment do të merret në konsideratë dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.5. Auditim me zgjedhje sipas periudhave mbi rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve me arkë, bankë dhe blerjet me vlera të vogla (shpenzimet administrative, për automjetet, udhëtim e dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj).

Për rregullshmërinë e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe shpenzimeve administrative, u auditua dokumentacioni si më poshtë:

-Ditari i bankës.

-Dokumentacioni i veprimeve të kryera nga banka, për 6-mujori I i vitit 2021, 3-mujori I i vitit 2020, 3-mujori IV i vitit 2020 dhe 3-mujori IV i vitit 2019.

-Procedurat e kryera për blerjet me vlera të vogla dhe marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

-Dokumentacioni i mbajtur për harxhimin e karburantit.

-Dokumentacioni për veprimet e kryera nga banka për shpenzime dieta brenda dhe jashtë vendit, sponsorizime, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

-Auditimi i veprimeve nëpërmjet bankës.

AAC, kryen veprime kryesisht nëpërmjet bankës BK. dhe Cre.

Veprimet e kryera nëpërmjet bankës nga Sektori i Financës dhe Buxhetit, janë regjistruar në sistemin kompjuterik programi “Alfa”.

Për periudhën objekt auditimi u zgjodh për tu audituar dokumentacioni i veprimeve të kryera për 6-mujori I i vitit 2021, 3-mujori I dhe IV i vitit 2020 dhe 3-mujori IV i vitit 2019.

Nëpërmjet bankës, janë kryer veprimet e likuidimit të detyrimeve për shpenzime, si: paga, dieta, ujë, energji, telefoni celularë dhe fikse, shpenzime ndaj furnitorëve, shpenzime për pagesat e vendimeve gjyqësore, etj.

Veprimet janë regjistruar kronologjikisht sipas kohës së kryerjes së veprimit dhe dokumentet justifikues bashkëlidhur janë të plota, nënshkruar nga personat përgjegjës, duke zbatuar kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Udhëzimin e Ministrisë Financave nr.30, datë 27.12.2011“Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar.

Likuidimet e kryera nga banka janë shoqëruar në çdo rast me dokumentacionin justifikues dhe nënshkruar nga personat përgjegjës.

-Për periudhën 2019-2020, nga AAC janë kryer pagesa nëpërmjet bankës për 7 punonjës të larguar nga puna padrejtësisht (sipas vendimeve gjyqësore), në shumën 13,933,903 lekë. Kjo vlerë përfaqëson dëmshpërblimin e punonjësve në shumën 13,294,846 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 114,400 lekë dhe shpenzime përmbarimi në shumën 524,657 lekë.

Vlera prej **13,933,903 lekë, përbën efekt negativ financiar** për AAC dhe ngarkon me përgjegjësi z. K. K.

-Nëpërmjet bankës për vitin 2018, janë kryer pagesa për “sigurimin e jetës&shëndetit të punonjësve” në kompaninë e sigurimeve “SIC.” në shumën 2,078,750 lekë.

Për vitin 2019, janë kryer pagesa për “sigurimin e jetës&shëndetit të punonjësve” në kompaninë e sigurimeve “INS.” në shumën 3,500,800 lekë.

Për vitin 2020, janë kryer pagesa për “sigurimin e jetës&shëndetit të punonjësve” në kompaninë e sigurimeve “INS.” në shumën 3,391,400 lekë.

Pra, për 3 vjet prej fillimit të kryerjes së këtij shërbimi vlera prej **8,970,950 lekë**, është shpenzuar për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, vlerë e cila konsiderohet efekt ekonomik negativ pasi nuk ka argumentim ligjor për arsyet e kryerjes së këtij shërbimi ndaj punonjësve. Mungon analiza dhe hartimi i një programi mbi argumentimin e kryerjes së këtij shërbimi, nuk ka asnjë dokumentacion ku të arsyetohen kategoritë dhe vendet e punës që kanë më shumë risk, si është vlerësuar nga institucioni risku i punonjësve të administratës krahasuar me personelin teknik, etj, bazuar në detyrimet e punëmarrësit sipas Ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.

- Nëpërmjet bankës, janë kryer pagesat për **“pensionin vullnetar”** të punonjësve të AAC prej vitit 2014 e në vazhdim. Për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar nga AAC për këtë qëllim **58,918,231 lekë**. Nga grupi i auditimit në lidhje me bazën ligjore të dhënies së këtij financimi për punonjësit me fondet e institucionit u kërkua dokumentacion ligjor mbi argumentimin e financimit. Megjithë kërkesat e AAC për tu futur në skemën e sigurimit suplementar nga Ministria e Punës sot (MSHMS) është kthyer përgjigje nr.497/3, datë 23.02.2011, se ky institucion nuk mund të përfshihet në këtë skemë sepse në nenin 3 të ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” është përcaktuar se ky institucion është person juridik, jo buxhetor dhe nuk mund të përfshihet në skemën suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe punonjësve të shtetit”.

Nga AAC, nuk janë vazhduar procedurat për futjen e institucionit në skemën e pensionit suplementar, pasi sipas pikës 4, të VKM nr. 499, datë 21.09.2000 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 382, datë 20.05.1996, të KM “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, AAC duhej ti drejtohej sipas hierarkisë Këshillit të Ministrave pasi është ky organ që miraton ndryshimin ose jo të emërtesës dhe jo Ministria.

Për sa më lart, Administrata e AAC është administratë publike. Statusi i punonjësve të AAC është me statusin e Nëpunësit Civil dhe pagat janë paga të miratuara me VKM dhe paga të barazvlefshme me pagat e grupeve përfituese të përcaktuara në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” neni 1, pikat 5 dhe 9. Në këto pika përcaktohet se përfitojnë punonjësit e Administratës Publike si edhe personat e barazvlefshëm me pagë sipas grupeve përkatëse.

AAC referuar pikës 4, të VKM nr.499, datë 21.09.2000, duhej ti drejtohej Këshillit të Ministrave, pasi ky organ miraton ose jo ndryshimin e emërtesës dhe jo Ministria.

Ministria nëpërmjet ISSH, administron vetëm skemën, pra nuk e ka kompetencën e ndryshimit të listave të emërtesave të institucioneve në listat aktuale. Në ligjin nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” neni 3, citohet se: AAC është person juridik publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, po kështu referuar neni 16, struktura dhe pagat e AAC miratohen me VKM dhe punonjësit e AAC trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil. Pra, AAC futet në institucionet publike dhe si e tillë nuk mund të veprojë jashtë kuadrit ligjor të përdorimit të fondeve të institucionit, etj.

Nga AAC, është nënshkruar më 11.04.2014 kontrata me operatorin “S.” me objekt “Kontratë e punëdhënësit për anëtarësimin e punëmarrësve në fondin e pensioneve vullnetare Sig.”. Kjo kontratë është nënshkruar bazuar në nenin 53 të ligjit nr.10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e pensioneve vullnetare”. Fusha e veprimtimit të ligjit nr. 10197, datë 10.12.2009 “Për fondet e

pensioneve vullnetare” është e gjerë dhe përfshin edhe persona juridikë privat të cilët në funksionimin e aktivitetit të tyre mund të financojnë si punëdhënës, fond pensioni profesional referuar kërkesave dhe përcaktimeve në këtë ligj. Ky aktivitet mund të realizohet edhe nga AAC, por referuar kontratave të dakortësuara për financim nga vetë punonjësit e AAC.

-Gjithashtu, financimi i fondit të pensionit për punëmarrësin është në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr.10233, datë 11.02.2010, pika 4, ku citohet se: *Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, si edhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil”.*

Pagesat e kryera sa më sipër janë pagesa për financim të pensionit profesional dhe nuk hyjnë në pagesat e cilësura në ligjin për AAC.

-Me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016, të Këshillit Drejtues është miratuar një rregullore “Për pensionet vullnetare të punëdhënësit”, ku përcaktohet se AAC, merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute në favor të punëmarrësve.

-Rregullorja e miratuar nga Këshilli Drejtues nuk ka të përcaktuar legjislacionin mbi të cilin është bazuar që AAC merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute.

-Në këtë rregullore nuk janë përcaktuar kufijtë minimal dhe maksimal të % mbi pagë që do të llogaritet dhe përfitohet sipas grupeve të përcaktuara, por janë ndarë vetëm 3 grupe punonjësish sipas moshës dhe vjetërsisë në punë.

-Në pikën 2.4 të rregullores citohet se: *Kontributi për llogaritet si % e cila është variabël dhe përcaktohet çdo vit në bazë të mundësive financiare të institucionit nëpërmjet fondit të miratuar për pensionet vullnetare të parashikuar në programin ekonomiko-financiar të vitit dhe depozitohet në llogaritë individuale të punëmarrësit.*

Për periudhën objekt auditimi konstatohet se % e përfitur nga punonjësit për vitet 2019-2021 varijon nga 20-25%, megjithëse aktiviteti i AAC për vitin 2020, rezulton me humbje (në shumën 14,920,327 lekë), dhe në vështirësi financiare.

-Shpenzimet administrative për periudhën objekt auditimi paraqiten si më poshtë:

Nr.	Përshkrimi	Viti 2019	Viti 2020	3-mujori 2021
1	Dieta brenda vendit	69,720	24,560	5,320
2	Dieta jashtë vendit	30,723,184	2,803,315	238,344
3	Karburant	1,304,198	467,048	84,817
4	Shpenzime PTT	315,864	114,410	29,820
5	Shpenzime celular	3,863,496	1,629,155	86,685
6	Shpenzime mirëmbajtje automjete	566,640	119,340	-
7	Shpenzime gjyqësore	6,235,372	13,933,903	-
	Totali	43,078,474	19,091,731	444,986

Siç shihet edhe nga tabela ka një ulje të ndjeshme të shpenzimeve administrative në vitin 2020, pasojë e kushteve të krijuara nga pandemia Covid-19.

-Mbi shpenzimet udhëtime e dieta

Pagesat nga AAC, për përballimin e shpenzimeve për udhëtim e dieta të punonjësve që shkojnë me shërbim brenda dhe jashtë vendit, ka gjetur zbatim VKM nr.997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”, i ndryshuar dhe VKM nr. 870, datë 14.12.2011 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë vendit”, i ndryshuar. Shpenzimet e fjetjes, të transportit dhe dieta,

janë të dokumentuara me faturat përkatëse (fatura, bileta, etj), dhe pagesat janë kryer në përputhje legjislacionin.

-Auditimi i shpenzimeve të karburantit.

Mbi shpenzimet e karburantit dhe harxhimin sipas normativave të miratuara, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Fletë udhëtimet.

-Normat e konsumit të karburantit sipas automjeteve.

-Urdhra udhëtimi, autorizime.

-Dokumentacioni justifikues i lëvizjeve të kryera, etj.

AAC për karburant në vitin 2019, ka shpenzuar 1,304,198 lekë, për vitin 2020 - 467,048 lekë dhe për 3 mujorin I të vitit 2021 84,817 lekë. Nga 5 mjete në inventar për periudhën e auditimit kanë qenë në përdorim 4 prej tyre, të cilat janë furnizuar me karburant nëpërmjet sistemit kompjuterik me “chip elektronik”.

Nr.	Automjeti	Targa	Tetor - Dhjetor 2019	Janar - Dhjetor 2020	Janar-Prill 2021
1	Wolksv. Transporter	AA51..IZ (Naftë)	599	740	150
2	Fo. Mon. Hybrid	AA37.YS (Benzinë)	60	750	200
3	Fo. Mon. Hybrid	AA53.YR (Benzinë)	500	900	530
4	Au. Q5	AA46.SU (Benzinë)	300	650	-
5	Sk. Superb	AA40.DV (Benzinë)	-	-	-
	Shuma		1,459	3,040	880

Për menaxhimin e shpenzimeve të karburantit nga AAC janë nxjerrë urdhrat e titullarit nr. 380/7, datë 26.10.2020 “Për vlerësimin e mjeteve motorike në administrim të AAC dhe përcaktimin e normativave të harxhimit të karburantit nga automjetet” dhe nr.71, datë 26.02.2021 “Për përdorimin, administrimin dhe furnizimin me karburant të automjeteve”.

Referuar urdhrave të mësipërm, është hartuar edhe formati i dokumenteve të cilat duhet të plotësojnë punonjësit udhëtues, sektori i shërbimeve dhe drejtuesit e mjeteve.

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për harxhimin e karburantit konstatohet se dokumentacioni i lëvizjeve është plotësuar referuar kërkesës nga drejtoria përkatëse, autorizimit për lëvizje duke përcaktuar në çdo rast destinacionin dhe qëllimin e shërbimit. Nga drejtoria e shërbimeve janë ndjekur normativat e konsumit të çdo mjeti sipas km të përshkuar dhe janë plotësuar evidencat mujore të konsumit/mjet. Plotësimi dhe nënshkrimi i dokumentacionit justifikues, si urdhër shërbime, fletë udhëtimi, përmbledhëse e harxhimit të karburantit, etj, janë plotësuar referuar legjislacionit në fuqi. Lëvizjet e automjeteve janë kryesisht në destinacionet brenda Tiranës, Tiranë-Rinas dhe disa raste Tiranë-Kukës. Nga auditimi i harxhimit të karburantit nuk u konstatuan diferenca ose moszbatim i legjislacionit si për plotësim në dokumentacion, ashtu edhe sa i takon distancave të përcaktuara me Urdhrin e Ministrit të PPT nr.125, datë 26.12.2011 “Për miratimin e hartave të azhurnuara të Rrjetit Rrugor Kombëtar dhe distancave kilometrike ndërmjet qyteteve në RSH”.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Dokumentimi dhe shpenzimet e kryera për shpenzimet administrative, udhëtime dieta, karburant, etj, janë kryer në përputhje me legjislacionin.

-Mungon argumentimi i shpenzimeve të kryera për “sigurim jete& shëndeti të punonjësve” dhe “Pension vullnetar”.

-Është shkaktuar efekt negativ financiar për AAC, si pasojë e largimeve të punonjëse padrejtësisht nga puna.

-Mbi rregullshmërinë e kryerjes së blerjeve me vlera të vogla

Autoriteti i Aviacionit Civil për periudhën objekt auditimi (01.10.2019 - 30.06.2021), ka realizuar prokurimet me vlera të vogla, si më poshtë:

Nr	Objekti	Viti	NR prokurimeve	Fondi Limit	Vlera e kontratës
1	Prokurimet me vlerë të vogël	2019	25	7,188,296	4,865,967
2	Prokurimet me vlerë të vogël	2020	23	8,052,065	4,552,927
3	Prokurimet me vlerë të vogël	2021	12	4,904,254	2,850,142

Për këtë qëllim, janë ngritur komisionet përkatëse (sipas urdhrave/vit të titullarit të institucionit). Me urdhrin Nr.2, datë 03.01.2019, të Drejtorit të AAC, z.K. K., është ngritur Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i cili përbëhet nga:

-A. P. , në cilësinë e kryetarit të komisionit.

-O. A. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

-A. N. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

Me urdhrin Nr.2, datë 06.01.2020, të Drejtorit të AAC, z. K. K., është ngritur Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i cili përbëhet nga:

-A. N. , në cilësinë e kryetarit të komisionit.

-O. A. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

-E. A. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

Me urdhrin Nr.383, datë 27.10.2020, të Drejtorit të AAC, zj. E. K., është zëvendësuar anëtarja e kvo zj. E. A. me zj. E. M., e cila caktohet kryetare komisioni.

Me urdhrin Nr.3, datë 05.01.2021, të Drejtorit të AAC, zj. E. K., është ngritur Komisioni i blerjeve me vlera të vogla, i cili përbëhet nga:

-E. M. , në cilësinë e kryetarit të komisionit.

-O. A. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

-A. N. , në cilësinë e anëtarit të komisionit.

Me urdhrin nr.255, datë 22.06.2021, të drejtorit të AAC, zj. E. K., është zëvendësuar kryetari i kvo zj. E. M. me z. A. N., i cili caktohet kryetar komisioni dhe është shtuar zj. E. A.

Për vitin 2019, janë kryer 25 procedura për “blerje me vlera të vogla” me fond limit 7,188,296 lekë dhe vlerë kontrate 4,865,967 lekë.

Për vitin 2020, janë kryer 23 procedura për “blerje me vlera të vogla” me fond limit 8,052,065 lekë dhe vlerë kontrate 4,552,927 lekë.

Për 6-mujorin e I të vitit 2021, janë kryer 12 procedura për “blerje me vlera të vogla” me fond limit 4,904,254 lekë, dhe vlerë kontrate 2,850,142 lekë.

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar rregullat e përcaktuara në VKM nr.914, datë 29.12.2014 dhe Udhëzimet përkatës. Çdo fillim viti është ngritur komisioni për blerjet e vogla me urdhër të titullarit, i cili ka funksionuar për gjithë vitin. Procedurat e prokuruarra, janë parashikuar në regjistrin e parashikimeve të dorëzuar në APP. Në të gjitha rastet është nxjerrë urdhri i prokurimit, i cili mban firmën e titullarit, si dhe është shoqëruar me ftesën për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë, duke plotësuar dokumentacionin referuar legjislacionit në fuqi që nga llogaritja e fondit e deri në finalizimin e prokurimit.

Nga auditimi i procedurave të blerjeve me vlera të vogla për 6-mujorin e I të vitit 2021, u konstatua se është kryer procedura me objekt ***“Asistencë për negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”***.

Me shkresën nr.2457/4, datë 19.03.2021, të Sekretares së Përgjithshme zj. V. H., kërkohet asistencë e nevojshme nga AAC, për komisionin e dhënies me koncesion pranë MIE, mbështetje me shërbim profesional të kualifikuar për të mundësuar kontraktimin e një ekspertize profesionale të kualifikuar e cila do të asistojë grupin negociator të MIE për një afat 30 ditor.

Me urdhrin nr.152, datë 24.03.2021, është ngritur nga titullari AAC komisioni për hartimin e termave të referencës dhe përlogaritjes së fondit limit për procedurën “Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”.

Procedura për fillimin e procedurës nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kritereve, hartimi i termave të referencës, datojnë më 24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit nga Titullari.

Urdhër prokurimi nr.13, datë 24.03.2021.

Në datën 25.03.2021 është paraqitur në SPE, ofertuesi T. P. me vlerë 789,000 lekë.

dhe është nënshkruar kontrata më 30.03.2021

Kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, *pasi nuk mund të kryhej nga AAC, por nga vetë Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.*

Ministria duhet të zhvillonte procedurën dhe të mbulonte koston e procedurës së shërbimit “Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”. Mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre e kthen AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve, për më tepër në vitin ku AAC ka rezultuar me humbje.

-Procedura e prokurimit “Blerje 4 kompjutera dhe 4 lap top”

Me Urdhër prokurimi nr.33, datë 28.12.2020, është iniciuar blerja e 4 kompjutera dhe 4 laptop, për nevoja të punonjësve.

Sipas procesverbalit të marrjes në dorëzim të aktivitetit të furnizuar më datë 31.12.2020, mbajtur nga komisioni i përbërë nga K. G. , O. A. dhe A. D. (nëpunës me përgjegjësi material) konfirmohet se mallrat janë furnizuar sipas specifikimeve të kërkuara.

-Referuar specifikimeve teknike, nga verifikimi në vend konstatohet se mungon specifikimi në karakteristikat e “lap top” zëri “Media device” DVD+/-Rw with DL Internal ose external; Memory card reader.

-Për zërin “Kompjuter”, u konstatua se nuk është plotësuar specifikimi “Ports” ku kërkohen “portat e komunikimit me 8 dalje” dhe 1 shpejtësie, nga verifikimi u konstatua se janë me 8 porta, por 1 nga portat në pjesën e mbrapme nuk është portë shpejtësie.

Sa më sipër arrihet në konkluzionin që:

-Nga auditimi i procedurave të ndjekura nga komisioni i blerjeve me vlera të vogla, rezultoi se në përgjithësi janë zbatuar rregullat e përcaktuara në Udhëzimet përkatës, por u konstatua se 1 procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr.9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në:

-Ligjin nr.9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

-VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: zj. E. K. , me detyrë Drejtor Ekzekutiv, zj. K. G. , me detyrë inspektore në sektorin e licencimit dhe z. O. A. , me detyrë specialist në sektorin e prokurimeve.

Për sa më lart është mbajtur Aktkonstatimi nr.6, datë 30.07.2021.

Procedura e prokurimit “Marrje në përdorim të pajisjeve për printim” viti 2020.

Me Urdhër nr.49, datë 29.01.2020, është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën blerje me vlerë të vogël “Marrje në përdorim tujeve për printim” me komision E. Gj. , J. D. dhe K. K.

-Urdhri është nxjerr pa patur ndonjë kërkesë për këtë procedurë , veprime në kundërshtim me Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërm; a) një përshtkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Me shkresën nr. 270 datë 03.02.2020 titullari i AK ka nxjerr urdhrin e prokurimit nr. 5 datë 03.02.2020 për “Marrje në përdorim të pajisjeve për printim” për sigurimin e printimit të 394,404 faqe A4 dhe 500 faqe A3 në vit.

Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël i krijuar me datë 03.02.2020 i përberë nga A. N. kryetar, E. A. dhe O. A. antarë kanë hartuar Ftesën për ofert me datë 03.02.2020.

Janë ftuar në seksion përkatës të SPE 5 operator ekonomik të fushës

F.

S. C.

B. E.

A.

I. O.

Pas vlerësimit në sistem datë 02.04.2020 është bërë dhe Klasifikimi përfundimtarë i OE pjesëmarrës.

B. T. 400,000

J. G. 700,000

A. 748,900

O. T. 750,000

F. 753,000

R. -A 785,000

Operator ekonomik i s kualifikuar B. E.

Pas klasifikimit përfundimtar është bërë njoftimi i fituesit në sistem.

Po më 02.04.2020 pas marrjes së njoftimit të fituesit OE B. T. ka paraqitur njoftim tërheqje ora 16:43.

Më 05.02.2020 komisioni harton procesverbalin e vlerësimit dhe njofton Operatorin e renditur të dytin në rruhdhë J. G.

Më 05.02.2020 J. G. paraqitet në institucion dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Po në këtë datë pas verifikimit të dokumentacionit Komisioni e njofton në sistem OE J. G. për paraqitjen brenda 5 ditëve sipas ftesës për ofertë me produktin.

Më 10.02.2020 Komisioni hartoi procesverbalin e mosparaqitjes së operatorit të dytë pjesëmarrës për furnizimin e pajisjeve sipas ftesës për ofertë, si dhe njoftoi OE e tretë ofertues A.

Më 11.02.2020 J. G. paraqitet në institucion dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Më 12.02.2020 është bërë vlerësimi dhe është njoftuar për furnizimin me pajisjet e kërkuara në ftesën për ofertë.

Më 12.02.2020 Titullari AK lidh kontratën nr. 339/2 datë 12.02.2020 me OE pjesëmarrës A., pa patur asnjë gjurmë të verifikimit të pajisjeve të furnizuara sipas kushteve të ftesës për ofertë, nuk ka asnjë të dhënë për pajisjet e furnizuara janë apo jo në përputhje me specifikimet teknike. Ska asnjë të dhënë procesverbal kur u morën në dorëzim, kush i mori, kur u furnizuan etj.

Sa më sipër mban përgjegjësi ish titullari i AK z. K. K. .

Me shkresën nr. 339/3 datë 12.02.2020 Titullari i AK ka nxjerr urdhrin për mbikëqyrjen e kontratës nga I. P. , A. D. dhe O. A.

Procedura e prokurimit “Marrje në përdorim të pajisjeve për printim” viti 2021

Pas marrjes së kërkesës nr. 37 prot., datë 08.01.2021 për nevojën e kryerjes së procedurës Sigurimi i pajisjeve të printimit titullari i AK ka nxjerr urdhrin e prokurimit nr. 1 datë 11.01.2021 për “Marrje në përdorim të pajisjeve për printim” për sigurimin e printimit të 394,404 faqe A4 dhe 500 faqe A3 në vit.

Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël i krijuar me datë 11.01.2021 i përberë nga A.N. kryetar, E. M. dhe O. A. antarë kanë hartuar Ftesën për ofertë me datë 11.01.2021.

Janë ftuar në seksion përkatës të SPE 5 operator ekonomik të fushës

F.

A.

B.E.

A.

I. O.

Pas vlerësimit në sistem datë 12.01.2021 është bërë dhe klasifikimi përfundimtar i OE pjesëmarrës.

I. DR	248,200
E. L.	544,800
A. K.	644,800
R.-A	650,000
F.	650,000
T. E.	672,200
P.ST.	699,600
A. D.	700,000
AD.	715,000
A.	744,980
O. T	733,333

Operator ekonomik i skualifikuar; RE., O. H., B. E. , J. G. dhe S. R.

Pas klasifikimit përfundimtar është bërë njoftimi i fituesit në sistem.

Më 13.01.2021 pas marrjes së njoftimit të fituesit O. I. DR ka paraqitur njoftim tërheqje për arsye të llogaritjes gabim të ofertës.

Më 14.01.2021 komisioni harton procesverbalin e vlerësimit dhe njofton Operatorin e renditur të dytin në radhë E.L., edhe ky paraqet terkes për tërheqje për arsye kohe. Komisioni bëri njoftimin e fituesit për OE renditur i Treti A. K.

Më 14.01.2021 A. K. paraqitet në institucion dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Pas vlerësimit të dokumentacionit teknik u konstatuan mangësi në lis pagesat e kërkuara. Dhe është njoftuar OE i katërt RI.-AL pas hedhjes së shortit në sistem elektronik ku i katërti renditet RI.-AL dhe i pesti F.

Më 20.01.2021 Komisioni i blerjeve me vlerë të vogël harton procesverbalin e mos paraqitjes në kohë të OE të shpallur fitues RI. -Al dhe njoftohet OE i renditur i pesti F.

Më 21.01.2021 F. paraqitet në institucion dhe dorëzon dokumentacionin e kërkuar në ftesën për ofertë.

Më 22.01.2021 komisioni ka bërë njoftimin në sistem të O. F. për paraqitjen në institucion së bashku me pajisjet për verifikimi brenda afati kohorë të parashikuar në ftesën për ofertë 5 ditë.

Me shkresën nr. 134 prot., datë 25.01.2021 titullari i AK nxjerr urdhrin nr. 20 datë 25.01.2021 për ngritjen e komisionit për verifikimin e parametrave të pajisjes së ofruar.

Komisioni i ngritur hartoi memon nr. 134/1 prot., datë 27.01.2021 ku informon titullarin e AK për plotësimin e kushteve të kërkuara nga pajisjet e ofruara.

Më 29.01.2021 Titullari AK lidh kontratën nr. 134/2 datë 29.01.2021 me OE pjesëmarrës F.

Me shkresën nr. 134/3 datë 01.02.2021 Titullari i AK ka nxjerr urdhrin për mbikëqyrjen e kontratës nga K. G. , A. D. dhe O.A.

Pajisjet janë sipas specifikimeve të kërkuara.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 1678/1 prot. datë 14.10.2021 “Mbi Projektraportin e Auditimit”, nga zj. E. K. , ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendimi i subjektit: *Audituesi konstaton se nuk është ndjekur procedurë konkurrimi për përzgjedhjen e shoqërisë administruese të fondit duke moszbatuar përcaktimet e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar si dhe Ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për prokurimin Publik”, i ndryshuar. Në lidhje me këtë konstatim, sqarohet si më poshtë:*

*Ligji “Për prokurimin publik” përcakton rregullat që zbatohen për procedurat e prokurimeve, fushën e zbatimit si dhe specifikisht përjashtimet e veçanta. Referuar nenit 7, pika “ç”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar (Ligji në fuqi në 2018), përjashtohen shprehimisht nga fusha e zbatimit të këtij ligji “**shërbimet financiare për shitjen, blerjen apo transferimin e titujve ose instrumentëve të tjera financiare, veçanërisht veprimet e autoritetit kontraktor për akumulimin e vlerave monetare apo të kapitalit, si dhe shërbimet e bankës qendrore.**”*

Fondet e Pensioneve, për nga forma dhe marrëdhënia juridike janë tituj/instrumenta financiar të emetuara nga Banka e Shqipërisë, të miratuar nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (Neni 3 dhe 4, Ligjit Nr. 9879, datë 21.02.2008 “Për titujt”)

Asetet e Fondit Investohen në tituj të emetuar ose garatuar nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, në Bono Thesari dhe kryesisht në Obligacione afatgjata duke qënë se është një investim afatgjatë.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Në lidhje me pretendimin tuaj sqarojmë se meqenëse ky fond konsiderohet nga AAC akumulim i vlerave monetare, merret në konsideratë observacioni dhe nuk do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendimi i subjektit: Për sa konstatoni në procedurën me objekt “Asistencë për negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”, sqaroj se referuar ligjit 96/2020 “Kodi Ajror i RSH” neni 7, Ministri është autoriteti më i lartë në fushën e aviacionit civil dhe përgjegjës për a) hartimin e politikave të aviacionit civil në RSH, b) negocimin dhe nënshkrimin e marrëveshjeve dypalëshe për transportin ajror dhe neni 8, AAC është ent publik me vetëfinansim në varësi të Ministrit. Me shkresën nr.2457/4, datë 19.03.2021, MIE kërkon asistencë e nevojshme nga AAC, për komisionin e dhënies me koncesion pranë MIE, mbështetje me shërbim profesional të kualifikuar për të mundësuar kontraktimin e një ekspertize profesionale të kualifikuar e cila do të asistojë grupin negociator të MIE për një afat 30 ditor.

Është detyrë direkte e AAC, ndjekja dhe zbatimi i udhëzimeve dhe kërkesave që burojnë nga Qeveria Shqiptare në dobi të mirë rregullimit dhe mbarëvajtjes së fushës së aviacionit civil. Me vendimin nr.2, datë 23.03.2021 Këshilli Drejtues miraton përfshirjen e kësaj asistence në Programin ekonomik. Audituesja konstaton se kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40 (referuar nenit për blerjet me vlera të vogla) ku vihet re se konstatimi është i përgjithshëm pa specifikuar konkretisht çfarë pike nuk është zbatuar dhe sqaroj se procedura është finalizuar me sukses.

Qëndrimi i grupit të auditimit: Grupi i auditimit e ka të qartë rolin dhe detyrat e Ministrit të linjës. Pretendimi se audituesja nuk ka specifikuar çfarë pike nuk është zbatuar, nuk qëndron sepse në aktkonstatim dhe Projektraport audituesja ka përcaktuar saktë legjislacionin mbi të cilin kryen procedurat e prokurimit. **Neni 40**, përcakton se: 1. Autoriteti kontraktor përdor procedurën e prokurimit me vlerë të vogël për punë/mallra/shërbim, kur vlera e përllogaritur është më e ulët se 800.000 (tetëqind mijë) lekë në vit. Autoriteti kontraktor planifikon në fillim të vitit natyrën, sasisht dhe llojet e kontratave, që do të prokurohen me këtë procedurë prokurimi.

Ju kujtojmë se AAC është Autoritet Kontraktor i cili duhet të kryej procedurat e prokurimit me fondet e veta për institucionin dhe në asnjë nen të ligjit apo VKM “Mbi prokurimin publik”, nuk gjen vend kryerja e një procedure prokurimi për llogari të një Autoriteti tjetër kontraktor.

Në legjislacionin mbi prokurimin publik, janë të përcaktuara qartësisht termat që përdoren dhe jepet saktë kuptimi i tyre si: “Autoritet kontraktor”, “Fonde publike”, etj.

Në pretendimet e paraqitura citoni se: “është detyrë direkte e AAC ndjekja dhe zbatimi i udhëzimeve dhe kërkesave që burojnë nga Qeveria Shqiptare në dobi të mirë rregullimit dhe mbarëvajtjes së fushës së aviacionit civil”, kjo nuk nënkupton moszbatim të legjislacionit sipas nenit dhe pikës, por moskundërshtim i urdhrin të MIE.

Pretendimi se procedura është finalizuar me sukses, qëndron sa i takon hapave të ndjekur nga kvo, ndërsa procedura nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kriterëve, hartimi i termave të referencës, datojnë më 24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit hartimin e termave të referencës!!

Pretendimi i subjektit: -Shpenzimi i kryer për “sigurim jete dhe shëndeti për punonjësit e AAC” për vitin 2020, është bazuar në programin ekonomik për vitin 2020, miratuar me vendimin e Këshillit Drejtues nr.15, datë 28.12.2019 si edhe në procedurën e prokurimit nr.29, datë 18.11.2020. Ky shpenzim është mbështetur në pikën 4 të nenit 17 të ligjit 10233, datë 11.02.2010

“Për Autoritetin e Aviacionit Civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale të nevojshme për funksionimin normal të AAC, si edhe pagesat që rrjedhin nga anëtarësimi i RSH në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil.

-Për punonjësit sigurohet një shërbim mjekësor shumë i shpejtë në spitalet private dhe punonjësit motivohen në punë duke u ndjerë të barabartë me trajtimin që iu bëhet punonjësve në industrinë e aviacionit dhe organizatave ndërkombëtare ku AAC aderon, nuk ka vonesa dhe radhë në kryerjen e shërbimit, etj....

-AAC, në kuptim të Ligjit nr.10197 “Për fondet e pensionit vullnetar”, i ndryshuar, ku parashikohet se institucioni mund të krijojë një plan pensioni profesional për punë marrësit e tij, ka lidhur kontratë me shoqërinë “Si.”. Cdo vit AAC ka planifikuar në programin ekonomik dhe miratuar me vendim të këshillit drejtues fondin e pensionit profesional dhe është njoftuar edhe Ministri bazuar në pikën “d” të ligjit të AAC. Nëse nuk do të ekzistonte fondi i pensionit do të përbënte risk për rritjen e pakënaqësisë së punonjësve e cila do të sillte deri në largimin e stafit Teknik.

AAC çdo vit, në programin ekonomik ka planifikuar dhe miratuar me vendim të Këshillit Drejtues fondin e pensionit vullnetar/profesional, sipas mundësive financiare të periudhës përkatëse. Për vendimmarrjet e Këshillit Drejtues të lidhura me programin ekonomik është njoftuar Ministri në zbatim të pikës “d” të nenit 6 të Ligjit të AAC.

Gjithashtu, pensioni vullnetar është përfshirë në llogaritjen e kostos të tarifës en-route, në përputhje të plotë me udhëzimet e aplikimit të parimeve të kostos bazë të publikuara nga Euro. , në të cilat përcaktohet se kosto e stafit përbëhet nga:

paga bruto;sigurimet shoqërore dhe shëndetësore sipas skemës së kontributit shtetëror;
pagesa e kontributit të pensioneve shtesë;

Kosto të tjera si trajnime, misione, punonjës të përkohshëm apo konsulentë.

Pra, fondi i pensionit vullnetar është pjesë e përlllogaritjes të kostos për tarifën en -route që do të thotë se kjo tarifë përbën dhe burimin e të ardhurave për këtë fond.

AAC është institucion unik dhe i një natyre të veçantë dhe ka marrëdhëniet me buxhetin e shtetit thuajse 0.

Referuar pretendimit se nga KLSH, janë vërtetuar dhe lënë rekomandim për përfshirjen në pagesat e pensionit vullnetar të punonjësve të Aeroportit të Kukës, vihet re cënimi i parimit të sigurisë juridike dhe gjykim ndryshe i të njëjtës çështje nga i njëjti institucion, ndërkohë që asgjë nuk ka ndryshuar në këto 5 vite.

-Ligji për pensionet vullnetare parashikon edhe institucione të financuara nga buxheti i shtetit dhe jo vetëm persona juridikë privat, siç konstaton audituesi. Pensioni profesional aplikohet nga disa institucione buxhetore dhe jo buxhetore si: ISSH, OST, DPSHTRR, AMF, ALCONTROL, etj.

Qëndrimi i grupit të auditimit: -Në lidhje me pretendimin tuaj sqarojmë se në këtë ligj janë të mirë përcaktuara shpenzimet që duhen kryer. Në zërin shpenzime paga, sigurime...përfshihen kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore të detyrueshme nga institucioni sipas legjislacionit në fuqi. Grupi i auditimit nuk shprehet se këto shpenzime nuk janë miratuar në programin ekonomik/këshilli drejtues, programi ekonomik hartohet dërgohet për miratim nga AAC. Sa i takon pretendimit se punonjësit ndjehen të motivuar dhe kryejnë më shpejt trajtimet në spitalet private sqarojmë se punonjësit e AAC janë pjesë e administratës shtetërore dhe trajtohen me statusin e nëpunësit civil dhe për rrjedhojë i nënshtrohen zbatimit të legjislacionit në fuqi.

-Sa i takon pretendimit se ky fond është miratuar në programin ekonomik, sqarojmë se grupi i auditimit nuk është shprehur se ky fond nuk është përfshirë në program ekonomik. Pretendimi se stafi Teknik mund të largohet nga puna nëse nuk do të ishte fondi i pensionit vullnetar, nuk justifikohet pasi në AAC këtë pension nuk e përfiton vetëm stafi Teknik, por të gjithë punonjësit.

-Sa i takon pretendimit se AAC është institucion unik dhe i një natyre të veçantë dhe ka marrëdhëniet me buxhetin e shtetit thuhet 0, sqarojmë se për këtë qëllim duhet të përcaktohen në ligjin e AAC të gjitha shpenzimet që do të kryen për punonjësit, për të respektuar angazhimet shtetërore që burojnë nga anëtarësimet e Shqipërisë në organizatat ndërkombëtare të aviacionit civil.

-Referuar pretendimit se nga KLSH, janë vërtetuar dhe lënë rekomandim për përfshirjen në pagesat e pensionit vullnetar të punonjësve të Aeroportit të Kukës, sqarojmë se është konstatuar qëndrim subjektiv dhe i njëanshëm referuar listë pagesave të hartuara ku është përjashtuar vetëm ajo kategori punonjësish dhe nuk ka asnjë cënim të parimit të sigurisë juridike dhe gjykim ndryshe i të njëjtës çështje nga i njëjti institucion.

-Sqarojmë se paralelizmi që bëni me përfitimin e këtij pensioni nga disa institucione të tjera, ju kujtojmë se këto institucione nuk funksionojnë me ligjin për Statusin e Nëpunësit Civil si AAC dhe sa për informacion ky kontribut për punonjësit e ISSH, nuk tejkalon masën 2%, krahasuar me 25% që aplikon AAC. Çdo institucion përcakton dhe argumenton ligjërisht për vendimmarrjet e tij.

-Pretendimi se AAC nuk ka qenë në vështirësi financiare nuk qëndron pasi për vitin 2020 rezulton me humbje, duke mos zbatuar as pikën 2.4 të rregullores ku citohet se: **Kontributi përlllogaritet si % e cila është variabël dhe përcaktohet çdo vit në bazë të mundësive financiare të institucionit** nëpërmjet fondit të miratuar për pensionet vullnetare të parashikuar në programin ekonomik-financiar të vitit dhe depozitohet në llogaritë individuale të punëmarrësit. Pretendimi nuk merret në konsideratë.

1. Titulli i gjetjes:	Largime të padrejta nga puna.
Situata:	Për periudhën 2019-2020, nga AAC janë kryer pagesa nëpërmjet bankës për 7 punonjës të larguar nga puna padrejtësisht (sipas vendimeve gjyqësore), në shumën 13,933,903 lekë. Kjo vlerë përfaqëson dëmshpërblimin e punonjësve në shumën 13,294,846 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 114,400 lekë dhe shpenzime përmbarimi në shumën 524,657 lekë.
Kriteri:	Vendimet gjyqësore.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në të ardhurat e AAC në shumën 13,933,903 lekë.
Shkaku:	Mos argumentim i largimeve.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 1.1:	Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, në të ardhmen të marrin masa për eliminimin e procedurave të largimeve nga puna të punonjësve të paargumentuara ligjërisht, me qëllim minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare dhe venë në vështirësi institucionin.

2. Titulli i gjetjes:	Shpenzime të paargumentuara.
------------------------------	------------------------------

Situata:	Nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për “sigurimin e jetës & shëndetit të punonjësve” në kompanitë e sigurimeve “S.” dhe “I.” për 3 vjet prej fillimit të kryerjes së këtij shërbimi vlera prej 8,970,950 lekë , është shpenzuar për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, vlerë e cila konsiderohet efekt ekonomik negativ pasi nuk ka asnjë argumentim ligjor për arsyet e kryerjes së këtij shërbimi. Mungon analiza dhe hartimi i një programi mbi argumentimin e kryerjes së këtij shërbimi, nuk ka asnjë dokumentacion ku të arsyetohen kategoritë dhe vendet e punës që kanë më shumë risk, si është vlerësuar nga institucioni risku i punonjësve të administratës krahasuar me personelin teknik, etj, bazuar në detyrimet e punëmarrësit sipas Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.
Kriteri:	Ligji nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”.
Ndikimi/Efekti:	Efekt negativ financiar në të ardhurat e AAC.
Shkaku:	Mos zbatim i legjislacionit.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 2.1:	Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të analizojnë dhe përcaktojnë kategoritë përfituese të punonjësve për sigurim jete dhe shëndeti, referuar vështirësisë së vendit të punës dhe nivelit të riskut për çdo pozicion pune, referuar legjislacionit në fuqi dhe me miratim nga Ministria e linjës, me qëllim përfitimin e shërbimit nga punonjësit dhe minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare.

3 Titulli i gjetjes:	Pagesa jo ligjore për pension vullnetar.
Situata:	- Nëpërmjet bankës, janë kryer pagesat për “pensionin vullnetar” të punonjësve të AAC prej vitit 2014 e në vazhdim. Për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar nga AAC për këtë qëllim 58,918,231 lekë . Nga grupi i auditimit në lidhje me bazën ligjore të dhënies së këtij financimi për punonjësit me fondet e institucionit u kërkua dokumentacion ligjor mbi argumentimin e financimit. Nga AAC, nuk janë vazhduar procedurat për futjen e institucionit në skemën e pensionit suplementar, pasi sipas pikës 4, të VKM nr. 499, datë 21.09.2000 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 382, datë 20.05.1996, të KM “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, AAC duhej ti drejtohej sipas hierarkisë Këshillit të Ministrave pasi është ky organ që miraton ndryshimin ose jo të emërtesës dhe jo Ministria. Gjithashtu, financimi i fondit të pensionit për punëmarrësin është në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr.10233, datë 11.02.2010, pika 4, ku citohet se: <i>Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, si edhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës</i>

	<p><i>Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil</i>". Pagesat e kryera sa më sipër janë pagesa për financim të pensionit profesional dhe nuk hyjnë në pagesat e cilësuar në ligjin për AAC. Me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016, të Këshillit Drejtues është miratuar një rregullore "Për pensionet vullnetare të punëdhënësit", ku përcaktohet se AAC, merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute në favor të punëmarrësve. Në këtë rregullore nuk janë përcaktuar kufijtë minimal dhe maksimal të % mbi pagë që do të llogaritet dhe përfitohet sipas grupeve të përcaktuara, por janë ndarë vetëm 3 grupe punonjësish sipas moshës dhe vjetërsisë në punë. Në pikën 2.4 të rregullores citohet se: <i>Kontributi për llogaritet si % e cila është variabël dhe përcaktohet çdo vit në bazë të mundësive financiare të institucionit nëpërmjet fondit të miratuar për pensionet vullnetare të parashikuar në programin ekonomik-financiar të vitit dhe depozitohet në llogaritë individuale të punëmarrësit.</i> Për periudhën objekt auditimi konstatohet se % e përfituar nga punonjësit për vitet 2019-2021 varjon nga 20-25%, megjithëse aktiviteti i AAC për vitin 2020, rezulton me humbje (në shumën 14,920,327 lekë), dhe në vështirësi financiare.</p>
Kriteri:	Ligji nr.10233, datë 11.02.2010, "Për Autoritetin e Aviacionit Civil", pika 4. Rregullore për pensionet, pika 2.4, miratuar me vendim nr.57, datë 03.08.2016.
Ndikimi/Efekti:	Rritje e shpenzimeve, thellim i rezultatit ekonomik negativ (humbje).
Shkaku:	Moszbatim legjislativ.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 3.1:	<p>Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të AAC, brenda mundësive të financimit dhe referuar kompetencave ligjore për miratim, parashikuar në legjislativ në fuqi të krijojnë fondin për financimin e pensionit vullnetar dhe % e pjesëmarrjes, vetëm duke marrë miratimet përkatëse si edhe përcaktimin e këtij financimi në ligjin "Për AAC".</p> <p>Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të AAC, të analizojnë ligjshmërinë e përfitimit të "Pensionit vullnetar" nga punonjësit duke pasqyruar ndryshimet në rregulloren e miratuar me vendim të këshillit drejtues nr.57, datë 03.08.2016, me qëllim përmirësimin e saj dhe rishikimin e % së financimit.</p>

4. Titulli i gjetjes:	Procedurë prokurimi jo ligjore.
Situata:	Me urdhrin nr.152, datë 24.03.2021, është ngritur nga titullari AAC komisioni për hartimin e termave të referencës dhe për llogaritjen së fondit limit për procedurën "Asistencë për hartimin dhe negociimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës". Procedura për fillimin e procedurës nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kriterëve, hartimi i termave të referencës, datojnë më

	24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit nga Titullari. Kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin, pasi nuk mund të kryhej nga AAC, por nga vetë Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Ministria duhet të zhvillonte procedurën dhe të mbulonte koston e procedurës së shërbimit “Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”. Mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre e kthen AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve, për më tepër në vitin ku AAC ka rezultuar me humbje.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40.
Ndikimi/Efekti:	Rritje e shpenzimeve që nuk i shërbejnë AK.
Shkaku:	Moszbatim legjislacioni.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 4.1:	Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtorja e Shërbimeve Përgjithshme të marrë masa që në të ardhmen të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE (për prokurime) dhe në çdo rast të përmbushen vetëm nëse ato janë në interes të AAC, si edhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi të përcaktuara për çdo Autoritet Kontraktor, me qëllim që mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre të mos kthejë AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve.

2.6. Mbi mbajtjen e evidencës kontabile, hartimin dhe miratimin e pasqyrave financiare, evidentimin, ndjekjen dhe pasqyrimin e debitorëve dhe kreditorëve, si dhe përlllogaritjen, njohjen, regjistrimin dhe pagesën e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore.

Autoriteti Aviacionit Civil, është një institucion publik me status juridik, jobuxhetor, i krijuar me Ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010, i ndryshuar, me vetë financim. Organet drejtuese të AAC janë Këshilli Drejtues (këtu e në vijim KD) dhe Drejtori Ekzekutiv. Struktura e AAC miratohet nga Ministri së bashku me nivelin e pagave pas miratimit nga KD brenda kufijve të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave.

Fusha e veprimtarisë së Autoritetit është rregullimi dhe mbikëqyrja e të gjitha veprimtarive në fushën e transportit ajror civil në Republikën e Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr.10040, datë 22.12.2008 "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë". AAC ka organizuar mbajtjen e kontabilitetit dhe përgatitjen e pasqyrave financiare në zbatim të kuadrit ligjor dhe në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK) të përmirësuara dhe zbatimin e detyrueshëm të tyre, të miratuara nga Ministria e Financave me Urdhrin nr. 64, datë 22.07.2014, hyrë në fuqi me datën 1 janar 2015.

Kontabiliteti mbahet në mënyrë elektronike me programin Alfa , dhe janë bërë regjistrimet për vitet ushtrimore 2019,2020. Nga grupi i auditimit është konstatuar se pasqyrat financiare në fund të vitit përputhen me të dhënat e kontabilitetit duke pasqyruar drejtë gjendjen e llogarive të institucionit.

Nga auditimi i listë pagesave për vitet 2019- 2020 dhe 4 mujorin e parë të vitit 2021, rezulton se listë pagesat janë mbajtur të rregullta, të shoqëruara me listë prezencat e drejtorive përkatëse, si dhe llogaritjet e detyrimeve fiskale dhe sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë mbajtur në zbatim të legjislacionit në fuqi.

Me shkresën nr.10815prot, datë 24.12.2019, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, administruar nga institucioni me praktikën nr.2332prot, datë 26.12.2019, janë emëruar A. M., A.P. dhe A.H. për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore për vitin 2019 të AAC, si ekspert kontabël i autorizuar. Për periudhën 01.01.2019-31.12.2019, ka përfunduar përgatitja e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të veprimtarisë së ushtrimit, të cilat janë kontrolluar nga audituesit ligjor të emëruar, sipas raportit të certifikimit dhe ekspertizës së kryer dorëzuar me datë 18.06.2019, administruar nga AAC me nr.884prot.Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2019,të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare janë mbyllur në afat, ato paraqesin drejt, dhe në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të AAC më datën 31.12.2019, performancën financiare dhe flukset e parasë në përputhje me SKK-të e përmirësuara.

Me shkresën nr.884prot, datë 30.06.2019, është dërguar për informim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe pasqyrat financiare në zbatim e nenin 20, të Ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin Aviacionit Civil”, i ndryshuar.

Pasqyrat financiare(PF) janë përgatitur bazuar në koston historike, bazuar në supozimin e biznesit në vijimësi, i cili ka marrë parasysh se AAC do të jetë aktive në ekzistencën e aktivitetit të saj në të ardhmen, të cilat paraqiten në lekë. Politikat kontabël janë evidentuar në mënyrë konsistente në të gjitha periudhat e paraqitura në PF. Të gjitha transaksionet e huaja të konvertuara në lekë janë bazuar në kursin e këmbimit të datës në të cilën janë kryer këmbimet, ndërkohë që gjendja e llogarive të mjeteve dhe detyrimeve në monedhë të huaj janë konvertuar në lekë sipas kursit zyrtar në ditën e fundit të vitit ushtrimor, të shpallur nga Banka e Shqipërisë. Diferencat e kurseve të këmbimit janë evidentuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas llogarive përkatëse referuar ndryshimeve të kursit të këmbimit. AAC kryen veprimet e saj bankare me U. Bank, Banka Cr., Banka Kombëtare Tregtare ku në secilën prej tyre ka llogaritë përkatëse në Lekë, Euro dhe Dollar. Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse, depozitat bankare dhe mjetet monetare të vendosura si garanci.

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Instrumente të tjerë jo-derivativë maten me kosto të amortizuar sipas metodës së interesit efektiv, duke zbritur humbjet nga vlerësimi. Inventarët regjistrohen në kontabilitet me kosto dhe paraqiten me vlerën më të ulët të koston së blerjes dhe çmimit të vlerësuar të shitjes duke pakësuar kostot e përfundimit dhe shitjes. Gjithashtu gjendja e inventarit janë vlerësuar me kosto historike në bilanc.

Të dhënat për pasqyrat financiare të vitit 2019 paraqiten si më poshtë :

	Në 31 dhjetor 2019	Në 31 dhjetor 2018
AKTIVET		
<i>Aktive tafatshkurtra</i>		
Mjetet monetare	317,342,574	234,033,510
Llogarit e arkëtueshme tregtare	57,685,984	54,592,335
Llogarit e arkëtueshme te tjera	1,935,032	3,459,109
Inventarë	1,912,429	1,394,341

Shpenzime të shtyra	4,621,995	
Total aktive afatshkurtra	383,498,013	293,479,296
<i>Aktivet afatgjata</i>		
Aktivet afatgjata materiale	409,324,101	410,763,499
Aktivet afatgjata jo materiale	9,440,040	495,000
Total Aktiveve Afatgjata	418,764,141	411,258,499
Total Aktive	802,262,154	704,737,795
DETYRIMET		
<i>Detyrime afatshkurtra</i>		
Llogarit e pagueshme tregtare	4,719,943	9,428,006
Personeli dhe sigurime	2,070,810	2,033,266
Te ardhurat e shtyra	2,419,425	288,000
Detyrime tatimore	928,172	3,267,086
<i>Detyrime te tjera</i>		
Të tjera të pagueshme shtetit kreditor	149,260,654	
Provizione	17,478,726	2,972,640
Total Detyrime afatshkurtra	176,877,730	15,016,358
<i>Detyrime afatgjata</i>		
Grante	3,816,250	4,420,635
Të ardhura të shtyra	658,889	
Total Detyrime afatgjata	4,475,139	7,393,275
<i>Totali i detyrimeve</i>	<i>181,352,870</i>	<i>22,409,633</i>
Kapitalet e veta		
Kapitali	402,410,346	402,410,346
Fonde te mbartura	130,657,162	181,846,441
Fitimi i ushtrimit	87,841,777	98,071,375
Total kapitali aksionar	620,909,285	682,328,162
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	802,262,154	704,737,795

Burimi i të dhënave AAC.

Gjendja e aktiveve në vitin 2019 është në shumën 802,262,154 lekë, e cila në krahasim me vitin 2018 që është në shumën 704,737,795 lekë, ka një rritje me 97,524,359 lekë.

AKTIVET

Mjetet monetare

Për vitin ushtrimor 2019 ky zë ka pësuar një rritje në masën 36% krahasuar me një vit më parë. Kjo rritje ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave, kur disa prej tyre jepen konkretisht si më poshtë vijon:

Të ardhurat nga mbikalimet nuk kanë pësuar ndryshime, vlera absolute është e njëjtë 167,000,000 lekë në vitin 2018 dhe në vitin 2019.

Të ardhurat nga tarifa e sigurisë dhe komunikimit janë rritur në masën 10% ose në shifra absolute nga 188,876,115 lekë në 207,764,655 vitin 2019. Kjo rritje lidhet me shtimin e numrin të pasagjerëve për vitin 2019 krahasuar me një vit më parë.

Të ardhurat nga tarifat e pagesave për licenca janë në vlerën 16,550,186 lekë krahasuar me vitin 2018 në vlerën 26,002,866. Kjo diferencë ka ardhur kryesisht si rezultat i lëshimit të dy certifikatave të vlefshmërisë ajrore për kompaninë ajrore Alb. me një vlerë prej 13,643,800 lekë/total ndërkohë që ky shërbim është ofruar vetëm për lëshimin e një certifikate për vitin 2019.

Llogari të arkëtueshme tregtare

Shuma përfaqëson të ardhurat që AAC pret të arkëtojë nga klientët të cilët nuk i kanë shlyer detyrimet përkundrejt faturave të lëshuara.

Mbeten të pashlyera detyrimet nga disa klient të për të cilat nuk pritet arkëtim pasi këto kompani kanë falimentuar dhe nuk operojnë më në treg. Konkretisht janë kompanitë A. B. P.&C. L. KG., A. V., L., A. A. dhe E., për fluturime ferry. Vlera e detyrimit që kanë këto kompani ndaj Institucionit është 125,000 lekë në total.

Llogari të arkëtueshme të tjera

Shuma përfaqëson të ardhurat që AAC pret të arkëtojë nga furnitorë dhe ish-punonjës që janë larguar nga institucioni. Rritja e vlerës së këtij zëri në vitin 2018, ka ardhur si rezultat i garancisë për TBP. Aktualisht vlera që pritej të arkëtohet nga furnitorët dhe ish-punonjësit, nuk ka ndryshuar përgjatë vitit 2019, por AAC e ka si prioritet arkëtimin e këtyre detyrimeve të pashlyera nga të tretët, për të cilat janë në vijueshmëri procesi i njoftimeve të tyre për shlyerjen e detyrimeve përkatëse. Përkatësisht me urdhrin e brendshëm nr.285, datë 06.06.2019 të ish-Drejtorit Ekzekutiv të AAC K. K. i është dërguar njoftimi për të gjithë ish-punonjësit dhe ish anëtarë të Këshillit Drejtues që të kthejnë të gjitha pajisjet informatike që kanë pasur në ngarkim për shkak të detyrës që ato kanë ushtruar. Shkresat janë dërguar si më poshtë:

Me shkresën nr.1119/1 është lajmëruar A. L.

Me shkresën nr.1119/2 është lajmëruar A. C.

Me shkresën nr.1119/3 është lajmëruar A. A.

Me shkresën nr.1119/4 është lajmëruar F. G.

Me shkresën nr.1119/4 është lajmëruar I. H.

Edhe pse këto persona janë lajmëruar që në datën 06.06.2019, asnjë prej tyre nuk ka kthyer pajisjet informatike, nga ana e Drejtorit Ekzekutiv nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjor, veprim ky që ngarkon K.K. në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të AAC nga data 14.11.2017-22.04.2020 dhe E. K. në pozicionin aktual të Drejtorit Ekzekutiv të AAC. (22.04.2020- e në vazhdim).

Inventarë

Ky zë përfaqëson gjendjen e mallrave në magazinë më 31.12.2019. Krahasuar me vitin 2018 është rritur në vlerën 518,050 lekë.

5. Aktivitet afatgjatë jomateriale

Rritja e këtij zëri krahasuar me një vit më parë ka ardhur si rezultat i blerjes të sistemit të “Lejeve të Fluturimit”.

DETYRIMET

Llogari të pagueshme tregtare

Janë detyrimet që AAC duhet tu shlyejë të tretëve kundrejt faturës. Janë detyrime vetëm të vitit 2018 të cilat janë shlyer gjatë vitit 2019.

Personeli dhe Sigurime

Ky zë rezulton me një rritje prej 37,544 lekë në vlerë absolute.

3.Të ardhura të shtyra.

Ky zë përfshin ato të ardhura të cilat faturimi i tyre shtrihet përtej vitit 2019,të tilla si:

Certikatë e operimit ajror për A. A., Al.
Licenca e operatorit ajror për A. Al.
Licensimi e Aeroportit.

4. Detyrime të tjera

Vlera 149,260,654 lekë përfaqëson derdhjen në buxhetin e shtetit fitimi i vitit ushtrimor për 2 vite, me Vendimin e Këshillit Drejtues.

Ndërkohë që vlera 17,478,726 lekë janë parashikimet nga Sektori Ligjior i proceseve gjyqësore për vitin. Vlera është në rritje për shkak të proceseve të hapura kryesisht nga ish-punonjësit e larguar.

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga aktiviteti.

Të ardhurat për vitin 2019 paraqiten në vlerën 395,804,233 lekë, në krahasim me vitin 2018 të cilat kanë qenë në vlerën 382,378,986 lekë, pra me një rritje në vlerën 13,425,247 lekë. Kryesisht të ardhurat janë nga tarifat e rrugës en-route që i faturohet Euro. për mbikalimet, në territorin e Shqipërisë, të cilat mbliidhen nga Euro. në zbatim të marrëveshjes së lidhur për këto tarifa të cilat janë në vlerën 167,000,000 lekë.

Të ardhura të tjera.

Janë nga tarifa e sigurisë së aviacionit të cilat merren në përmjet aeroportit Nënë Tereza të cilat janë në vlerën 207,764,655 lekë për vitin 2019 dhe në krahasim me vitin 2018 ato kanë qenë në vlerën 188,876,116 lekë pra me një rritje në vlerën 18,888,539 lekë. Kjo rritje ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të pasagjerëve në dalje nga TIA, ku AAC për çdo pasagjer në dalje përfiton 1 Euro. Të ardhurat nga autorizimet, licencimet, certifikimet të cilat bëhen sipas Kodit Ajror në Republikën e Shqipërisë të cilat për vitin 2019 janë në vlerën 16,550,186 lekë dhe për vitin 2018 janë në vlerën 26,002,866 lekë.

Këto të ardhura përdoren nga AAC për shpenzime pagash, sigurimesh shëndetësore e shoqërore, shpenzime administrative, investime kapitale, sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit për funksionimin normal të tij.

SHPENZIME

Materiale të para dhe të konsumueshme.

Ky zë ka një ulje të konsiderueshme në vlerën 4,251,609 lekë në vitin 2019, krahasuar me vitin 2018 kjo për shkak të përdorimit me efikasitet dhe efektivitet të të ardhurave.

2. Shpenzime të tjera.

Këtu përfshihen shpenzime në lidhje me trajnimet jashtë vendit, shpenzime për ekspertë të jashtëm, shpenzime të cilat kanë sjellë dhe rritjen prej 68% në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018.

3. Shpenzime Personeli.

Në vitin 2019 Shpenzime Personeli ka pësuar një rënie prej 1,720,139 lekë pasi në Prill 2019 Aeroporti i Kukësit u dha me koncesion.

4. Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.

Në këtë zë përfshihen shpenzime të ndryshme administrimi si roje objekti, mirëmbajtje e sistemit financiar Alpha, mirëmbajtje e webpage, mirëmbajtje pajisje zyresh. Në vitin 2019 krahasuar me vitin 2018 ka pasur një rënie prej 12,002,146 lekë në vlerë absolute.

	Në 31 dhjetor 2019	Në 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga aktiviteti	395,804,233	382,378,986

Të ardhura të tjera	781,150	18,136,895
Materiale të para dhe të konsumueshme	-3,306,079	-7,557,688
Shpenzime të tjera	-97,045,846	-57,752,824
Shpenzime personeli	-143,061,401	-148,661,963
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-11,186,178	-13,700,659
Shpenzime të tjeratë shfrytëzimit	-50,258,078	-62,260,224
Të ardhura nga interesat	854	14,835
Humbje nga këmbimet valutore	-3,886,878	-12,498,585
Zhvlerësimi I aktiveve financiare	-	-27,397
Fitimi para tatimit	87,841,777	98,071,375
Fitimi I vitit	87,841,777	98,071,375
Totali I të ardhurave të përgjithshme	87,841,777	98,071,375

Burimi i të dhënave AAC.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur mbi jetën e vlerësuar të aktivitetit afatgjatë material duke vlerësuar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, sipas normave vjetore të amortizimit të aplikueshme sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018. Konkretisht metoda dhe normat e amortizimit paraqiten si më poshtë:

Kategoritë e AAM-ve	Viti 2019		Viti 2018	
	Norma e amortizimit	Metoda e llogaritjes	Norma e amortizimit	Metoda e llogaritjes
Ndërtesa e konstruksione	5%	Vlerën e mbetur	5%	Vlerën e mbetur
Mobilje	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Pajisje zyre				
Pajisje informatike	25%	Vlerën e mbetur	25%	Vlerën e mbetur
Dhe softe				
Makineri	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Dhe pajisje				
Mjete transporti	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Aktivetafatgj.jomateriale	15%	Vlerën e mbetur		
Aktivetafatgj.materiale.	25%	Vlerën e mbetur		

Burimi i të dhënave AAC.

Ndryshimi i normave të amortizimit dhe metoda e përdorur në vlerësimin kontabël të AAM-ve, ka ndodhur si rezultat i zhvillimeve të reja dhe si i tillë njihet përgjatë gjithë periudhës kontabël në të cilën ka ndodhur, dhe jo në retrospektivë referuar SKK1.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.343 datë 07.06.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, Aeroporti i Kukësit është pronë e paluajtshme e shtetit, me statusin e pronës së paluajtshme publike dhe Autoriteti i Aviacionit Civil është organi përgjegjës për administrimin e këtij aeroporti.

Nga Këshilli i Ministrave me VKM 146, datë 20.03.2019, është miratuar kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Shtetin Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “G.T. M.”, SHPK., dhe “B.”, SHPK.,

në cilësinë e konçensionarit dhe me shoqërinë konçensionarit “K.I.A.” SHPK., për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit.

-Në lidhje me procesin e inventarizimit të aktiveve të AAC.

Me urdhrin nr. 599, datë 05.12.2019 të titullarit të AAC, është krijuar komisioni për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, për AAC i përbërë prej A.D., K.G. dhe I.M. Sipas këtij urdhri procesi do të përfshijë periudhën ushtrimore Janar- Dhjetor 2019, dhe të gjitha procedurat duhet të përfundojnë brenda datës 31.12.2019. Grupi i punës pasi ka marrë kartelat e hartuara nga financa për gjendjen kontabël, ka kryer verifikimin e materialeve sipas personave të cilat i kishin në ngarkim ato.

Me shkresën nr. 2190/1 prot, datë 31.12.2019 është hartuar relacioni përmbledhës në të cilin janë evidentuar gjendja fizike e AAM-ve materiale dhe jo materiale në të cilin janë pasqyruar se nuk ka diferenca (tepër), apo (mangët).

Gjithashtu nga komisioni janë evidentuar dhe materiale të cilat kishin kaluar kohën e amortizimit dhe janë të papërdorshme ose jo në gjendje pune sipas tyre duke relatuar tek titullari për ngritjen e një komisioni vlerësimi të këtyre materialeve për gjendjen tekniko funksionale.

Me urdhrin nr. 339, datë 15.09.2020, të titullarit të AAC është krijuar komisioni për kryerjen e procesit të vlerësimit të aktiveve të cilat janë propozuar nga komisioni i inventarizimit, për nxjerrje jashtë përdorimit. Komisioni përbëhet nga A. P. kryetar, e anëtarët A.G., E. K. , E. Gj. dhe K.G. Sipas këtij urdhri procedura duhet të përfundojë brenda datës 15.10.2020.

Me shkresën nr. prot. 1532/1 prot, datë 15.10.2020, si dhe me procesverbalin me nr. prot.1532/2, datë 15.10.2020 për vlerësimin e aktiveve të cilat janë propozuar të nxirren jashtë përdorimit, është paraqitur relacioni nga kryetari i komisionit dhe procesverbali i mbajtur nga grupi i punës mbi aktivet që sipas listës së hartuar nga komisioni i inventarizimit janë propozuar për rivlerësim, nga ku rezulton që një pjesë e aktiveve të rivlerësuara duhet të riparohen për të realizuar funksionimin normal të procesit të punës.

Lista përfundimtare e aktiveve të cilat janë gjykuar për tu nxjerrë jashtë përdorimit është 27 artikuj, në vlerën fillestare 4,558,364 lekë dhe vlerën kontabël të mbetur 1,340,893 lekë.

Me urdhrin nr.420, datë 27.11.2020, të titullarit të AAC, është miratuar nxjerrja jashtë përdorimit të aktiveve sipas listës së hartuar nga komisioni i vlerësimit.

Me urdhrin nr.340, e praktika nr.1533 prot., datë 15.09.2020, nga titullari i AAC është ngritur komisioni për asgjësimin e aktiveve dhe materialeve të miratuara për nxjerrje jashtë përdorimit, i përbërë prej, G.B., F.N., E. M., M.K. dhe E.K.

Me shkresën nr. 1533/3 pro., datë 02.12.2020, është mbajtur procesverbali nga komisioni i asgjësimit të aktiveve, për asgjësimin e aktiveve, i cili është nënshkruar nga të gjithë anëtarët. Për listën e materialeve të AAC të cilat do të asgjësoheshin, sipas këtij procesverbali asgjësimi i tyre është bërë në impiantin e depozitimit “I. B. SPV sh.p.k”.

Transporti i tyre sipas komisionit është kryer me automjetin e AAC,V. kombi me targë A... IZ, me drejtues E.K.

2020.

Me shkresën nr. 2042 prot., datë 22.02.2021, të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, administruar nga institucioni me praktikën nr.306 prot., datë 25.02.2021, është emëruar Ç. dhe E.V. për të kontrolluar dhe çertifikuar llogaritë vjetore për vitin 2020 të AAC, si ekspert kontabël të autorizuar. Për periudhën 01.01.2020-31.12.2020, ka përfunduar përgatitja e bilancit kontabël dhe pasqyrave financiare të veprimtarisë së ushtrimit, të cilat janë kontrolluar nga audituesi ligjor

i emëruar, sipas raportit të certifikimit dhe ekspertizës së kryer dorëzuar me datë 19.04.2021, administruar nga AAC me nr.196/2 prot. Nga auditimi i kryer u konstatua se, për vitin 2020,të dhënat kontabël dhe pasqyrat financiare janë mbyllur në afat, ato paraqesin drejt, dhe në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të AAC më datën 31.12.2020, performancën financiare dhe flukset e parasë në përputhje me SKK-të e përmirësuara.

Me shkresën nr.722 prot., datë 27.04.2021, është dërguar për informim në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë raporti i veprimtarisë vjetore të Autoritetit të Aviacionit Civil, si dhe pasqyrat financiare në zbatim e nenin 20, të Ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin Aviacionit Civil”, i ndryshuar.

Të dhënat për pasqyrat financiare të vitit 2020 janë si më poshtë:

	Në 31 dhjetor 2020	Në 31 dhjetor 2019
AKTIVET		
<i>Aktivet afatshkurtra</i>		
Mjetet monetare	181,930,176	317,342,574
Llogarit e arkëtueshme tregtare	26,064,426	57,685,984
Llogarit e arkëtueshme te tjera	1,935,032	1,935,032
Inventarë	2,186,152	1,912,429
Shpenzime të shtyra	5,064,354	4,621,995
Total aktive afatshkurtra	217,180,139	383,498,013
<i>Aktivet afatgjata</i>		
Aktivet afatgjata materiale	396,976,563	409,324,101
Aktivet afatgjata jo materiale	13,830,761	9,440,040
Total Aktiveve Afatgjata	410,807,324	418,764,141
Total Aktive	627,987,462	802,262,154
DETYRIMET		
<i>Detyrime afatshkurtra</i>		
Llogarit e pagueshme tregtare	3,770,959	4,719,943
Personeli dhe sigurime	2,061,369	2,070,810
Te ardhurat e shtyra	2,448,466	2,419,425
Detyrime tatimore	1,001,033	928,172
<i>Detyrime te tjera</i>		
Të tjera të pagueshme shtetit kreditor		149,260,654
Provizione	8,686,839	17,478,726
Total Detyrime afatshkurtra	17,968,666	176,877,730
<i>Detyrime afatgjata</i>		
Grante	3,570,950	3,816,250
Provizione		
Të ardhura të shtyra	458,889	658,889
Total Detyrime afatgjata	4,029,839	4,475,139
<i>Totali i detyrimeve</i>	<i>21,998,505</i>	<i>181,352,870</i>
Kapitalet e veta		
Kapitali	402,410,346	402,410,346

Fondet e mbartura	218,498,939	130,657,162
Fitimi i ushtrimit	(14,920,327)	87,841,777
Total kapitali aksionar	605,988,958	620,909,285
Totali i kapitalit dhe detyrimeve	627,987,463	802,262,154

Burimi i të dhënave AAC.

Gjendja e aktiveve në vitin 2020 është në shumën 627,987,462 lekë, e cila në krahasim me vitin 2019 që është në shumën 802,262,154 lekë, ka një ulje me 174,274,692 lekë.

AKTIVET

1.Mjetet monetare

Për vitin ushtrimor 2020 ky zë ka pësuar një ulje në masën 43% krahasuar me një vit më parë. Në krahasim me vitin 2019, vihet re një ulje drastike e të ardhurave si pasojë e situatës së krijuar për shkak të Covid 19, e cila pasoi me pezullimin e aktivitetit të fluturimeve gjatë periudhës Mars-Qershor dhe vendosjes së rregullave dhe protokolleve për lëvizjen e pasagjerëve për periudhën në vazhdim. Si pasojë e masave kufizuese më të ardhurat e ndikuara më tepër janë ato nga tarifa en-route dhe tarifa e sigurisë, të cilat janë direkt të lidhura me aktivitetin e fluturimeve. Të ardhurat nga mbikalimet nga 167,000,004 lekë në 2019 kanë zbritur në 66,310,240 lekë.

Të ardhurat nga tarifa e sigurisë dhe komunikimit janë ulur në masën 62% ose në shifra absolute nga 207,764,655 lekë në 79,527,895 vitin 2020.

Të ardhurat nga tarifat e pagesave për licenca janë në vlerën 18,916,150 lekë krahasuar me vitin 2019 në vlerën 16,550,186 lekë.

2.Llogari të arkëtueshme tregtare

Shuma përfaqëson të ardhurat që AAC pret të arkëtojë nga klientët të cilët nuk i kanë shlyer detyrimet përkundrejt faturave të lëshuara. Mbeten të pashlyera detyrimet nga disa klient të për të cilat nuk pritet arkëtim pasi këto kompani kanë falimentuar dhe nuk po perojnë më në treg. Konkretisht janë kompanitë A.B. P.&C.L. KG, A. V., L., A. A. dhe E., për fluturime ferry. Vlera e detyrimit që kanë këto kompani ndaj Institucionit është 125,000 lekë në total.

3.Llogari të arkëtueshme të tjera

Shuma përfaqëson të ardhurat që AAC pret të arkëtojë nga furnitorë dhe ish punonjës që janë larguar nga institucioni. Vlera që pritej të arkëtohet nga furnitorët dhe ish-punonjësit, nuk ka ndryshuar përgjatë vitit 2020, por AAC e ka si prioritet arkëtimin e këtyre detyrimeve të pashlyera nga të tretët, për të cilat janë në vijueshmëri procesi i njoftimeve të tyre për shlyerjen e detyrimeve përkatëse.

4.Inventarë.

Ky zë përfaqëson gjendjen e mallrave në magazinë më 31.12.2019. Krahasuar me vitin 2018 është rritur në vlerën 518,050 lekë.

Aktivet afatgjata jo materiale

Rritja e këtij zëri krahasuar me një vit më parë është 47 %. Kjo rritje përkon me vlerën e sistemit elektronik të "Mbikqyerjes në Aviacion".

DETYRIMET

Llogari të pagueshme tregtare.

Janë detyrimet që AAC duhet tu shlyejë të tretëve kundrejt faturës. Janë detyrime të vitit 2019 të cilat janë shlyer gjatë vitit 2020.

Personeli dhe Sigurime.

Ky zë rezulton me një zbritje prej 9,441 lekë në vlerë absolute.

Të ardhura të shtyra

Ky zë përfshin ato të ardhura të cilat faturimi i tyre shtrihet përtej vitit 2020, të tilla si:

Certikatë e operimit ajror për A.A., Alb.

Licenca e operatorit ajror për A. A.

Licensimi e Aeroportit.

Detyrime të tjera

Janë provizione të parashikuara për proceset gjyqësore ku palë e paditur është AAC, kjo përsa i përket largimeve nga puna të ish-punonjësve.

TË ARDHURAT

Të ardhurat nga aktiviteti.

Të ardhurat për vitin 2020 paraqiten në vlerën 164,847,356 lekë, të cilat në krahasim me vitin 2019 kanë qenë në vlerën 395,804,233 lekë. Për të përballuar këtë ulje drastike të të ardhurave në 30 Korrik 2020, ndërmjet AAC dhe Alb. është nënshkruar Marrëveshja për ndarjen e paketës financiare të kredisë së EURO. dhe rishikimin e tarifës së AAC për vitin 2020, për përballimin e krizës së shkaktuar nga COVID-19. Në vijim të kësaj marrëveshje tarifa e rishikuar do të arkëtohet sipas një skeduli të përcaktuar.

Të ardhura të tjera.

Të ardhura të tjera janë nga tarifa e sigurisë së aviacionit të cilat merren në përmjet aeroportit “Nënë Tereza” të cilat janë ulur me 62% krahasuar me vitin 2019 dhe kjo për shkak të uljes së fluksit të pasagjerëve në dalje nga Aeroporti “Nënë Tereza”, për shkak të situatës së krijuar nga pandemia Covid-19.

Të ardhurat nga autorizimet, licencimet, certifikimet të cilat bëhen sipas Kodit Ajror në Republikën e Shqipërisë të cilat për vitin 2020 janë në vlerën 18,916,150 lekë dhe për vitin 2019 janë në vlerën 16,550,186 lekë.

Këto të ardhura përdoren nga AAC për shpenzime pagash, sigurimesh shëndetësore e shoqërore, shpenzime administrative, investime kapitale, sipas nevojave dhe kërkesave të institucionit për funksionimin normal të tij.

SHPENZIME

1. Materialetë para dhe të konsumueshme

Ky zë ka një ulje të konsiderueshme në vlerën 4,251,609 lekë në vitin 2020, krahasuar me vitin 2019 kjo për shkak të situatës së krijuar nga Covid-19, ku puna gjatë vitit është alternuar pjesërisht në zyrë dhe pjesërisht në shtëpi.

Shpenzime të tjera

Këtu përfshihen shpenzime në lidhje me trajnimet jashtë vendit, shpenzime për ekspertë të jashtëm, shpenzime të cilat u pezulluan gjatë 3 mujorit të dytë të vitit 2019. Ky pezullim solli uljen nga 97,045,846 lekë në vitin 2019 në vlerën 18,459,224 lekë në vitin 2020.

Shpenzime Personeli

Në vitin 2020, përkatësisht në muajt Prill-Gusht kishte një ulje të pagës prej 30% si pasojë e situatës të krijuar për shkak të COVID 19. Kjo solli dhe uljen e Shpenzime Personeli në vlerën 122,566,535 lekë në 2020 krahasuar me vitin 2019 që ishte në vlerën 143,061,401 lekë.

Shpenzime të tjera të shfrytëzimit.

Në këtë zë përfshihen shpenzime të ndryshme administrimi si roje objekti, mirëmbajtje e sistemit financiar Alpha, mirëmbajtje e webpage, mirëmbajtje pajisje zyrash. Në vitin 2020 krahasuar me

vitin 2019 ka pasur një rënie prej 25,203,485 lekë në vlerë absolute, thënë ndryshe kjo shumë është përgjysmuar.

	Në 31 dhjetor 2020	Në 31 dhjetor 2019
Të ardhura nga aktiviteti	164,847,356	395,804,233
Të ardhura të tjera	245,300	781,150
Materiale të para dhe të konsumueshme	-1,843,988	-3,306,079
Shpenzime të tjera	-18,459,224	-97,045,846
Shpenzime personeli	-122,566,535	-143,061,401
Shpenzime zhvlerësimi dhe amortizimi	-14,619,993	-11,186,178
Shpenzime të tjeratë shfrytëzimit	-25,054,593	-50,258,078
Të ardhura nga interesat	-2,490,606	-3,886,878
Humbje nga këmbimet valutore	40,745	854
Zhvlerësimi I aktiveve financiare	-14,920,327	87,841,777
Fitimi para tatimit	-14,920,327	87,841,777
Fitimi I vitit	-14,920,327	87,841,777

Burimi i të dhënave AAC.

Amortizimi i aktiveve është llogaritur mbi jetën e vlerësuar të aktivitetit afatgjatë material duke vlerësuar nga dita e parë e muajit që pason muajin e blerjes, sipas normave vjetore të amortizimit të aplikueshme sipas Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018. Konkretisht metoda dhe normat e amortizimit paraqiten si më poshtë:

Kategoritë e AAM-ve	Viti 2020		Viti 2019	
	Norma e amortizimit	Metoda e llogaritjes	Norma e amortizimit	Metoda e llogaritjes
Ndërtesa e konstruksione	5%	Vlerën e mbetur	5%	Vlerën e mbetur
Mobilje	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Pajisje zyre				
Pajisje informatike	25%	Vlerën e mbetur	25%	Vlerën e mbetur
Dhe softe				
Makineri	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Dhe pajisje				
Mjete transporti	20%	Vlerën e mbetur	20%	Vlerën e mbetur
Aktivetafatgj.materiale	15%	Vlerën e mbetur	15%	Vlerën e mbetur
Aktivetafatgj.materiale.	25%	Vlerën e mbetur	25%	Vlerën e mbetur

Burimi i të dhënave AAC.

Ndryshimi i normave të amortizimit dhe metoda e përdorur në vlerësimin kontabël të AAM-ve, ka ndodhur si rezultat i zhvillimeve të reja dhe si i tillë njihet përgjatë gjithë periudhës kontabël në të cilën ka ndodhur, dhe jo në retrospektivë referuar SKK1.

Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.343 datë 07.06.2006 “Për pronësinë dhe administrimin e aeroportit të Kukësit”, Aeroporti i Kukësit është pronë e paluajtshme e shtetit, me statusin e pronës së paluajtshme publike dhe Autoriteti i Aviacionit Civil është organi përgjegjës për administrimin e këtij aeroporti.

Nga Këshilli i Ministrave me VKM 146, datë 20.03.2019, është miratuar kontrata e koncesionit/partneritetit publik privat, nëpërmjet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë për Shtetin Shqiptar dhe bashkimit të operatorëve ekonomikë “G.T. M.”, SHPK., dhe “B.”, SHPK., në cilësinë e konçensionarit dhe me shoqërinë konçensionarit “K.I.A.” SHPK., për rehabilitimin, operimin, transferimin e aeroportit të Kukësit.

-Në lidhje me procesin e inventarizimit të aktiveve të AAC për vitin 2020.

Me urdhrin nr. 446, datë 16.12.2020 të titullarit të AAC, është krijuar komisioni për kryerjen e procesit të inventarizimit të aktiveve, për AAC i përbërë prej D. O. , R.B. , M. H. dhe S.T. . Sipas këtij urdhri procesi do të përfshijë periudhën ushtrimore Janar- Dhjetor 2020, dhe të gjitha procedurat duhet të përfundojnë brenda datës 31.12.2019. Grupi i punës pasi ka marrë kartelat e hartuara nga financa për gjendjen kontabël, ka kryer verifikimin e materialeve sipas personave të cilat i kishin në ngarkim.

Me shkresën nr. prot 2061, datë 31.12.2020 është hartuar relacioni përmbledhës në të cilin janë evidentuar gjendja fizike e AAM-ve material dhe jo materiale në të cilin janë pasqyruar se nuk ka diferenca (tepër), apo (mangët).

Gjetjet dhe rekomandimet për këtë pikë :

1. Titulli i gjetjes:	Ndjekja e debitorëve dhe veprimet për shlyerjen e detyrimeve.
Situata:	<p>Llogari të arkëtueshme të tjera</p> <p>Shuma përfaqëson të ardhurat që AAC pret të arkëtojë nga furnitorë dhe ish punonjës që janë larguar nga institucioni. Rritja e vlerës së këtij zëri në vitin 2018, ka ardhur si rezultat i garancisë për TBP. Aktualisht vlera që pritej të arkëtohet nga furnitorët dhe ish-punonjësit, nuk ka ndryshuar përgjatë vitit 2019, por AAC e ka si prioritet arkëtimin e këtyre detyrimeve të pashlyera nga të tretët, për të cilat janë në vijueshmëri procesi i njoftimeve të tyre për shlyerjen e detyrimeve përkatëse. Përkatësisht me urdhrin e brendshëm nr.285, datë 06.06.2019 të ish Drejtorit Ekzekutiv të AAC K. K. i është dërguar njoftimi për të gjithë ish punonjësit dhe ish anëtarë të Këshillit Drejtues që të kthejnë të gjitha pajisjet informatike që kanë pasur në ngarkim për shkak të detyrës që ato kanë ushtruar. Shkresat janë dërguar si më poshtë:</p> <p>Me shkresën nr.1119/1 është lajmëruar A. L.</p> <p>Me shkresën nr.1119/2 është lajmëruar A.C.</p> <p>Me shkresën nr.1119/3 është lajmëruar A. A.</p> <p>Me shkresën nr.1119/4 është lajmëruar F. G.</p> <p>Me shkresën nr.1119/4 është lajmëruar I. H.</p> <p>Edhe pse këto persona janë lajmëruar që në datën 06.06.2019, asnjë prej tyre nuk ka kthyer pajisjet informatike, nga ana e Drejtorit Ekzekutiv nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjor, veprim ky që ngarkon K.K. në pozicionin e Drejtorit Ekzekutiv të AAC nga data 14.11.2017-22.04.2020 dhe E.K. në pozicionin aktual të Drejtorit Ekzekutiv të AAC. (22.04.2020- e në vazhdim).</p>
Kriteri:	Ligji 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.
Ndikimi/Efekti:	Mos arkëtimi i detyrimeve që kanë të tretët ndaj AAC.
Shkaku:	Mos ndërmarrja e hapave ligjor për shlyerjen e detyrimeve ndaj shoqërisë

	nga të tretët.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi 1.1:	Drejtori Ekzekutiv i AAC, të marrë masa të menjëhershme për ndërmarrjen e të gjithë hapave ligjor për arkëtimin e detyrimeve që kanë ndaj AAC.

2.7. Përputhshmëria ligjore dhe rregullshmëria financiare në planifikim dhe në realizimin e prokurimit të fondeve publike për mallra, punë dhe shërbime.

Për periudhën 01.09.2019-30.04.2021 nga ana e institucionit Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar janë realizuar 4 procedura prokurimi të cilat janë audituar. Për periudhën para 01.09.2019 kjo pikë programi është audituar nga Auditi i mëparshëm i KLSH-së. Procedurat e zhvilluara dhe audituara për periudhën 1.09.2019 deri me 30.04.2021.

Viti	Nr	Emertimi	Fondi Limit	Lloji	V. Kontratës	Data zhvillimit	Fituesi
2019	1	Sigurimi i ndertesës dhe pajisjeve të AAC	2,000,000	K. për propozim	1,964,600	13/08/2019	A.
	2	Sigurimi i shëndetit të punonjësve të AAC	4,000,000	K. për propozim	3,993,100	11/11/2019	I. JETE SH.A
2020	3	Sigurim i ndertesës dhe pajisjeve të AAC	2,200,000	K. për propozim	2,197,950	13/08/2020	A.
	4	Sigurimi i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC	4,000,000	K. për propozim	3,993,100	02/12/2020	I. JETE SH. A

1-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” me fond limit 3,999,670 lekë, viti 2019 konstatohet:

Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim” Urdhri nr 1927 datë 22.10.2019	2 Njësia e Prokurimit A. P. A.N. O.A.	3.1 KVO Urdhri nr 1928 datë 22.10.2019 A. S. R.A. A. D.	3.2 KSHA
4. Fondi Limit 3,999,670 lekë	5. Oferta fituese 3,993,100 lekë	6. Diferenca me fondin limit 6,570 lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 07.12.2019	8. Burimi Financimit Të ardhurat e veta	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër1 b) S’kualifikuar OOE, c) Kualifikuar IOE	
7/2 Kohëzgjatja 12 muaj			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i AAC K.K.me shkresën nr. 1725 prot datë 17.09.2019 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën “*Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së*”, pa marrë marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës, Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germ; a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, **ose të nevojës për prokurim**, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Në dosje nuk ekziston asnjë relacion apo procesverbal sqarues për domosdoshmërinë e sigurimit të aseteve të këtij Institucioni, rrezikshmërinë që i kanoset, nevojën për sigurim të tyre etj.

Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe rriskun e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion në referencë të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”. Punëdhënësi në referencë të nenit 9 këtij ligji ka detyrim të veçantë si më poshtë:

a) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta;

b) përcakton masat mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren;

c) mban regjistër të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë për më shumë se 3 ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale;

ç) harton raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse.

-Gjithashtu në referencë të nenit 10 të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, punëdhënësi detyrohet si më poshtë:

Neni .10. Detyrime të punëdhënësit për hartimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale Punëdhënësi, për hartimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, ka këto detyrime:

a) miraton, në fazën e kërkimit, të projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave, të vënies në punë të pajisjeve të punës e të teknologjive, që do të përdoren, zgjedhje në përputhje me 9 dispozitat ligjore në fuqi, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

b) përpilon, duke vlerësuar rrezikun, një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut, që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieno-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës të veprimtarisë;

c) merr autorizimet përkatëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi, para fillimit të çdo veprimtarie, për mënyrën e veprimit për sigurinë dhe shëndetin në punë;

ç) përcakton, në përshkrimet e punës, cilësitë dhe përgjegjësitë e punëmarrësit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, sipas pozicionit përkatës të punës;

d) harton, në zbatim të ligjit, udhëzimet e tyre, në mënyrë që të plotësojnë dhe zbatojnë rregulloret për sigurinë dhe shëndetin në punë për veprimtari të veçanta dhe vendet e punës në përgjegjësi të tyre.

Në respektim të këtij ligji titullari i AAC përpara nxjerrjes së urdhrit për specifikimet teknike dhe fondin limit për një procedurë të tillë “*Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së*”, duhet të mbante:

regjistrat përkatës të aksidenteve në punë (argumenton dhe justifikon nevojën e procedurës)
raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale (argumentojnë dhe justifikojnë termat e referencë) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; (argumentojnë dhe justifikojnë stafin e nevojshëm për pajisje me policë sigurimi)

Sa më sipër jemi në kushtet që ish-titullari i AAC K.K. ka nxjerr një urdhër për përlogaritje fondi limit, hartim specifikimesh dhe terma reference për një procedure prokurimi të pa argumentuar nevojën për prokurim duke sjellë shpenzime jo në përputhje me ligjin.

1. Titulli i gjetjes:	Mangësi në justifikimin dhe argumentimin e nevojave.
Situata:	<p>Titullari i AAC K.K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së</i>”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së</i>” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe rrishtet e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion në referencë të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “<i>Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë</i>”.</p> <p>Në respektim të këtij ligji titullari i AAC përpara nxjerrjes së urdhrit për specifikimet teknike dhe fondin limit për një procedurë të tillë “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së</i>”, duhet të mbante:</p> <p>-regjistrat përkatës të aksidenteve në punë (argumenton dhe justifikon nevojën e procedurës) -raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale (argumentojnë dhe justifikojnë termat e referencë) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; (argumentojnë dhe justifikojnë stafin e nevojshëm për pajisje me policë sigurimi).</p>
Kriteri:	<i>Ligji i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma; a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;</i>
Ndikimi:	Shpenzime të pa argumentuara plotësisht .
Shkaku	Mungesa e vëmendjes dhe qartësisë në trajtimin e situatave, nevojave dhe argumentimi i tyre në referencë të frymës së ligjit të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 1.1:	AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatës, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

-Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 1725 prot., datë 17.09.2019 ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës.

Kërkesat për ofertë dërguar me shkresën; nr.1725/1 prot., datë 20.09.2020 kompanive “S. U.G. A.”, “I.” SHA dhe kompanisë “S. I.” SHA, ndër të tjera përmbajnë dhe Termtat e referencës , por për të cilat nuk është mbajtur asnjë dokument për hartimin e tyre. Në termtat e referencës, komisioni i përberë nga A.P., A. N. dhe O.A. , ndër të tjera kanë kërkuar mbulim për “50% e vlerës së ndërhyrjes në spitalin Amerikan” duke bërë dhe një përzgjedhje të institucioneve shëndetësore private.

-Me shkresën nr. 1725/5 prot., datë 07.10.2019, komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit i përberë nga A. P. , A.N. dhe O.A. , i dërgon specifikimet titullarit të AAC me fond limit të llogarit prej 3,999,670 lek.

-Me shkresën nr. 1927 prot., datë 22.10.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nxjerrë urdhrin e prokurimit me fond limit me vlerë 3,999,670 lekë dhe njësi prokurimi A.P. , A.N. dhe O. A.

-Me shkresën nr. 1928 prot., datë 22.10.2019 titullari i autoritetit kontraktor nga nxjerr urdhrin për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga A. S. kryetar, I. K. dhe R. A. antarë.

-Me datë 23.10.2019 NJP ka mbajtur procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit. Me procesverbalin e datës 24.10.2019 NJP ka njoftuar Operatorët ekonomik për pjesëmarrje:

I. S. J. SHA.

S. I.A. V. I. G. SHA

A. J. SHA

S.U.G. A. SHA

Me urdhrin nr. 534 datë 31.10.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor ,ka nxjerr urdhrin për pezullim procedure dhe ndryshim dokumente të tenderit.

Me shklesen datë 31.10.2019 shtojcë nr. 1, u bë ndryshimi i DST dhe afati i hapjes së procedurës datë 11.11.2019 ora 10:00.

-Me shkresën nr. 2033 prot., datë 11.11.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nxjerr urdhrin nr. 552 datë 11.11.2019 për zëvendësimin e antarit të KVO, I. K. zëvendësohet me A. D.

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin datë **15.10.2019** të KVO “Për shqyrtimin dhe vlerësimin ofertave”, u konstatua se në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm 1 OE me ofertat si më poshtë:

Nr.	Shoqëria	Oferta Lekë
1	“I. J.” SHA	3,993,100

Me shkresën nr. 1928/2 prot., datë 25.11.2019 KVO, ka hartuar raportin përmbledhës të cilin nuk e ka miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit public”, i ndryshuar Nenet 68 dhe 69, dhe ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK K. K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nuk u konstatuan problematika.

Pas njoftimit të fituesit në sistem OE i njoftuar I. J. Sha ka depozituar dokumentacionin fizik për verifikim në institucion.

2-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” me fond limit 3,995,553 lekë, viti 2020 konstatohet:

Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkes për propozim” Urdhri nr 1918 datë 18.11.2020	2 Njësia e Prokurimit E. M. O. A. A. D.	3.1 KVO Urdhri nr 1918/1 datë 18.11.2020 A.S. R. A. J. Gj.	3.2 KSHA
4. Fondi Limit 3,995,553 lekë	5. Oferta fituese 3,993,100 lekë	6. Diferenca me fondin limit 2,453 lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 02.12.2020	8. Burimi Financimit Të ardhurat e veta	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër1 b) S’kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1OE	
7/2 Kohëzgjatja 12 muaj			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i AAC E.K. me shkresën nr. 1826 prot., datë 02.11.2020, ka ngritur grupin e punës të përberë nga A. Gj., A.D. dhe K.K. , për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës por vetëm duke ju referuar programit ekonomik. Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germa, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, **ose të nevojës për prokurim**, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Gjithashtu në dosje nuk ekziston asnjë relacion apo procesverbal sqarues për domosdoshmërinë e sigurimit të aseteve të këtij Institucioni, rrezikshmërinë që i kanoset, nevojën për sigurim të tyre etj.

Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “ Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion në referencë të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”. Punëdhënësi në referencë të nenit 9 këtij ligji ka detyrim të veçantë si më poshtë:

a) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta;

b) përcakton masat mbrojtëse që duhen marrë dhe, nëse është e nevojshme, pajisjet mbrojtëse që do të përdoren;

c) mban regjistër të aksidenteve në punë, për rastet kur punëmarrësit përfitojnë paaftësi të përkohshme në punë për më shumë se 3 ditë pune, për shkak të aksidenteve e të sëmundjeve profesionale;

ç) harton raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale, të cilat ia vë në dispozicion autoriteteve përkatëse.

-Gjithashtu në referencë të nenit 10 të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” punëdhënësi detyrohet si më poshtë:

Neni .10. Detyrime të punëdhënësit për hartimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë e të sëmundjeve profesionale Punëdhënësi, për hartimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, ka këto detyrime:

a) miraton, në fazën e kërkimit, të projektimit dhe ndërtimit të ndërtesave, të vënies në punë të pajisjeve të punës e të teknologjive, që do të përdoren, zgjedhje në përputhje me 9 dispozitat ligjore në fuqi, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve për aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale;

b) përpilon, duke vlerësuar rrezikun, një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut, që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieno-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës të veprimtarisë;

c) merr autorizimet përkatëse, sipas dispozitave ligjore në fuqi, para fillimit të çdo veprimtarie, për mënyrën e veprimit për sigurinë dhe shëndetin në punë;

ç) përcakton, në përshkrimet e punës, cilësitë dhe përgjegjësitë e punëmarrësit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, sipas pozicionit përkatës të punës;

d) harton, në zbatim të ligjit, udhëzimet e tyre, në mënyrë që të plotësojnë dhe zbatojnë rregulloret për sigurinë dhe shëndetin në punë për veprimtari të veçanta dhe vendet e punës në përgjegjësi të tyre.

Në respektim të këtij ligji titullari i AAC përpara nxjerrjes së urdhrit për specifikimet teknike dhe fondin limit për një procedurë të tillë “*Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së*”, duhet të mbante:

-regjistrat përkatës të aksidenteve në punë (argumenton dhe justifikon nevojën e procedurës)

-raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale (argumentojnë dhe justifikojnë termat e referencë) kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; (argumentojnë dhe justifikojnë stafin e nevojshëm për pajisje me policë sigurimi)

Sa më sipër jemi në kushtet që Titullari i AAC E. K. ka nxjerr një urdhër për përllogaritje fondi limit, hartim specifikimesh dhe terma reference për një procedure prokurimi të pa argumentuar nevojën për prokurim duke sjellë shpenzime jo në përputhje me ligjin.

2. Titulli i gjetjes:	Mangësi në justifikimin dhe argumentimin e nevojave.
Situata:	<p>Titullari i AAC E.K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të nj-së</i>”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së</i>” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion në referencë të Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “<i>Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë</i>”.</p> <p>Në respektim të këtij ligji titullari i AAC përpara nxjerrjes së urdhrit për specifikimet teknike dhe fondin limit për një procedurë të tillë “<i>Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së</i>”, duhet të mbante:</p> <p>regjistrat përkatës të aksidenteve në punë (argumenton dhe justifikon nevojën e procedurës)</p> <p>raporte për aksidentet në punë e sëmundjet profesionale (argumentojnë dhe</p>

	<i>justifikojnë termat e referencë)</i> kryen një vlerësim të rreziqeve për sigurinë dhe shëndetin në punë, përfshirë edhe grupet e punëmarrësve të ekspozuar ndaj rreziqeve të veçanta; (<i>argumentojnë dhe justifikojnë stafin e nevojshëm për pajisje me policë sigurimi</i>)
Kriteri:	<i>Ligji i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germa, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, <u>ose të nevojës për prokurim</u>, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;</i>
Ndikimi:	Shpenzime të pa argumentuara plotësisht.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes dhe qartësisë në trajtimin e situatave, nevojave dhe argumentimi i tyre në referencë të frymës së ligjit të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 2.1:	AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

-Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 1826 prot., datë 02.11.2020 ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës edhe pse në këtë institucion ekziston një kontratë e mëparshme e suksesshme.

-Me shkresën nr. 1826/1 prot., Datë 11.11.2020, komisioni për hartimin e specifikimeve teknike dhe fondit limit i përberë nga A.Gj., A.D. dhe K. K., i dërgon specifikimet titullarit të AAC me fond limit të llogarit prej 3,995,533 lek.

-Me shkresën nr. 1918 prot., Datë 18.11.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nxjerrë urdhrin e Prokurimit me fond limit me vlerë 3,995,533 lekë dhe njësi prokurimi E.M. , A. D. dhe O.A.

-Me shkresën nr. 1918/1 prot datë 18.11.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor, nga nxjerr urdhrin për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga A. S. kryetar, J. Gj. dhe R.A. anëtarë.

-Me datë 23.10.2019 NJP ka mbajtur procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Me procesverbalin e datës 20.11.2020 NJP ka njoftuar Operatorët ekonomik për pjesëmarrje:

1. S. J. SHA

2-S.

3-S. I.A. V. I. G. SHA

4-A. J. SHA

5-S. U. G. A. SHA

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin datë **04.12.2020** të KVO “Për shqyrtimin dhe vlerësimin ofertave”, u konstatua se në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm 1 OE me ofertat si më poshtë:

Nr	Shoqëria	Oferta Lekë
1	“I. J.” SHA	3,993,100

Me shkresën nr. 1918/4 prot., datë 14.12.2020 KVO ka hartuar raportin përmbledhës të cilin nuk e ka miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor, veprim në kundërshtim me Vendimin e

Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Nenet 68 dhe 69, dhe ngarkojnë me përgjegjësi titullarin e AK E. K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nuk u konstatuan problematika.

Pas njoftimit të fituesit në sistem OE i njoftuar I. J. Sha ka depozituar dokumentacionin fizik në institucion.

3-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2019 konstatohet:

Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sigurim I ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkesë për propozim” Urdhri nr 49 datë 31.07.2019	2 Njësia e Prokurimit A.P. A.N. I.P.	3.1 KVO Urdhri nr. 406 datë 31.07.2019 S.R. A.Gj. E.A.	3.2 KSHA
4. Fondi Limit 1,965,666 lekë	5. Oferta fituese 1,964,600 lekë	6. Diferenca me fondin limit 1,066 lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 07.12.2020	8. Burimi Financimit Të ardhurat e veta	9. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër1 b) S’kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1OE	
7/2 Kohëzgjatja 12 muaj			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

- Titullari i Autoritetit Kontraktor K. K. me shkresën nr. 1390 prot., datë 15.07.2019 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës, Veprime në kundërshtim me ligjin e prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës;

-Gjithashtu në dosje nuk ekziston asnjë relacion apo procesverbal sqarues për domosdoshmërinë e sigurimit të asetëve të këtij Institucioni, rrezikshmërinë që i kanoset, nevojën për sigurim të tyre etj.

3. Titulli i gjetjes:	Mangësi në justifikimin dhe argumentimin e nevojave.
Situata:	Titullari i AAC K. K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim I ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “Sigurim I ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në dispozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar

	që i kanos aseteve të këtij institucioni.
Kriteri:	Ligji i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, germa, a) një përshkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim , për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës.
Ndikimi:	Shpenzime të pa argumentuara plotësisht.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes dhe qartësisë në trajtimin e situatave, nevojave dhe argumentimi i tyre në referencë të frymës së ligjit të prokurimit publik.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandimi 3.1	AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

-Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 1390 prot., datë 15.07.2019 ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës duke ju referuar “Raportit financiar të Audituesve të pavaruar” për sa i përket vlerës së aseteve që do sigurohen.

Kërkesat për ofertë dërguar me shkresat me nr.1404 prot., datë 17.07.2019 kompanisë “I. V. I.G.” SHA; nr. 1404/1 prot., datë 17.07.2019 kompanisë “I.” SHA dhe me shkresën nr. 1404/2 prot., datë 17.07.2019 kompanisë “E.” SHA, ndër të tjera përmbajnë dhe Termet e referencës, por për të cilat nuk është mbajtur asnjë dokument për hartimin e tyre. Në termat e referencës, komisioni i përberë nga A. P. , A. N. dhe I. P. ndër të tjera tek pika 3 Detyrimet e sipërmarrësit kërkohet: pika 6. **Rreziku i vjedhjes** apo dëmtimit të pasurive nga veprimet që vijnë si rezultat i së parës.

Për ruajtjen e objektit dhe zyrave të AAC, ky institucion ka një kontratë me kompaninë “I. G.”, ku në rregulloren bashkangjitur kontratës është e mirë përcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi 24/7 pa ndërprerje.

Element i pa nevojshëm në policën e sigurimit duke **shtuar kostot për policë**, pasi për këtë element AAC ka një kontratë aktive për të cilën në çdo likuidim nga titullari i institucioni është nënshkruar procesverbali i performacës së ofruesit të shërbimeve, ku çdo gjë paraqitet në rregull.

4. Titulli i gjetjes:	Vendosja e elementeve të pa nevojshëm.
Situata:	Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës duke ju referuar “Raportit financiar të Audituesve të pavaruar” për sa i përket vlerës së aseteve që do sigurohen. Kërkesat për ofertë, ndër të tjera përmbajnë dhe <u>Termet e referencës</u> , por për të cilat nuk është mbajtur asnjë dokument për hartimin e tyre. Në termat e referencës, komisioni i përberë nga A. P., A. N. dhe I. P. kërkohet: Mbulim nga: Rreziku i vjedhjes apo dëmtimit të pasurive nga veprimet që vijnë si rezultat i së parës. Për ruajtjen e objektit dhe zyrave të AAC, ky institucion ka një kontratë me kompaninë “I.” G. ku në rregulloren bashkangjitur kontratës është e mirë përcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi 24/7 pa ndërprerje.

	Ky element i kërkuar të mbulohet nga polica e sigurimit, është i pa nevojshëm duke dubluar shpenzimet për këtë pjesë dhe shtuar kostot për policë , pasi për këtë element AAC ka një kontratë aktive për të cilën në çdo likuidim nga titullari i institucioni është nënshkruar procesverbali i performacës së ofruesit të shërbimeve , ku çdo gjë paraqitet në rregull.
Kriteri:	Ligji i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 1, pika 2, germa, b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 2.
Ndikimi:	Shtim kostosh.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes dhe qartësisë në përlogaritjen e fondit limit.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 4.1	AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiarë, teknik dhe juridik në përlogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike.

Pas marrjes së ofertave NJP përgatit materialin me specifikimet teknike, termat e referencës dhe fondin limit për titullarin e AAC me shkresën nr. 1479 prot., datë 30.07.2019, ku është përcaktuar fondi limit nga mesatarja e ofertave me vlerë 1,965,666 lekë.

-Me datë 01.08.2019 NJP, ka mbajtur procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit.

Me shkresën nr. 1486 prot., datë 31.07.2019 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nxjerr urdhrin për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga S. R. kryetar, A. Gj. dhe E. A. anëtarë.

Me procesverbalin e datës 02.08.2019 NJP, ka njoftuar operatorët ekonomik për pjesëmarrje:

I. S. SHA

E. SHA

I. SHA

A. SHA

S. U. G. A. SHA

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin datë **16.08.2019** të KVO “Për shqyrtimin dhe vlerësimin ofertave”, u konstatua se në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm 1 OE me ofertat si më poshtë:

Nr.	Shoqëria	Oferta Lekë
1	“A.” SHA	1,964,600

Me shkresën nr. 1486/3 prot datë 26.08.2019 KVO ka hartuar raportin përmbledhës të cilin e ka miratuar tek Titullari i Autoritetit Kontraktor.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nuk u konstatuan problematika.

Pas njoftimit të fituesit në sistem OE i njoftuar A. Sha ka depozituar dokumentacionin fizik për verifikim në institucion.

Në procesverbalin e KVO datë 03.09.2019, për verifikimin e përputhshmërisë së dokumentacionit për procedurën e prokurimit me objekt: “Sigurimi i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC” u konstatua se: ky procesverbal është nënshkruar vetëm nga 2 anëtarë të KVO nga A. Gj.

dhe E.A., ndërkohë që S.R. në cilësinë dhe të kryetares së KVO, nuk e ka nënshkruar atë duke e bërë të pavlefshëm këtë akt.

4-Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion për procedurën e prokurimit me objekt “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2020 konstatohet:

Të dhëna mbi objektin

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sigurim I ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së”			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit “Kërkes për propozim” Urdhri nr 1332 datë 29.07.2020	2 Njësia e Prokurimit E. A. A. N. O.A.	3.1 KVO Urdhri nr 133 datë 29.07.2020 E. T. I.K. K. G.	3.2 KSHA
4. Fondi Limit 2,198,500 lekë	5. Oferta fituese 2,197,950 lekë	6. Diferenca me fondin limit 550 lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 16.08.2020	8. Burimi Financimit Të ardhurat e veta	9. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender Numër1 b) S’kualifikuar 0OE, c) Kualifikuar 1OE	
7/2 Kohe zgjatja 12 muaj			

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Pas marrjes së kërkesës për iniciimin e procedurës së prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” Titullari i AAC E. K. me shkresën nr. 1260 prot., datë 20.07.2020 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim I ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” të përbërë nga A. D., S. K. dhe E.K.

-Komisioni i ngritur me urdhrin nr. 1260 prot., datë 20.07.2020, ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC” dhe dërguar me shkresën nr. 1260/1 prot., datë 28.07.2020 me fond të përlllogaritur prej 2,198,500 lekë.

Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D. , S.K. dhe E. K. është 232,534 lek më i lartë kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi.

-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2020 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e përlllogaritjes së fondit nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.

Së dyti, AAC ka një kontrata të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë. Element që ngarkon me përgjegjësi Komisionin të përbërë nga A.D., S. K. dhe E.K.

-Veprimet e mësipërme kanë sjellë rritje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiarë për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = **233,350 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet**

dëmshpërblehet nga komisioni i përbërë nga A.D., S.K. dhe E.K. të cilët me veprimet dhe mos veprimet kanë sjellë rritje të pa justifikuar të fondit limit me pasoja financiare për institucionin.

5. Titulli i gjetjes:	Rritje të pa justifikuar të fondit limit.
Situata:	<p>Komisioni për llogaritjen e fondit limit ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC” prej 2,198,500 lekë.</p> <p>Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D., S. K. dhe E. K. është 232,534 lek më i lartë kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi.</p> <p>-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2019 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e fondit limit e llogaritur nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.</p> <p>Së dyti, AAC ka një kontrata të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë.</p> <p>-Veprimet e mësipërme kanë sjellë rritje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiarë për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = 233,350 lekë, vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet nga Komisioni i përbërë nga A. D. , S. K. dhe E. K. të cilët me veprimet dhe mos veprimet e tyre krijuan një fryrje të fondit limit me pasoja financiare për insitucionin.</p>
Kriteri:	<p>Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 pika b) VKM 914 datë29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 59 Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës 1. Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës bëhet nga njësia e prokurimit, nëse kjo detyrë nuk i është 35 ngarkuar një strukture të posaçme. 2. Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.); ose/dhe a) çmimet e tregut; ose/dhe b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe c) çmimet ndërkombëtare, të botuara. Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrit të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.</p>
Ndikimi:	Dëm ekonomik në vlerën 233,350 lekë.
Shkaku	Mungesa e vëmendjes dhe qartësisë në përlllogaritjen e fondit limit mos marrja në konsideratë e kontratës së mëparshme.

Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi 5.1:	AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiarë, teknik dhe juridik në përlllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike. AAC të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e shumës prej 233,350 lekë nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit.

-Në termat e referencës Komisioni i përbërë nga A.D., S. K. dhe E. K. ndër të tjera tek pika 3 Detyrimet e sipërmarrësit kërkohet: pika 6. **Rreziku i vjedhjes** apo dëmtimit të pasurive nga veprimet që vijnë si rezultat i së parës.

Për ruajtjen e objektit dhe zyrave të AAC, ky institucion ka një kontratë me kompaninë “I.” G. nr. 1219/1 datë 17.07.2020 ku në rregulloren nr. 1219/2 datë 17.07.2020, bashkangjitur kontratës është e mirë përcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi 24/7 pa ndërprerje.

Element i pa nevojshëm në policën e sigurimit duke **shtuar kostot për policë**, pasi për këtë element AAC ka një kontratë aktive për të cilën në çdo likuidim nga titullari i institucioni është nënshkruar procesverbali i performacës së ofruesit të shërbimeve, ku ç gjë paraqitet në rregull.

Me shkresën nr. 1332 prot., datë 29.07.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor, ka nxjerrë urdhrin e Prokurimit me fond limit me vlerë 2,198,500 lekë dhe njësi prokurimi E.A. , A.N. dhe O.A. .

Me shkresën nr. 1333 prot., datë 29.07.2020 Titullari i Autoritetit Kontraktor nga nxjerr urdhrin për krijimin e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të përbërë nga E.T. kryetar, I. K. dhe K. G. antarë.

-Me datë 30.07.2020 NJP ka mbajtur procesverbalin për hartimin e dokumenteve të tenderit Me procesverbalin e datës 03.08.2020 NJP ka njoftuar Operatorët ekonomik për pjesëmarrje:

I. S. SHA

E. SHA

I. SHA

A. SHA

S. U. G. A. SHA

b. Mbi vlerësimin e ofertave.

Me procesverbalin nr. 1409 prot., datë **17.08.2020** të KVO “Për shqyrtimin dhe vlerësimin ofertave ” , u konstatua se në procedurën e prokurimit ka marrë pjesë vetëm 1 OE me ofertat si më poshtë:

Nr.	Shoqëria	Oferta Lekë
1	“A.” SHA	2,197,950

Me shkresën nr. 1409/1 prot., datë 25.08.2020 KVO ka hartuar raportin përmbledhës të cilin nuk e ka miratuar tek titullari i AAC, veprim në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar nenet 68 dhe 69, dhe ngarkojnë me përgjegjësi Titullari i Autoritetit Kontraktor E. K.

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave nuk u konstatuan problematika.

Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit të Auditimit, nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresën nr. 1678/1 prot, datë 14.10.2021(protokoll AAC) për Projektraportin e Auditimit, nga Drejtori Ekzekutiv E. K. ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

Pretendime nga subjekti i audituar: Për procedurën e prokurimit “Sigurimi i Aseteve të AAC” dhe “Sigurimi i jetës së punonjësve të AAC” pretendon se:

Komisioni i ngritur me urdhërin e Titullari i Autoritetit Kontraktor nr. 1390, datë 15.07.2019 për hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit të kontratës “Sigurimi i ndertës dhe pajisjeve të AAC”, ka hartuar procesverbalin e hartimit të TOR dhe fondin limit, dokument ky me nr.1479 prot., datë 30.07.2019, pjesë e dosjes së prokurimit , të cilin e gjeni bashkëlidhur këtij observacioni.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, në asnjë rast nuk ka thënë që ky dokument nuk ekzistiont por; nuk ka ekzistuar në kohën që JU i keni bërë kërkesë kompanive të siguracionit “Kërkesat për ofertë dërguar me shkresat; nr.1404 prot datë 17.07.2019” ndër të tjera përmbajnë dhe termat e referencës, por për të cilat nuk është mbajtur asnjë dokument për hartimin e tyre.

Pra është mese e qartë që kërkesa për ofertë me TOR mban datën 17.07.2019 ndërsa dokumentacioni që mbështeteni JU mban datën 30.07.2019 pra pas dërgimit të kërkesës.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendime nga subjekti i audituar:

Për procedurën e prokurimit “Sigurimi i Aseteve të AAC” dhe “Sigurimi i jetës së punonjësve të AAC” pretendon se shtimi i kostove për sigurimin e asetëve të Subjektit nuk qëndron:

Për këtë konstatim të audituesit, sqaroj se kontrata e lidhur ndërmjet AAC dhe shoqërisë Il.Gua.me objekt ruajtjen dhe sigurinë fizike të AAC, në nenin 10 të saj , pika 1 , përcakton:

“Asnjë nga palët nuk do jetë përgjegjëse për ndonjë mos përmbushje ose vonesë të përmbushjes së detyrimit kontraktor që shkaktohet nga forcat madhore si katastrofat natyrore, tërmete, luftë, greva, trazira, kryengritje si dhe akte sabotimi ndalime dhe kufizime ligjore ose nxjerrje e akteve të cilat përbëjnë shkas për pengimin ose kufizimin e përmbushjes së të drejtave dhe detyrimeve që rrjedhin nga kjo kontratë në nivel të konsiderueshëm si de defekte teknike të rënda ose ndërprerje e përgjithshme e energjisë elektrike.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Grupi i auditimit, çmon se nëse JU, vlerësoni Vjedhje si Katastrofë Natyrore, mund të qëndroj si pretendim , por në asnjë rast apo rrethanë fizike apo juridike, vjedhja nuk klasifikohet e tillë, pa marrë në konsideratë rregulloren që i bashkëngjitet kontratës së rojeve ku është e mirë përcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi 24/7 pa ndërprerje.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

Pretendime nga subjekti i audituar:

Për procedurë e prokurimit “Sigurimi i Aseteve të AAC” pretendon se shtimi i kostove për sigurimin e asetëve të Subjektit nuk qëndron:

Ju sqarojmë se komisioni i ngritur me urdhër te Drejtorit Ekzekutiv Nr.275, date: 20.07.2020 për ngritjen e komisionit te posaçëm për hartimin e termave te referencës dhe përlllogaritjes se fondit limit për procedurën "Sigurimi i ndërtesës dhe pajisjeve te AAC", për te kryer përlllogaritjen e fondit ka ndjekur zbatimin e pikës 2 te nenit 59 "Përlllogaritja e vlerës limit te kontratës", te VKM. Nr. 914, date 29.12.2014 “Per miratimin e rregulla ve te prokurimit publik”, i ndryshuar: -Ne përlllogaritjen e vlerës limit te kontratës, autoriteti kontraktor duhet t'i referohet një ose me shume alternativave renditura si me poshtë: çmimet e botuara nga Instituti i Statistikave (INSTAT), ose/dhe çmime te tjera zyrtare, te njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, ne manuale etj);ose/dhe

a) çmimet e tregut; ose/dhe

b) çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vete apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe

ç) çmimet ndërkombëtare, të shpallura publikisht.

Llogaritja e fondit është bere bazuar ne piken a)- ne çmimet e tregut dhe e vërteton me kërkesat dhe përgjigjet e mara nga kompanitë e sigurimeve.

Qëndrimi i grupit të auditimit:

Procedura e prokurimit ka Ligjin, VKM dhe aktet nënligjore përkatëse. Në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, nën 1 pika b) e shpreh shumë mirë

b) të sigurojë mirë përdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;

Për sa i përket sa më sipër nga ana Juaj nuk është parë fare si me rëndësi përkundrazi Ju keni drejtuar tregut, Nëse nga ana Juaj do dështonte procedura për arsye çmimi atëherë ishte mëse e justifikuar dhe argumentuar përdorimi i kësaj metode për nxjerrjen e fondit limit.

Prandaj ky koment nuk merret në konsideratë dhe do të trajtohet në materialin e auditimit.

2.8. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit..

Në zbatim të pikës Nr.8, të programit të auditimit nr. 580/1 prot. datë 04.06.2021, mbi zbatimin e ligjshmërisë për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit Grupi i auditimit kërkoi dokumentacionin si më poshtë:

1. Rregulloren e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil.
2. Strukturën e Autoritetit të Aviacionit Civil të miratuar.
3. Urdhrat për miratimin e Nëpunësit Autorizues dhe Nëpunësit Zbatues.
4. Plan veprimi për 5 (pesë) vite.
5. Kod etik, Rregullore, Urdhër.
6. Urdhër delegimi kompetence.
7. Programe trajnimi të miratuara.
8. Trajnimet për Riskun dhe Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin.
9. Dosjet e punonjësve, Vlerësimet Vjetore.
10. Strategjinë e Riskut.
11. Regjistrat e riskut për periudhën objekt auditimi.
12. Urdhër për ngritjen e Grupit të Menaxhimit Strategjik.
13. Hartimin dhe miratimin e Gjurmës të Auditit.
14. Procedurat Anti-korrupsion.
15. Deklaratën e Cilësisë dhe Raportin.
16. Pyetësorin e Vlerësimit për 5 (pesë) fushat e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.
17. Deklarata e misionit dhe vizionit.

Autoriteti i Aviacionit Civil është person juridik publik, jobuxhetor, me seli në Tiranë në varësi të ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, i cili funksionon në bazë të Ligjit nr.10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” i ndryshuar, dhe Ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodin Ajror të Republikës të Shqipërisë” i ndryshuar. Menaxhimi financiar dhe kontrolli është një sistem politikash, procedurash, veprimtarish dhe kontrollesh, të cilat duhet të vendosen, ruhen dhe përditësohen rregullisht nga titullari i njësisë publike dhe vihen në zbatim nga i gjithë personeli, me qëllim për të adresuar risqet e për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njësisë publike do të arrihen nëpërmjet veprimtarive efektive, efçente dhe me

ekonomi, pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat, informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota dhe mbrojtjes së informacionit e të aktiveve. Në drejtim të vlerësimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në Autoritetin e Aviacionit Civil, nga grupi i auditimit janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizmit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij për të gjithë komponentët: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi dhe komunikimi, si dhe monitorimi, në zbatim të ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollit.

Në zbatim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, Grupi i auditimit ka kryer një Pyetësor në funksion të realizimit të pesë fushave të kontrollit në të cilat funksionon menaxhimi financiar. Mbi bazën e përgjigjeve dhe dokumenteve të vendosura në dispozicion u konstatua se:

1.1 Mjedisi i kontrollit.

Në zbatim të nenit 8, pika 4, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, Nëpunësi Autorizues është E. K. Drejtor Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil. Me shkresën nr. 2243 prot., Urdhrin nr. 613, datë 13.12.2019 A. P., Drejtor i Drejtorisë Së Shërbimeve të Përgjithshme është caktuar Nëpunës Zbatues i Autoritetit të Aviacionit Civil sipas kritereve të përcaktuara në këtë ligj.

Prej djetorit të vitit 2019 deri në ermërimin e. A.P. Nëpunës Zbatues, këtë detyrë e ka mbuluar E.D. .

Etika personale dhe profesionale:

Autoriteti i Aviacionit Civil bazohet mbi një Kod të Brendshëm Etik të përcaktuar në rregulloren e brendshme e cila monitoron pajtueshmërinë e punonjësve me legjislacionin për etikën personale dhe profesionale. Me shkresën nr. 48 prot., datë 08.01.2018 Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil lëshon urdhrin nr. 10, datë 08.01.2018 për disiplinën në punë. Me shkresën nr. 992/4 prot., datë 14.06.2019 Drejtori Ekzekutiv miraton Rregulloren “Për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve nga përdorimi i produkteve të duhanit në AAC”. Për çdo shkelje për disiplinën në Drejtori Ekzekutiv sinjalizohet nga Drejtorja e Burimeve Njerëzore.

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit:

Punonjësit e Autoritetit të Aviacionit Civil i rregullojnë marrëdhëniet e punës me punëdhënësin në bazë të ligjit mbi nëpunësin civil. Titullari i institucionit, në rast të shkeljes së normave ligjore apo të rregullave ka të drejtë të ndërmarrë hapat e duhura duke propozuar masa disiplinore dhe administrative për punonjësit. Në rregulloren e brendshme nuk janë të përcaktuara kriteret dhe rregullat e delegimit. Delegimi i kompetencave nga Delegimi i detyrave dhe përgjegjësive si dhe dokumentimi i tyre dokumentohet dhe protokollohen në formën e urdhrave të brendshëm.

Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:

Rregullorja e brendshme e Autoritetit të Aviacionit Civil është e përditësuar me Vendim nr.5, datë 13.06.2019. Nga përzgjedhja e rastësore e disa dosjeve të disa punonjësve u konstatua se institucioni ka bërë vlerësimet vjetore të punës për këta punonjës, i cili është bashkëlidhur dosjeve personale të punonjësve. Gjatë periudhës objekt auditimi janë trajnuar punonjësit për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, me tematika të ndryshme në funksion të pozicioneve të punës. Autoriteti i Aviacionit Civil për periudhën objekt auditimi ka hartuar programe specifike për trajnimin të cilat janë të miratuara nga Drejtori Ekzekutiv, si dhe të arkivuara.

Trajnimet mbi riskun janë shumë të pakta. Përsa i përket punonjësve të Autoritetit të Aviacionit Civil por në veçanti punonjësve të Sektorit të Financës dhe Buxhetit nuk janë trajnuar mbi legjislacionin e menaxhimit financiar dhe kontrollit veprime këto në mos përmbushje të kërkesave të Kapitullit III, 3.1 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin ku përcaktohet:

Mjedisi i kontrollit (ose mjedisi i brendshëm i njësisë” paragrafët “Politikat dhe praktikat që lidhen me burimet njerëzore” dhe “Profesionalizmi i stafit”. Punonjësit nuk kanë njohuri për funksionimin e këtij sistemi, si dhe për plotësimin, mbajtjen dhe ruajtjen e dokumentacionit;

Për vitin 2019 është miratuar Rregullorja për Rregullat e Brendshme të Autoritetit të Aviacionit Civil. Rregullat e etikës në institucion janë përcaktuar në Kapitullin VIII, nenet 31-36 të kësaj Rregulloreje.

Në kuadër të rritjes së efikasitetit dhe disiplinës në punë është nxjerrë urdhri nr. 10, datë 08.01.2018 “Për disiplinën në punë”.

Gjithashtu, ekziston edhe Rregullorja nr. 992/4 prot., datë 14.06.2019 “Për mbrojtjen e shëndetit të punëmarrësve nga përdorimi i produkteve të duhanit në autoritetin e Aviacionit Civil Shqiptar”.

1.2 Menaxhimit i Riskut.

Menaxhimi i riskut është procesi i identifikimit, vlerësimit dhe monitorimit të riskut. Titullari i njësisë publike është përgjegjës për hartimin e politikave, miratimin dhe monitorimin e strategjisë për menaxhimin e risqeve brenda njësisë së tij.

Strategjia e riskut përcakton mënyrën se si duhet të silltet Autoriteti i Aviacionit Civil ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. AAC-ja nuk ka hartuar Strategjinë e Riskut dhe për pasojë drejtuesit nuk janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që kanë në menaxhimin e riskut. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut, veprime këto në kundërshtim të Kreut III, neni 21, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, ku përcaktohet:

Për t'i zbatuar veprimtaritë e parashtruara në pikën 1 të këtij neni, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi Autorizues analizon dhe përditëson kontrollin që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit;

Drejtori Ekzekutiv i Autoritetit të Aviacionit Civil ka nxjerrë Vendimin nr. 6, datë 07.06.2019 “Për miratimin e dokumenteve të Sistemit të Menaxhimit të Cilësisë”, sipas sistemit ISO 9001:2015, pjesë përbërëse e tij është dhe Grupi i Rishikimit të Cilësisë ku për vitin 2019 ka zhvilluar dhe dy mbledhje. Nga AAC-ja pretendohet se ky grup është i barasvlershëm si dhe kryhen të njëjtat funksione me Grupin e Menaxhimit Strategjik.

Identifikimi i risqeve është përgjegjësi e çdo drejtori drejtorie për risqe që afektojnë veprimtarinë e tyre. Masa parandaluese dhe mitiguese duhet të ndërmerren për risqe që i adresohen atyre.

Funksionet e Grupit të Menaxhimit Strategjik (në vazhdimësi GMS).

(GMS) luan një rol kyç përsa i takon integritetit të informacionit financiar të njësisë publike, si dhe sistemit të kontrollit të brendshëm. Zhvillimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit kërkon gjithashtu zhvillimin e menaxhimit të riskut në mënyrë sistematike duke krijuar një mjedis të tillë në të cilin diskutimet për riskun të jenë pjesë e operacioneve të përditshme. Vendimet e (GMS) duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive duke patur në vëmendje interesin publik, vendimet të cilat duhet të pasqyrohen në dokumente dhe t’i vendosen në dispozicion menaxhimit

të njësisë. (GMS) duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

(GMS) duhet të nxisë realizimin e objektivave dhe qëllimet strategjike të njësisë, të garantojë se brenda njësisë ekziston një kuadër i përshtatshëm dhe efektiv i MFK-së, ku siguron vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve, realizimin e objektivave të MFK-së, rishikimin e procesit të menaxhimit të riskut, garantimin se punonjësit janë të pajisur me aftësitë dhe udhëzimet e nevojshme për të vënë në zbatim kontrole të brendshme efektive dhe për të menaxhuar risqet, të shqyrtojë nëse mjedisi i kontrollit dhe procedurat mund t'i përmbushin objektivat e tyre, përcaktimin nëse janë raportuar dobësi materiale, rishikimin e përmirësimeve të sugjeruara për MFK-në si dhe ndjekjen në vazhdimësi të korrigjimeve të dobësive në kontrollin e brendshëm, verifikimin e deklaratën e titullarit mbi sistemin e kontrollit të brendshëm.

Një (GMS) efektive duhet të ketë linja të hapura komunikimi me të gjitha nivelet e njësisë publike si dhe me auditin e brendshëm. Grupi duhet të sigurojë marrjen në kohën dhe formën e duhur të informacioneve cilësore, të cilat i mundësojnë atij kryerjen e detyrave në raport me të gjitha aktivitetet e njësisë. Lloji i informacionit lidhet me natyrën e aktiviteteve dhe objektivat e njësisë, por duhet të përmbajë të dhëna për:

Raportimin mujor mbi kontabilitetin dhe menaxhimin, i cili i referohet përdorimit mujor të burimeve njerëzore dhe financiare si dhe raportet periodike të përpiluara gjatë vitit që përmbajnë parashikime mbi të ardhurat dhe shpenzimet përkundrejt buxhetit financiar të të ardhurave, burimeve dhe shpenzimeve kapitale, progresin lidhur me realizimin e synimeve dhe objektivave, identifikimin dhe menaxhimin e risqeve.

Theksojmë se Autoriteti i Aviacionit Civil nuk është i pajisur me Certifikatën ISO 9001:2015.

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion konstatohet se:

-Për periudhën objekt auditimi nuk është ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik të riskut, i cili duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, si dhe të përgatisë raportin vjetorë mbi problematikat e hasura, veprime këto në mos kundërshtim të Kreut II, neni 8, "Titullarët e njësisë publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore" pika b, si dhe Kreu III, neni 27, pika 2 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, ku përcaktohet:

Pika b) Ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike;

Pika 2) Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë;

Në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit", si dhe Udhëzimin nr.16, datë 20.07.2016 "Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinorit të riskut në njësitë publike" pika 2.2.4. ku përcaktohet:

Grupi i menaxhimit Strategjik duhet të kontrollojë si janë menaxhuar risqet brenda njësisë publike, dhe duhet të mblidhet të paktën 4 herë në vit, ku këto takime duhet të regjistrohen nga sekretari dhe të vihen në dispozicion të drejtimin të njësisë publike gjë e cila nuk është e faktuar;

Për periudhën objekt auditimi nuk janë kryer takime me stafin menaxherial mbi çështjet e menaxhimit të riskut, diskutimin e problematikave dhe dokumentimin e veprimtarisë së përditshme të menaxhimit të riskut, si dhe nuk është rishqyrtuar vlerësimi i riskut, të cilat duhet

të ishin reflektuar në raportin vjetor, i cili duhet të ishte përgatitur nga Grupi i Menaxhimit Strategjik.. Mos përgatitja e këtij raporti nga Grupi i Menaxhimit Strategjik ka ndikuar në mos monitorimin dhe raportimin mbi gjendjen e riskut, pra s'ka asnjë informacion nëse aktivitetet e kontrollit kanë minimizuar risqet dhe nëse në objektivat e planifikuara për tu realizuar janë rrezikuar nga këto risqe. Nuk është evidentuar nëse risqet janë duke u rritur ose zvogëluar, me qëllim marrjen e vendimeve nga ana e menaxhimit për reagimin e duhur ndaj riskut. Kjo ndikon dhe në mungesën e transparencës dhe llogaridhënies për aktivitetet e njësisë.

Janë organizuar mbledhje të Rishikimit të Menaxhimit ku kanë marrë pjesë të gjithë drejtuesit e njësisë dhe janë trajtuar çështje të ndryshme të lidhura me arritjen e objektivave, risqet ekzistente dhe masat e marra për mitigimin e tyre.

Funksionet të cilat kryhen Grupi i Rishikimit të Cilësisë nuk janë të njëjta me ato të Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Koordinatori i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit dhe Koordinatori i Riskut sipas përcaktimit ligjor të menaxhimit financiar dhe kontrollit, është Nëpunësi Autorizues. Funksionin e Koordinatorit të Riskut për periudhën objekt auditimi e mbulon Sektori i Kontrollit të Cilësisë, sektor i cili është në varësi të tij.

-Për vitin 2018 konstatojmë se nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale, për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontroleve të risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive. Pra, nuk ekziston një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve, ku të adresohen personat përgjegjës për çdo risk, veprime këto në kundërshtim të kërkesave të Kreut III të Manualit, "Identifikimi i risqeve", Kreu II, neni 11, pika 2, 3, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, ku përcaktohet:

Pika 2. Identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë;

Pika 3. Garantimin e funksionimit të sistemit të menaxhimit financiar dhe të kontrollit në strukturat që ata drejtojnë, bazuar në rregullat e vendosura nga titullari i njësisë publike, si dhe i raportojnë nëpunësit autorizues përkatës për çdo dobësi të sistemit që duhet trajtuar;

Si dhe neni 9 "Përgjegjshmëria menaxheriale e nëpunësit autorizues" pika c, neni 10 "Përgjegjshmëria menaxheriale e koordinatorit të riskut" pika 2 gërmat a, b, c të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit" i ndryshuar, ku përcaktohet:

c) Monitorimin e kontroleve të risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë që menaxhojnë;

2. a) Bashkërendimin e veprimtarive që lidhen me identifikimin dhe vlerësimin e risqeve, që vënë në rrezik arritjen e objektivave të njësisë dhe ngritjen e sistemit për menaxhimin e riskut, në përpjesëtim me përmasat e tij;

b) Këshillimin dhe dhënien e instruksioneve menaxherëve të tjerë të njësisë publike, në bashkëpunim me njësinë qendrore të harmonizimit, për menaxhimin financiar dhe kontrollin;

c) Paraqitjen e raportit të përgjithshëm të risqeve të njësisë publike tek titullari i njësisë publike dhe grupi i menaxhimit strategjik të njësisë publike;

Për vitin 2019-2020 konstatohet se ka një regjistër risku ku janë të hedhura risqe që janë adresuar nga drejtoritë përkatëse të AAC-së ku është bërë dhe vlerësimi i tyre sipas procedurës për menaxhimin e riskut. *I vetmi risk i hasur, mangësia e burimeve njerëzore.*

Në këtë Regjistër Risku nuk janë të evidentuara objektivat, risku para kontrollit, risqet pas kontrollove, nevojat për kontrole të mëtejshme, veprime për të autorizuar këto boshllëqe, zotëruesi i riskut, ndryshimet në risk që nga detyra e fundit *jo sipas standartit të menaxhimit financiar dhe kontrollit*, veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, dhe pikës 3.2.2 Nëpunësi Autorizues/Koordinatori i Riskut, të Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike ku përcaktohet:

Bashkërendimin e aktiviteteve në lidhje me menaxhimin e risqeve (Krijimin e regjistrit të riskut të institucionit);

Si dhe veprime këto në kundërshtim të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, si dhe të kërkesave të pikës 5.4.1. Roli i strukturës përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, sipas Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” ku përcaktohet:

Struktura përgjegjëse për harmonizimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit ndihmon Koordinatorin e Riskut dhe Koordinatorin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, të çdo njësie publike për:

-Zhvillimin dhe dhënien e instrumenteve standarte dhe tabelave referuese sipas menaxhimit financiar dhe kontrollit (Model regjistri të risqeve, të plan veprimit ndaj riskut, plan kontrollit, etj., Aneksi 2. Regjistri dhe matricat e riskut);

1.3 Aktivitetet e kontrollit.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Në vendosjen e aktiviteteve të kontrollit, titullarët e njësisë duhet të marrin parasysh përfitimin që pritët prej tyre, si dhe kostot për futjen dhe zbatimin e tyre. Aktivitetet e kontrollit duhet të integrohen tek proceset dhe sistemet, në momentin që këto procese dhe sisteme krijohen. Futja e aktiviteteve të kontrollit në një fazë të mëvonshme është më e kushtueshme dhe më pak efikase. Në lidhje me aktivitetet e kontrollit, është e rëndësishme një ndarje e përshtatshme e detyrave, në mënyrë që i njëjti person/strukturë të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që lidhen me: miratimin, zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve, vendosja e rregullave të brendshme mbi kontrollin para faktit ose paraprak të ligjshmërisë, veprime të përshtatshme kontrolli për sistemet e TI-së, etj. Të dhënat personale (dosjet personale të punonjësve) administrohen nga Sektori i Burimeve Njerëzore dhe është në detyrat funksionale të stafit të këtij sektori dhe në përgjegjësi të tyre, ruajtja nga përdorimi i pa autorizuar. Materialet e Arshivës ruhen nga përdorimi i pa autorizuar në zbatim të dispozitave ligjore të Arkivave. Procedurat e punës për çdo sektor janë të shkruara në manualet përkatëse të punës. Angazhimet financiare nënshkruhen nga Nëpunësi Autorizues dhe Nëpunësi Zbatues i institucionit. Për çdo rast zbatohet sistemi i firmës së dyfishtë.

Sipas Udhëzimit nr.16, datë 20.07.2016 “Përgjegjësitë dhe detyrat e Koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të riskut në njësitë publike” ku përcaktohet:

Nëpunësi Autorizues i njësisë publike është përgjegjës për zbatimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, struktura, programet, aktivitetet dhe proceset e drejtuara prej tij në përputhje me parimet e ligjshmërisë, menaxhimit të shëndoshë financiar dhe transparencës. Nëpunësi Autorizues duhet të sigurojë që do të ndiqet qasja e përgjithshme e rekomanduar për ngritjen, vlerësimin dhe përmirësimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit, duhet të përfshijë hapat kryesorë të vlerësuara të rëndësishme për një sistem të shëndoshë të menaxhimit financiar dhe kontrollit:

Përgatitja e Gjurmës së auditit për proceset kryesore të punës;

Gjurma e auditit, përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare, prokurimeve dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të përshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Nga auditimi rezulton se Titullari i Autoritetit të Aviacionit Civil nuk ka nxjerrë ndonjë urdhër për të hartuar gjurmën e auditit, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, veprime këto në mos përmbushje të kërkesave të nenit 16, pika 2 dhe 3 të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, dhe të detyrimeve të Kapitullit III, të “Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” miratuar nga Ministri i Financave me Urdhrin nr. 54, datë 15.07.2010, ku përcaktohet:

Pika 2) Titullarët e njësisë publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit;

Pika 3) Gjurma e auditit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi;

Gjurmëve të auditit duhet të përfshijë të paktën proceset kryesore që kontribuojnë në arritjen e objektivave të njësisë dhe që përfshijnë zbatimin e aktiviteteve, programeve dhe projekteve më të rëndësishme të saj. Gjurma e auditit duhet të rifreskohet në mënyrë të vazhdueshme, për të garantuar pasqyrimin e ecurisë së aktiviteteve dhe dokumenteve që përmban një proces. Procedurat antikorrupsion Titullarët e njësisë kanë përgjegjësi për vendosjen e rregullave dhe procedurave për njoftimin, shqyrtimin, zbulimin dhe raportimin e dobësive administrative, mospërputhjeve dhe shkeljeve, që krijojnë terren për korrupsion, mashtrime, apo parregullsi.

Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka procedura të përcaktuara të brendshme anti –korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive veprime këto në kundërshtim të kërkesave të Kreut II neni 8, pika 8 dhe neni 17 si dhe Aneksi 10 Mashtrimi dhe korrupsioni, të Ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për organizimin dhe funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit” i ndryshuar, ku përcaktohet:

1. Çdo punonjës, i cili gjatë kryerjes së punës apo në lidhje me zhvillimin e detyrave të tij, vëren fakte, të cilat lënë vend për mundësi të ekzistencës së parregullsive dhe mashtrimeve, informon menjëherë me shkrim eprorin e drejtpërdrejtë ose eprorin e një niveli më të lartë, apo, nëse ai e sheh të dobishme, njofton nëpunësin autorizues ose titullarin e njësisë publike ose direkt nëpunësin e parë autorizues apo njësinë e antikorrupsionit;

1.4 Monitorimi dhe verifikimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë, sipas qëllimit për të cilin janë krijuar dhe mbeten efikente me kalimin e kohës. Monitorimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, bëhet për të vlerësuar cilësinë e sistemit dhe të performancës në kohë. Vlerësimi dhe monitorimi

i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit duhet të bëhet nëpërmjet: Monitorimit të vazhdueshëm, Vetëvlerësimit, Auditit të brendshëm.

Në rregulloren e re të miratuar Autoriteti i Aviacionit Civil rezulton se nuk disponon Audit të Brendshëm. AAC-ja auditohet nga Audit i brendshëm pjesë e strukturës së brendshme të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë.

Vlerësimi i vazhdueshëm i sistemit të kontrollit të brendshëm dhe komponentëve të tij duhet të jetë detyrë e titullarit të njësisë, nëpunësit autorizues dhe menaxherëve të tjerë. Ky vlerësim mund të kryhet ose nëpërmjet monitorimit të vazhdueshëm të komponentëve të sistemit të kontrollit ose nëpërmjet mekanizmave individuale të kontrollit dhe zbatimit të tyre gjatë punës së përditshme, të cilat kanë munguar gjatë periudhës objekt auditimi.

Në përputhje me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.28, datë 15.12.2011 është dërguar me shkresën nr.403/1 prot., datë 28.02.2019 Deklaratë për Cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm të Autoritetit të Aviacionit Civil për vitin 2018 si dhe bashkëlidhur ndodhet Raporti Vjetor për funksionimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, duke respektuar afatet kohore si dhe në zbatim me urdhrin e Ministrit të Financave nr. 8980, datë 15.07.2010, Kapitulli V “Shtojca 2” është përgatitur dhe dërguar pyetëtori i Vetëvlerësimit në funksion të realizimit të pesë fushave të kontrollit në të cilat funksionon menaxhimi financiar dhe kontrolli. Në pyetëSORIN e Vetëvlerësimit, Autoriteti i Aviacionit Civil nuk ka dhënë vlerësimin nga lderi 4 sipas përcaktimit në Manualin e menaxhimit financiar dhe kontrollit sipas *Aneksi 6- PyetëSORI i vetëvlerësimit për komponentët e menaxhimit financiar dhe kontrollit së njësi publike.*

Nga dokumentacioni i vendosur në dispozicion vlerësojmë se frekuenca dhe mënyra e raportimit apo monitorimit duhen të përmirësohen, si dhe raportet e monitoruese të performancës në funksion të arritjes së objektivave.

1.5 Informimi dhe komunikimi.

Monitorimi është tërësia e proceseve të rishikimit të aktivitetit të njësisë, i cili synon të ofrojë garanci të arsyeshme se aktivitetet e kontrollit funksionojnë sipas qëllimit për të cilin janë ngritur. Nga auditimi rezultoi në Autoritetit i Aviacionit Civil, ka një procedurë të shkruar për mënyrën e komunikimit brenda institucionit dhe procedurat për qarkullimin e informacionit, e cila është pjesë e Rregullores së Brendshme e miratuar me Vendimin nr.5, datë 13.06.2019, në mbështetje të Kapitullit IV, “Komunikimi i brendshëm dhe i jashtëm” është e evidentuar mënyra e komunikimit brenda institucionit, llogaritë e email-it që mirëmbahen në sistemin elektronik janë pronë e AAC-së, çdo punonjës ka akses elektronik. AAC-ja është përfitues i shërbimeve të AKSH-T i cili ofron backup për këto shërbime dhe sisteme, si llogaritë elektronike, faqja zyrtare internet, shërbime interneti, aplikacione dhe sisteme të ndryshme. Në lidhje me komunikimin me organizatat e huaja në të cilat aderon, është krijuar Sektori i të Drejtave të Pasagjerëve pranë Aeroportit për të asistuar pasagjerët për çdo rast vonese të linjave ajrore. Sistemi i IT nëpërmjet AKSHI- është përfitues i shërbimeve për sistemet Microsoft Projekt i cili është një softuerë online i aksesueshëm nga të gjithë punonjësit që kanë një llogari zyrtare të aksesit, i cili është i programuar për të ndihmuar menaxherët/drejtuesit për të patur nën kontroll jo vetëm afatet kohore të realizimit të një plani pune, por dhe burimet njerëzore në detyrat e caktuara, matjen e kohës së punës, menaxhimine buxhetit, realizimin-tejkalimin te afatave, për monitorimin e progresit. Titullari informohet vazhdimisht nga Shefat e Shërbimeve dhe Përgjegjësit e Sektorëve mbi aktivitetin e strukturave që ata drejtojnë me anë të takimeve ditore apo javore, informacioneve apo, raporteve të ndryshme dhe merr opinione prej tyre gjatë përgatitjes së planeve të punës por pa bazë dokumentare. Drejtuesit nën mbikëqyrjen e Titullarit raportojnë

realizimin e çdo objekti nën përgjegjësinë e gjithsecilit. Menaxherët dhe punonjësit e njësisë, duke mos pasur njohuritë e duhura për ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin, nuk mund të bëjnë siç duhet vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Si konkluzion nga sa më lartë kostatohet, menaxhimi financiar dhe kontrolli nuk ka funksionuar në nivele të duhura, ligji i cili është kuptuar pjesërisht dhe nuk ka funksionuar në pjesët e sistemit të drejtimit të AAC-së, për pasojë titullari nuk ka bërë vlerësimin e efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

2.9. Auditimi i Brendshëm

-Në zbatim të pikës 9 të Programit të Auditimit nr. 580/1 prot. datë 04.06.2021 “ Auditimi i Brendshëm” ,

Për sa i përket “Organizimi dhe funksionimin njësisë së auditit të brendshëm, kapacitetet audituese që mbulojnë këtë aktivitet, Planifikimi, realizimi i programit të auditimit dhe analiza sipas llojeve dhe gjetjeve. Rezultatet dhe efica e strukturave të ngritura për realizimin e auditit të brendshëm. Ndjekja e zbatimit të masave të rekomanduara nga drejtimi”.

Organizimi i sektorit të AB në AAC

Njësia e Auditimit të Brendshëm të “AAC” Tiranë, nuk ekziston pasi ky institucion nuk e plotëson numrin minimal të punonjësve për krijimin e kësaj strukture. AAC auditohet nga ministria e linjës, institucionet e pavarura si KLSH dhe kompanitë e auditit për pasqyrat financiare.

Veprimtaria e NJAB në AAC për periudhën objekt auditimi

Nuk ka veprimtari pasi nuk është krijuar, pasi nuk plotësohet numri minimal i stafit.

IV. GJETJET DHE REKOMANDIMET

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Autoriteti Aviacionit Civil nuk ka zbatuar plotësisht rekomandimet e lëna në auditimin e mëparshëm nga KLSH.

-Autoriteti Aviacionit Civil, nuk ka respektuar afatet 20 ditore dhe 6-mujor, të kthimit të përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, veprime në kundërshtim me nenet 15 germa “j” dhe 30 pika 2, të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”. Nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, konstatohet se niveli i pranimeve dhe zbatimit të rekomandimeve është si më poshtë:

-Nga 28 masa organizative gjithsej, të rekomanduara, 11 janë zbatuar plotësisht, 13 nuk janë pranuar, 1 është në proces dhe 3 janë zbatuar pjesërisht.

-Nga 2 masa për shpërblim dëmi të rekomanduara, nuk është pranuar asnjë prej tyre. -Nga 4 masa dëm potencialisht i mundshëm gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 1 është zbatuar.

-Nga 8 masa për eliminimin e efekteve negative gjithsej, 3 masa nuk janë pranuar dhe 5 janë zbatuar.

-Nga 2 masa për eliminimin e procedurave jo ligjore gjithsej, 2 masa janë zbatuar.

-Nga 7 masa sugjerime gjithsej, nuk është pranuar asnjë prej tyre.

-Nga 2 masa disiplinore, nuk është pranuar asnjë prej tyre.

-Niveli i pranimet dhe zbatimit të rekomandimeve paraqitet në nivele të ulta, rreth 36%.

-Drejtorja e AAC nuk ka marrë në konsideratë 64% të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

-Nuk janë respektuar afatet e kthimit të përgjigjes mbi rekomandimet e lëna nga KLSH sipas përcaktimeve ligjore.

-Rekomandimet e KLSH-së, dërguar me shkresën nr.1312/24, datë 02.05.2019, rezultojnë të zbatuara në nivelin 53%. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 13-45, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa për zbatimin dhe realizimin e plotë të rekomandimeve të dhëna nga auditimet e mëparshme të KLSH-së, të cilat kanë rezultuar të pazbatuara ose në proces, si edhe të ndiqen në të gjitha shkallët e gjykimit, ato që janë në procese gjyqësore.

Menjëherë dhe Në vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Me urdhrin nr. 152, datë 24.03.2021, është ngritur nga titullari AAC komisioni për hartimin e termave të referencës dhe përlllogaritjes së fondit limit për procedurën “Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”. Procedura për fillimin e procedurës nga urdhri i prokurimit, ftesat/ofertë, argumentimi i kriterëve, hartimi i termave të referencës, datojnë më 24.03.2021, pra brenda 1 dite pa u konsumuar edhe afati 3 ditor i përcaktuar në urdhrin e prokurimit nga Titullari. Kjo procedurë është kryer në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 10.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Kreu II, pika 1 dhe VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 40, pasi nuk mund të kryhej nga AAC, por nga vetë Ministria, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Ministria duhet të zhvillonte procedurën dhe të mbulonte koston e procedurës së shërbimit “Asistencë për hartimin dhe negocimin e termave të kontratës koncensionare të Aeroportit të Vlorës”, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor. Mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre e kthen AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve, për më tepër në vitin ku AAC ka rezultuar me humbje. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Drejtorja e Shërbimeve të Përgjithshme të marrin masa që në të ardhmen të analizojnë kërkesat e ardhura nga MIE (për prokurime) dhe në çdo rast të përmbushen vetëm nëse ato janë në interes të AAC, si edhe në përputhje me ligjet dhe rregullat në fuqi të përcaktuara për çdo Autoritet Kontraktor, me qëllim që mbulimi i shpenzimeve të kësaj natyre të mos kthej AAC në rolin e financuesit duke sjellë rritje të shpenzimeve.

Menjëherë dhe në vijimësi

3. Gjetje nga auditimi: Miratimi i strukturës organizative vetëm me Vendimin e Këshillit drejtues, pa miratimin e Ministrit të linjës. Konkretisht struktura organizative është miratuar vetëm me Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 8, datë 28.06.2019 dhe Vendimin e Këshillit Drejtues nr. 9, datë 28.06.2019, ndërsa struktura organizative e vitit 2021 është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 359, datë 18.12.2020, protokolluar në AAC me nr. 2118, datë 28.12.2020. Në strukturën e vitit 2019 dhe 2020 janë miratuar 73 të punësuar, por organika është shtuar dhe me 4 punonjës me kontratë me Vendim të Këshillit Drejtues, struktura nuk është miratuar nga Ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, të cilët janë përfshirë në strukturën e vitit 2021. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*

3.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të marrin masa që në të ardhmen, ndryshimet e strukturës së institucionit, të hyjnë në fuqi vetëm pas miratimit nga Ministri.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga ana e AAC për periudhën 01.10.2019-01.04.2021, është vepruar në kundërshtim me VKM Nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, pasi përshkrimi dhe klasifikimi i pozicioneve të punës është miratuar vetëm me miratimin e Këshillit Drejtues dhe jo nga Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe nga DAP. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1 Rekomandimi: Për shkeljen e konstatuar në përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës për periudhën e auditimit, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2021, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi. AAC nuk ka arritur të arkëtojë vlerën 1,935,032 lekë nga ish-drejtuesit që janë larguar nga institucioni. Kjo vlerë ka të bëjë pajisjet informatike që kanë pasur në ngarkim për shkak të detyrës që ato kanë ushtruar, të cilët nuk i kanë dorëzuar. AAC nuk duhet të kishte dhënë librezat e punës pa dorëzuar inventarin në ngarkim dhe detyrimet e tjera financiare. Por është mjaftuar vetëm me njoftimet që u ka bërë personave me përgjegjësi materiale dhe nuk ka ndërmarrë asnjë hap ligjor. Konkretisht referuar urdhrin të brendshëm nr. 285, datë 06.06.2019 të ish-Drejtorit Ekzekutiv të AAC K. K. janë njoftuar me shkresën nr. 1119/1 A. L. me detyrë ish-Drejtor Ekzekutiv, me shkresën nr.1119/2 A. C. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues, me shkresën nr. 1119/3 A.A. me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues, me shkresën nr. 1119/4 F.G. me detyrë ish-drejtor i departamenti ekonomik dhe me shkresën nr. 1119/4 Ilir Hebovia me detyrë ish-anëtar i Këshillit Drejtues.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6 faqe 86-98 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv i AAC, të marrë masa të menjëhershme për ndërmarrjen e të gjithë hapave ligjor për arkëtimin e detyrimeve që kanë ndaj Institucionit.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” me fond limit 3,999,670 lekë, viti 2019, Titullari i AAC K.K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanos stafin e këtij institucion; Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe Ligjin i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma; a) një përshkrim të shkurtër të mallrave,punëve ose shërbimeve, që do të prokurohen, ose të nevojës për prokurim, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1 Rekomandimi: AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Në vijimësi

7. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” me fond limit 3,995,553 lekë, viti 2020, Titullari i AAC E. K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “ Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanoset stafin e këtij institucion; Veprime në kundërshtim me Ligjin nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë” dhe Ligjin i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma, a) një përshtkrim të shkurtër të mallrave,punëve ose shërbimeve,që do të prokurohen, **ose të nevojës për prokurim**, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1 Rekomandimi: AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

8. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC/0-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2019, Titullari i AAC K.K. ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit për procedurën “Sigurim i jetës dhe shëndetit të punonjësve të AAC-së”, pa marrë më parë kërkesë nga drejtoria apo sektori përkatës për nevojën e kryerjes së procedurës. Gjithashtu kryerja e një procedure të tillë “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” nga dokumentacioni i vënë në pozicion dhe i gjendur në dosjen e procedurës së prokurimit nuk ka asnjë relacion shpjegues, sqarues dhe argumentues për domosdoshmërinë e kësaj procedure dhe riskun e kalkuluar që i kanoset asetet e këtij institucioni, veprime në kundërshtim me Ligjin i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 12, pika 2, gërma, a) një përshtkrim të shkurtër të mallrave, punëve ose shërbimeve,q ë do të prokurohen, **ose të nevojës për prokurim**, për të cilën autoriteti kontraktor ka vendosur nisjen e procedurës. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1 Rekomandimi: AAC, në çdo rast përpara fillimit të procedurave të prokurimit, duhet të ketë të administruar kërkesat e dërguara nga sektorët apo drejtorit përkatëse, duke argumentuar nevojën e kryerjes së shpenzimit apo investimit, domosdoshmërinë e tij dhe nevojën që institucioni ka.

Menjëherë dhe në vijimësi

9. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2019, Komisioni për përlllogaritjen e fondit limit ka dërguar kërkesat për ofertë kompanive që ofrojnë shërbim në sektorin përkatës duke ju referuar “Raportit financiarë të Audituesve të pavaruar” për sa i përket vlerës së aseteve që do sigurohen. Në termat e referencës Komisioni kërkon dhe: mbulim nga: **Rreziku i vjedhjes** apo dëmtimit të pasurive nga veprimet që vijnë si rezultat i së parës. Për ruajtjen e objektit dhe zyrave të AAC, ky institucion ka një kontratë me kompaninë “I. G.” ku në rregulloren bashkangjitur kontratës është e mirëpërcaktuar detyrat e këtij shërbimi duke ofruar ruajtje fizike dhe me sistem vëzhgimi

24/7 pa ndërprerje. Ky element i kërkuar të mbulohet nga polica e sigurimit është i pa nevojshëm duke dubluar shpenzimet për këtë pjesë dhe **shtuar kostot për policë**, veprime në kundërshtim me Ligji i prokurimit publik Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar Neni 1, pika 2, gërma, b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Ligji nr.10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1 Rekomandimi: AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizojë të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përlllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike.

Menjëherë dhe në vijimësi

10. Gjetje nga auditimi: Këshillit Drejtues për programin ekonomik të vitit 2021 ka zhvilluar mbledhjen e datës 18.12.2020 dhe të datës 24.12.2020. Në këto dy mbledhje dhe në veçanti në mbledhjen e datës 29.01.2021 është diskutuar “Mbi urdhrin e ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestro konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO.” dhe nuk është marr vendimmarrje, pavarësisht se zgjidhja e kësaj çështje rezulton me pasoja financiare, duke konsideruar se tarifa en-route e mbledhur nga Eurocontrol për llogari të RSH-së për ofrimin e shërbimeve të lundrimit ajror është një e ardhur e rëndësishme për Autoritetin e Aviacionit Civil, e cila përbën rreth 30% të të ardhurave totale..

Vendimmarrja e Këshillit Drejtues nuk ka marr në konsideratë për sa më poshtë vijon:

-a. Njoftimi i Eurocontrol për AAC nëpërmjet komunikimit elektronik bën me dije se shuma e mbajtur nga llogaria e Shqipërisë për llogari të Bechetti, deri në datën 15 dhjetor 2020 **është në vlerën 171,653 Euro**, ndërsa Ministria e Financave dhe Ekonomisë me shkresën nr. 1879/1, datë 23.03.2021, njofton AAC se kjo shumë në datën 28 Janar 2021 është **në vlerën 1,687,755 Euro**. *Theksojmë se referuar procesverbalit të mbledhjes së Këshillit Drejtues të datës 28.12.2020, detyrimi total është mbi në vlerën 140 milion euro.*

- b. Urdhri i ekzekutimit dhe vendimi i Gjykatës së Shkallës së Parë Belge për të cilën është lëshuar, nuk është realizuar në mënyrë zyrtare për Republikën e Shqipërisë, sikurse parashikohet në Konventën “Për njoftimin dhe dorëzimin jashtë shtetit të dokumenteve gjyqësore dhe jashtëgjyqësore në fushën civile dhe tregtare” të vitit 1965. Ky njoftim është bërë nëpërmjet Euro., e cila ka njoftuar AAC mbi objektin e urdhrin të ekzekutimit, me anë të shkresës Ref. DCF 126_20 të datës 7 dhjetor 2020.

-c. Autoriteti i Aviacionit Civil do të përballojë shpenzimet ekonomike të cilat do të rezultojnë në kuadër të ofrimit të asistencës juridike për çështjen e ngrirjes së llogarive të Republikës së Shqipërisë në E..L, sipas Urdhër Ekzekutimit të Autoriteteve Belge me objekt ngrirjen e llogarive të Republikës së Shqipërisë dhe Vendimit përkatës të Gjykatës së Shkallës së Parë Belge të datës 1 Dhjetor 2020, pra do t’i duhet të përshijë në programin ekonomik të viti 2021 shpenzimet të asistencës juridike, që nga auditimi rezultuan se nuk ka asnjë korrespondencë me Avokaturën e Shtetit n.q.s ka/ose jo të kontraktuar zyrë avokatie dhe sa shkojnë kostot e gjykimit.

-c. Edhe pse çështja paraqet rëndësi të veçantë për interesat e Shtetit dhe AAC, ka një natyrë të veçantë e të ndërlikuar juridike dhe kërkon njohuri juridike të specializuara në një fushë apo legjislacionit Ndërkombëtare dhe në Arbitrazhin Ndërkombëtar dhe urgjencën e kohës, Avokatura e Shtetit nuk ka vepruar në përputhje me nenin 15/8 dhe 18/1 të Ligjit 10018/2008, si dhe të Kapitulli 4 pika D të VKM nr. 893, datë 18.11.2020 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kriterëve për kontraktimin e pagesën e avokatëve/studiove të avokatisë, ekspertëve apo

shërbimeve të tjera ndihmëse dhe mënyra e pagesës”, pasi ka deleguar një të drejtë AAC që është tagër ekskluziv i saj.

-d. Mbledhja e Këshillit Drejtues e datës 29.01.2021 me pikë të parë të rendit të ditës mbi mbarëvajtjen e procesit të kundërshtimit të veprimeve përmbartimore lidhur me llogaritë e Republikës së Shqipërisë në EURO., është zhvilluar në fillim të viti buxhetor, ku AAC gjendet në pozitë financiare të vështirë që pasqyron qartazi vetëm një krizë të mprehtë likuiditeti, si rrjedhojë e mungesës së tarifës en-route dhe uljen rreth 50% të tarifës së sigurisë për shkak të numrit të ulët të fluturimeve nga kufizimet e COVID-19.

Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij neni 5 “Këshilli drejtues”, pika 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

10.1 Rekomandimi: Nga Organet Drejtuese të AAC ti bëhet prezent Instancave më të Larta Shtetërore, pozita financiare e AAC e krijuar, si rrjedhojë e urdhrat të ekzekutimit të vendosur nga Gjykata e Shkallës së Parë në Bruksel, mbi vendosjen e sekuestros konservative mbi llogaritë e Republikës së Shqipërisë në “EURO.” dhe pamundësia e deritanishme e zgjidhjes së kësaj situate nga institucionet e përfshira në këtë çështje si Avokatura e Shtetit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, jo vetëm për sa i përket mos përfitimit të tarifës en-route, por edhe për shpenzimet e pritshme të asistencës juridike (shpenzime avokatie).

Menjëherë

11. Gjetje nga auditimi: Këshilli Drejtues për vitin 2020 ka marrë 7 vendime qarkulluese. Konkretisht Vendimi nr. 2 datë 14.05.2020, vendimi nr. 4 datë 15.06.2020, vendimi nr. 5, nr. 6, nr. 7, nr. 8 datë 30.07.2020, vendimi nr. 12 datë 16.11.2020, ndërsa për vitin 2021 ka marrë 2 vendime qarkulluese konkretisht vendimin nr. 1 datë 08.01.2021 dhe vendimi nr. 2 datë 23.03.2021. Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, nuk ka të përcaktuar rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja me vendime qarkulluese. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të bëjë amendimin e Rregullores “Për rregullat e brendshme të organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me Vendim të Këshillit Drejtues nr. 68, datë 23.02.2017, ku të përcaktoj rregulla dhe procedura si organizohen mbledhjet në distancë dhe si merret vendimmarrja e tyre.

11.2 Rekomandimi: Këshilli Drejtues të shqyrtojë, analizojë me vëmendje, të debatojë dhe të miratojë me votim në mbledhje çështjet që vihen në rendin e ditës dhe të tjera për diskutim, me qëllim që të rritet performanca e AAC, duke shmangur sa më shumë të jetë e mundur vendimmarrjet nëpërmjet vendimeve qarkulluese.

Menjëherë dhe në vijimësi

12. Gjetje nga auditimi: Vendimi nr. 2 datë 23.03.2021 “Mbi miratimin e financimit dhe kontraktimit të “Asistencë për negociim të termave të kontratës konçensionare të Aeroportit të Vlorës”. Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje, është protokolluar me nr. 488/2 prot., datë 23.03.2021, dhe nuk është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së.

-Vendimi nr. 4 datë 15.06.2020 “Për Miratimin e Propozimit për Përfshirjen në Paketën Lehtësuese Financiare për Shkak të Situatës së Krijuar nga Covid-19, të Organizatës Evropiane

për Sigurinë e Lundrimit Ajror (këtu e në vijim Euro.). Nuk ka proces verbal të zhvillimit të mbledhjes, ndërsa vendimi është firmosur nga të gjithë anëtarët e pranishëm në mbledhje dhe kryetari, është protokolluar në datën 15.06.2020 me nr. 992/1 prot., dhe është publikuar në faqen zyrtare të AAC-së. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, me ndryshimet vijuese të tij, neni 11, pika 5, Rregullorja “Për rregullat e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Drejtues të AAC”, e miratuar me nr. 68, datë 23.02.2017 të Këshillit Drejtues, neni 9 pika 2. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1 Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara në mbledhjet e Këshillit Drejtues, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

13. Gjetje nga auditimi: Nuk është paraqitur në Këshillin Drejtues një raport i hollësishëm për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave, të dhënat e regjistrave, si dhe rastet e trajtimit të kërkesave të, qoftë nga operatorët, qoftë nga konsumatorët, që i janë paraqitur autoritetit. Veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 10.233, datë 11.02.2010 “Për autoritetin e aviacionit civil”, neni 13, pika iii. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqe 45-54 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv t'i kushtohet vëmendje e duhur institucionale, dërgimit të raportit të hollësishëm në Këshillin Drejtues për autorizimet, lejet dhe licencat e lëshuara, për miratimet dhe aktet e tjera individuale administrative të nxjerra, për rastet e refuzimit të licencave dhe të dhënave të regjistrave.

Menjëherë dhe në vijimësi

14. Gjetje nga auditimi: Të ardhurat nga tarifa e sigurisë së aviacionit, merret nëpërmjet Aeroporti Nënë Tereza. Për të garantuar sigurinë, TIA ka të drejtën të grumbullojë nga pasagjerët që përdorin aeroportin një tarife sigurie ("Pagesa e Sigurisë") deri në 4 EUR për pasagjer (2 EUR për pasagjeret që mbërrijnë dhe 2 EUR për pasagjeret që largohen) me qëllim që të mbulojë shpenzimet e arsyeshme për dhënien e shërbimit të sigurisë. TIA do të paguaj 25% **(ose 1 euro)**, të tarifës së sigurisë të mbledhur AAC në baza mujore me vonesë, dhe do të këtë të drejtën të mbajë diferencën. TIA, bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44” do të mbajë regjistrime me shkrim të numrit të pasagjerëve dhe shumat e tarifës së sigurisë së mbledhur, këto regjistrime do t'i paraqiten AAC-së për inspektim sipas kërkesës së arsyeshme. Nga AAC nuk është kryer asnjë inspektim në Aeroporti Nënë Tereza referuar SHTOJCËS 44. Përfitimi i të ardhurës nga tarifa e sigurisë së aviacionit, paraqet risk të lart, pasi të dhënat mbi pasagjer në dalje duke llogaritur 1 euro për pasagjer për llogari të AAC dhe tarifa e komunikimi duke llogaritur 25 euro për fluturim, bëhet e njëanshme vetëm nga Aeroporti Nënë Tereza. Pra nuk ka as verifikim nga ndonjë burim tjetër p.sh. operatorët e fluturimit, për saktësinë e pasagjerëve që raporton TIA. Referuar akteve ligjore dhe nënligjore mbi të cilat ushtron aktivitetin AAC, nuk i mundësohet të kërkoj të dhëna të tjera nga burime alternative për të verifikuar saktësinë e të dhënave të raportuara nga TIA. Për sa më sipër grupi i auditimit mori në përzgjedhje dy operatorë shqiptar të cilët kryejnë fluturime të rregullta (skedulë) në TIA. Konkretisht u morën në auditim operatori A. dhe A. A.. Duke marrë për bazë aplikimet për leje fluturimi dërguar nga dy kompanitë e mësipërme për sezonin veror IATA 2020, u konstatua se nuk ka asnjë të dhënë për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje.

Gjithashtu, këto të dhëna i referohen vetëm numrit të fluturimeve sipas frekuencës së kërkuar nga secili operator. Bazuar në Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare”, AAC nuk ka tagër ligjor për ti kërkuar operatorëve të dhënat statistikore për numrin e pasagjerëve në hyrje dhe në dalje. Nga informacioni verbal i dhënë nga Sektori i Licencave të Operimit dhe Shërbimit të Lejeve të Fluturimit, jemi bërë me dije se AAC po bashkëpunon me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 (e cila ka pësuar 5 ndryshime), “ Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”. Aktualisht Bashkimi Evropian ka në fuqi Rregulloren me nr. 437/2003 “Mbi statistikën në lidhje me transportin e udhëtarëve, transportin e mallrave dhe postës” (Regulation (EC) No 437/2003 of the European Parliament and of the Council of 27 February 2003 on statistical returns in respect of the carriage of passengers, freight and mail by air). Pra Bashkimi Evropian e ka, Republika e Shqipërisë nuk ka një rregullore për këtë qëllim. Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9312, date 11.11.2004, “Për marrëveshjen konçesionare, SHTOJCA 44”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

14.1 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv të merren masa për kryer për inspektime të herë pas herë në regjistrat e mbajtura nga TIA për numrin e pasagjerëve dhe shumën e tarifës së sigurisë së mbledhur.

Menjëherë dhe në vijimësi

14.2 Rekomandimi: Nga Drejtori Ekzekutiv të kushtohet vëmendje e duhur institucionale bashkëpunimit me MIE në lidhje me transpozimin e direktivës së BE nr. 437/2003 “Për rregulloren mbi raportet statistikore në lidhje me transportin e pasagjerëve, mallrave dhe postës”, edhe për AAC.

Menjëherë

15. Gjetje nga auditimi: Për periudhën nga data 10.11.2017 -22.04.2020, nuk janë publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit të Aviacionit Civil vendimet lidhur me dhënien, pezullimin apo anulimin e licencave të operimit. Veprim në kundërshtim me pikën 3 të Nenit 11 të Udhëzimit të Ministri të Punëve Publike dhe Transportit nr. 17, datë 2.9.2010 "Mbi Rregullat e Zbatueshme të Operimit në Fushën e Shërbimeve Ajrore", i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3 faqe 54-63 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

15.1 Rekomandimi: Për shkeljet dhe parregullsitë e konstatuara për periudhën 10.11.2017 - 22.04.2020, edhe pse kjo praktikë është korrigjuar, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja e rasteve të tilla në të ardhmen.

Në vijimësi

16. Gjetje nga auditimi: Njëpërmjet bankës, janë kryer pagesat për “pensionin vullnetar” të punonjësve të AAC prej vitit 2014 e në vazhdim. Për periudhën objekt auditimi janë shpenzuar nga AAC për këtë qëllim 58,918,231 lekë. Nga grupi i auditimit në lidhje me bazën ligjore të dhënies së këtij financimi për punonjësit me fondet e institucionit u kërkuar dokumentacion ligjor mbi argumentimin e financimit. Administrata e AAC është administratë publike, Statusi i punonjësve të AAC është me statusin e Nëpunësit Civil dhe pagat janë paga të miratuara me VKM dhe paga të barazvlefshme me pagat e grupeve përfituese të përcaktuara në ligjin nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit” neni 1, pikat 5 dhe 9. Në këto pika përcaktohet se përfitojnë punonjësit e Administratës Publike si edhe personat e barazvlefshëm me pagë sipas grupeve përkatëse. Nga AAC, nuk janë vazhduar procedurat për futjen e institucionit në skemën

e pensionit suplementar, pasi sipas pikës 4, të VKM nr. 499, datë 21.09.2000 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 382, datë 20.05.1996, të KM “Për zbatimin e ligjit nr. 8097, datë 21.03.1996 “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, AAC duhej ti drejtohej sipas hierarkisë Këshillit të Ministrave pasi është ky organ që miraton ndryshimin ose jo të emërtesës dhe jo Ministria. Në ligjin nr. 10233, datë 11.02.2010 “Për Autoritetin e Aviacionit Civil” neni 3, citohet se: AAC është person juridik publik, jo buxhetor, në varësi të Ministrit që mbulon çështjet e transportit ajror, po kështu referuar nenit 16, struktura dhe pagat e AAC miratohen me VKM dhe punonjësit e AAC trajtohen me Statusin e Nëpunësit Civil. Pra, AAC futet në institucionet publike dhe si e tillë nuk mund të veprojë jashtë kuadrit ligjor të përdorimit të fondeve të institucionit etj. Gjithashtu, financimi i fondit të pensionit për punëmarrësin është në kundërshtim me nenin 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.02.2010, pika 4, ku citohet se: Të ardhurat përdoren për paga, sigurime dhe shpërblime, shpenzime operative dhe investime kapitale, të nevojshme për funksionimin normal të Autoritetit, si edhe për pagesat e kontributeve që rrjedhin nga anëtarësimi i Republikës Shqipërisë në organizmat ndërkombëtare të aviacionit civil”. Pagesat e kryera sa më sipër janë pagesa për financim të pensionit profesional dhe nuk hyjnë në pagesat e cilësuar në ligjin për AAC. Me vendimin nr. 57, datë 03.08.2016, të Këshillit Drejtues është miratuar një rregullore “Për pensionet vullnetare të punëdhënësit”, ku përcaktohet se AAC, merr përsipër detyrimin për të paguar kontribute në favor të punëmarrësve. Në këtë rregullore nuk janë përcaktuar kufijtë minimal dhe maksimal të % mbi pagë që do të llogaritet dhe përfitohet sipas grupeve të përcaktuara, por janë ndarë vetëm 3 grupe punonjësish sipas moshës dhe vjetërsisë në punë. Në pikën 2.4 të rregullores citohet se: Kontributi për llogaritet si % e cila është variabël dhe përcaktohet çdo vit në bazë të mundësive financiare të institucionit nëpërmjet fondit të miratuar për pensionet vullnetare të parashikuar në programin ekonomik-financiar të vitit dhe depozitohet në llogaritë individuale të punëmarrësit. Për periudhën objekt auditimi konstatohet se % e përfituar nga punonjësit për vitet 2019-2021 varjon nga 20-25%, megjithëse aktiviteti i AAC për vitin 2020, rezulton me humbje (në shumën 14,920,327 lekë), dhe në vështirësi financiare. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

16.1 Rekomandimi:

Këshilli Drejtues dhe strukturat drejtuese të AAC, brenda mundësive të financimit dhe referuar kompetencave ligjore për miratim, parashikuar në legjislacionin në fuqi të krijojnë fondin për financimin e pensionit vullnetar dhe përqindjen e pjesëmarrjes, vetëm duke marrë miratimet përkatëse si edhe përcaktimin e këtij financimi në ligjin “Për AAC”.

Brenda datës 30.12.2021

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Në procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC-së” me fond limit 1,965,666 lekë, viti 2020, Komisioni për llogaritjen e fondit limit ka hartuar specifikimet teknike dhe termat e referencës dhe fondin limit për procedurën e prokurimit “Sigurim i ndërtesës dhe pajisjeve të AAC” prej 2,198,500 lekë. Fondi i llogaritur nga komisioni i përbërë nga A. D., S. K. dhe E. K. është 232,534 lek më i lartë se kontrata aktuale, element që ngarkon me përgjegjësi komisionin pasi:

-Së pari vlera e aseteve të siguruar për vitin 2020 është 105,514,767 lekë ndërsa për vitin 2019 kjo vlerë arrinte në 111,909,234 lekë pra vlera e aseteve ka rënë me 6,394,467 lek ose me 0.5% ndërkohë që vlera e fondit limit e llogaritur nga komisioni është rritur me 11.8%. Kjo lidhje duhet të jetë e drejt e jo e zhdrejtë.

-Së dyti AAC ka një kontratë të realizuar me sukses dhe nuk është e nevojshme marrja e ofertave, madje duke marrë oferta dukshëm më të larta se kontrata e mëparshme ndërkohë që vlera e aseteve ka rënë;

-Veprimet e mësipërme kanë sjellë një fryrje të pa justifikuar të fondit limit me një efekt financiar për buxhetin e institucionit AAC në vlerën 2,197,950 lekë (oferta e suksesshme) - 1,964,600 lekë (kontrata e mëparshme) = **233,350 lekë , vlerë e cila përbën dëm ekonomik dhe duhet dëmshpërblehet**. Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 1 pika b) VKM 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Neni 59 Përlllogaritja e vlerës limit të kontratës 1. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 98-112 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: AAC, në çdo rast përpara nxjerrjes së fondit limit duhet të analizoj të gjithë faktorët e nevojshëm të cilët kanë ndikim financiar, teknik dhe juridik në përlllogaritjen e fondit me qëllim administrimin sa më të mirë të fondeve publike. AAC të ndjek të gjitha rrugët administrative dhe ato ligjore për arkëtimin e shumës prej **233,350 leke** nga komisioni i përlllogaritjes së fondit limit.

Brenda datës 31.12.2021

C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE.

1.Gjetje nga auditimi: AAC ka shpenzuar nga humbja e proceseve gjyqësore dhe ekzekutimi i detyruar i titujve ekzekutivë (punonjës të larguar nga puna) për periudhën 2019-2020, shumën 13,933,903 lekë. Kjo vlerë përfaqëson dëmshpërblimin e punonjësve në shumën 13,294,846 lekë, shpenzime gjyqësore në shumën 114,400 lekë dhe shpenzime përmbarimi në shumën 524,657 lekë. Vlera prej **13,933,903 lekë, përbën efekt negativ financiar** për institucionin. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, në të ardhmen të marrin masa për eliminimin e procedurave të largimeve nga puna të punonjësve të paargumentuara ligjërisht, me qëllim minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare dhe venë në vështirësi institucionin.

Në vijimësi

2.Gjetje nga auditimi: Nëpërmjet bankës për periudhën objekt auditimi, janë kryer pagesa për “Sigurimin e jetës & shëndetit të punonjësve” në kompanitë e sigurimeve “S.” dhe “I.”. Për 3 vjet prej fillimit të kryerjes së këtij shërbimi vlera prej **8,970,950 lekë**, është shpenzuar për sigurimin e jetës dhe shëndetit të punonjësve, **vlerë e cila konsiderohet efekt ekonomik negativ** pasi nuk ka asnjë argumentim ligjor për arsyet e kryerjes së këtij shërbimi. Mungon analiza dhe hartimi i një programi mbi argumentimin e kryerjes së këtij shërbimi, nuk ka asnjë dokumentacion ku të arsyetohen kategoritë dhe vendet e punës që kanë më shumë risk, si është vlerësuar nga institucioni risku i punonjësve të administratës krahasuar me personelin teknik, etj, bazuar në detyrimet e punëmarrësit sipas Ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe Shëndetin në Punë”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 72-86, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

2.1 Rekomandimi: Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues, të analizojnë dhe përcaktojnë kategoritë përfutuese të punonjësve për sigurim jete dhe shëndeti, referuar vështirësisë së vendit

të punës dhe nivelit të riskut për çdo pozicion pune, referuar legjislacionit në fuqi dhe me miratim nga Ministria e linjës, me qëllim përfitimin e shërbimit nga punonjësit dhe minimizimin e rasteve që shoqërohen me efekte negative financiare.

Brenda datës 30.12.2021

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i listë pagesave për punonjësit e AAC, është konstatuar se pjesë përbërëse e pagës totale është dhe pagesa për shërbimin e telefonisë celulare. Pagesat për telefonin celular për administratën janë paguar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 5, date 20.01.2011 “Për tarifat e shërbimit të telefonisë celulare për punonjësit e AAC”, vendim ky që është marr në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” i ndryshuar. Edhe pse ky fenomen është konstatuar dhe nga grupet e mëparshme të KLSH-së, vazhdon dhe zbatohet nga ana e AAC.

Për periudhën 1.11.2020-30.04.2021 pagesa e këtij shërbimi është rregulluar referuar vendimit të Këshillit Drejtues nr. 11, datë 27.10.2020, konform VKM nr. 673, datë 02.09.2020 “Për pajisjen me numër telefoni celular të funksionarëve publikë ” (Tabela me punonjësit që e kanë përfituar pa të drejtë këtë shërbim paraqitet në aneksin nr. 3 të këtij Projekt Raporti).

Nga data 01.09.2019-31.10.2020 punonjësit që kanë përfituar pagesën për shërbimin e telefonive celulare në kundërshtim me VKM Nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë” janë paraqitur në aneksin nr. 3. Vlera totale e përfituar për këtë periudhë është **1,288,125 lekë** e cila ka shkaktuar efekt negativ për buxhetin e AAC. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 63-72 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1 Rekomandimi: Për shkeljen e konstatuar në pagesat e kryera për shërbimet telefonike dhe pse kjo praktikë është korrigjuar në vitin 2020, duhet ti kushtohet vëmendja e duhur institucionale mos përsëritja më e këtij fenomeni në të ardhmen.

Menjëherë dhe në vijimësi

E. MASA DISIPLINORE:

Mbështetur në nenet 57, 58 dhe 59 të ligjit nr. 153/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, i ndryshuar, pasi të jenë identifikuar përgjegjësitë në lidhje me shkeljet e konstatuara e të trajtuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, i rekomandohet Titullarit të AAC, si dhe Komisionit Disiplinor përkatës për vlerësim dhe dhënie masash disiplinore nga “Vërejtje” deri “Largim nga shërbimi civil”.

Për punonjësit e identifikuar me përgjegjësi për shkeljet e konstatuara, Titullari i AAC, pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

a. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

b. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.